



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 6 MAJ 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
6. MAJA 2011. GODINE**

**MAJ – MAJA
2011**

E premte, 6.05. 2011, ora 10:00

Drejtton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në mbledhje janë të pranishëm 90 deputetë, andaj mund t'ia fillojmë me rendin e ditës.

Sot pika e parë e rendit të ditës është:

- 1. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, e 11 marsit 2011**
- 2. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin e softuerit për doganat, ASYCUDA),**
- 3. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,**
- 4. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW-Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regional-Prishtina,**
- 5. Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut,**
- 6. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.**

Këto janë 6 marrëveshjet dhe ne në fillim e zhvillojmë debatin për të gjitha ose nëse ka të paraqitur për debat, kurse votimin e bëjmë veç e veç për secilën marrëveshje.

Besoj që jeni dakord për këtë formë.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ratifikimin e Marrëveshjes për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore të 11 marsit 2011.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, si propozues i çështjes.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht më lejoni që t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare që gjatë diskutimeve që kemi pasur për buxhetin, pikë të cilën e kemi diskutuar ka qenë edhe ratifikimi i këtyre marrëveshjeve, për çka i falënderoj shumë për mundësinë që na kanë dhënë t'i diskutojmë këto marrëveshje.

Këto marrëveshje nuk i dedikohen ndonjë subjekti politik, nuk i dedikohen ndonjë institucioni, po këto marrëveshje iu dedikohen të gjithë qytetarëve të Kosovës. Është shumë e rëndësishme ratifikimi i këtyre marrëveshjeve dhe rëndësia e këtyre marrëveshjeve konsiston në aspektin ekonomik, sepse do të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetesës për gjithë qytetarët e Kosovës, do të ndikojnë në përmirësimin e qeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies dhe do të kenë rëndësi të veçantë për hapjen e mundësisë për bashkëpunimin edhe në të ardhmen me këto institucione ndërkombëtare dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Në vazhdim, më lejoni që sot para jush, deputetë të nderuar, sipas rendit të ditës të paraqes për ratifikim gjashtë marrëveshje bilaterale të Qeverisë së Republikës së Kosovës me institucione ndërkombëtare dhe Qeverinë e Luksemburgut.

Baza ligjore e paraqitjes së marrëveshjeve në parlament qëndron në nenin 18, paragrafi 1, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 11 të kreut IV të Ligjit për borxhet publike që ka të bëjë me marrëveshje ndërkombëtare, ku ministri i Financave është i autorizuar i vetëm për të negociuar kushtet dhe lidhur me marrëveshje për të siguruar borxhet ndërkombëtare në emër të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të prezantoj aspektet e përgjithshme të marrëveshjes së nënshkruar me Bankën Botërore me datën 11 mars 2011.

Në gusht të vitit 2009, Qeveria e Kosovës dhe Banka Botërore arritën marrëveshje për mbështetje të përbashkët të politikave që kanë për qëllim përkrahjen e punësimit të qëndrueshëm.

Kjo marrëveshje e dizajnuar në formë të një programi për punësim të qëndrueshëm ofron mbështetje financiare për politika mbështetëse që zbatohen përmes aktiviteteve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në esencë, kjo marrëveshje kërkon nga Qeveria që të buxhetojë aktivitete të përcaktuara bashkërisht nga Qeveria dhe Banka Botërore me strategjinë për punësim të qëndrueshëm. Pasi që Qeveria të bëjë alokimin e fondeve, ajo përfiton të drejtën e pranimi të mbështetjes buxhetore në vlerë prej 55 milionë eurosh gjatë tri viteve. 50 milionë euro nga tërë kjo pako ofrohen në formë të grantit, ndërsa 5 milionë euro ofrohen në formë të kredisë koncesionare.

Në vitin 2010 janë përmbushur të gjitha obligimet buxhetore nga ana e Qeverisë së Kosovës, prandaj nëse ju sot i mbështetni këto marrëveshje, në një kohë shumë të shkurtër mund të pritët distribuimi i pjesës së parë prej 20 milionë eurosh në formë të grantit dhe pjesa prej 5 milionë eurosh kredi koncesionare. Disa nga projektet kryesore

të cilat do të financohen përmes kësaj strategjie, janë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmirësimi i infrastrukturës për biznes, financimi i përfundimit të Parkut industrial, dizajnimi dhe implementimi i programit për funksionalizimin e inkubatorëve të biznesit, vazhdimi i punës së filluar nëpërmes projektit Beta, krijimi i një qendre One Stop Shop në nivel qendror, ku bizneset do të mund të përfundojnë të gjitha shërbimet në lidhje me institucionet publike.

Ministria e Arsimit. Ndërtimi i katër qendrave të kompetencës, definimi i nevojave për ndërtimin e shkollave për aftësim profesional, krijimi i një Qendre Kombëtare për kualifikim profesional.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Projekti për kryerjen e punëve publike, ku ky projekt tanimë ka filluar të zbatohet gjatë vitit 2010 dhe është buxhetuar të vazhdojë edhe në vitin 2011. Ky është një projekt për inkuadrimin e të papunëve të regjistruar në realizimin e projekteve publike. Krijimi i një programi kompjuterik për strategjinë e punësimit publik në Kosovë, ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e Inspektoriatit të Punës në pajtim me një plan të detajuar në kuadër të strategjisë për punësim. Përveç këtyre projekteve, ekzistojnë edhe projekte të tjera që janë pjesë e kësaj strategjia, të cilat do të kenë ndikimin e tyre në zvogëlimin e papunësisë në Kosovë. Natyrisht, pasi që obligimet për pranimin e pjesës prej 20 milionë eurove në këtë formë të grantit janë përmbushur gjatë vitit 2010, atëherë pranimi i këtij granti gjatë vitit 2011 do të përfaqësojë pozitën tonë fiskale përmes rritjes së bilancit bankar. Ndërsa pjesa prej 5 milionë eurosh do të pranohet në formë kredie koncesionale, ofrohet me kushte shumë të volitshme, me rikthim pas 10 vitesh dhe me një normë interesi në formë të taksës së shërbimeve administrative prej 0,75% mbi bilancin e kredisë së mbetur. Shlyerja e kësaj kredie do të bëhet në një periudhë 10 vjeçare, duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2030 dhe e tërë shuma e interesit të paguar për këtë kredi gjatë 10 viteve do të jetë përafërsisht 375.000 euro.

2. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe UNCTAD (Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara për projektin softueri për doganat,ASYCUDA),

Marrëveshja në mes të Qeverisë dhe UNCTAD parasheh implementimin e një sistemi të ri softueri për doganat e Kosovës. Ky sistem softuerik që përkrah pothuaj të gjitha operacionet e doganës, do t'i mundësojë këtij institucioni të zëvendësojë sistemin e tanishëm të vjetërsuar me një sistem të avancuar teknologjik. Për më shumë, Agjencioni Specializuar i Kombeve të Bashkuara UNCTAD i ka afruar doganës së Kosovës, si donacion, instalimin e një sistemi të ri dhe në bazë të vlerësimit të përbashkët të nevojave është bërë përzgjedhja e programit ASYCUDA. Ky është një program tashmë i instaluar në 96 vende të botës, përfshirë këtu edhe 5 shtete të Unionit Evropian. Ky sistem me vlerë prej 4 milionë euro do t'i dhurohet Kosovës nga Agjencioni UNCTAD, ndërsa si kusht për ta pranuar këtë donacion, domethënë, Qeveria duhet të mbulojë vetëm koston e trajnimit të stafit, kosto kjo që vlerën maksimale mund ta ketë 900 mijë euro. Ju rikujtoj se kjo kosto tashmë është e buxhetuar si pjesë e buxhetit të Ministrisë së Financave, përkatësisht Doganave të Republikës së Kosovës. Duke qenë se kjo

marrëveshje nuk ka implikime fiskale shtesë, kërkoj nga ju mbështetjen formale për këtë marrëveshje që do të mundësojë modernizimin e mëtutjeshëm të Doganave të Kosovës.

3. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrë në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,

Projekti i kadastrit për regjistrimin e pronës së paluajtshme, i përgatitur nga Agjencioni kadastral të Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ka për qëllim kryesor zhvillimin e sistemit të informatave kadastrale dhe administrimit të tokës. Këto objektiva janë parakushte për të pasur një treg të qëndrueshëm të pronave të paluajtshme, i cili ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe krijon kushte për një jetë më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Një sistem i modernizuar i regjistrimit kadastral sjell përfitime të shumta ekonomike dhe sociale duke rritur sigurinë e pronës, përmirësuar qasjen e familjeve në kredi, zvogëluar mosmarrëveshjet për pronën, duke kontribuar në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore përdorisa pronarët i zgjerojnë horizontet e tyre për investime dhe duke inkurajuar zhvillimin më të rregullt urban dhe ndërrurban.

Financimi i projektit të modernizimit të sistemit kadastral do të financohet nga burimet e Bankës Botërore, ku 55% e koston do të mbulohet përmes kredisë koncesionale, ndërsa pjesa e mbetur prej 45% do të financohet në formë donacioni.

Financimi në formë të grantit ka vlerën prej 5.51 milionë dollarë, ndërsa financimi i ofruar në formë kredisë koncesionale ka vlerën prej 6.74 milionë dollarë. Projekti është negociuar në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore me 5 dhe 6 tetor 2009, si dhe është aprovuar nga Bordi i Bankës Botërore në Uashington, më 4 shkurt 2010.

Distribucioni i fondeve pritet të bëhet pas aprovimit nga Parlamenti i Kosovës. Periudha e implementimit të projektit do të jetë 5 vjeçare dhe do të jetë në harmoni të plotë me planin e punës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës 2009 – 2014.

Kushtet e financimit nuk përfshijnë pagesën formale të interesit për burime në fond kredisë, por plani i rikthimit të kredisë parasheh pagesën e përkushtimit të pagesës së shërbimeve administrative në vlerë prej 0,5% dhe 0,75%, respektivisht të kryegjësë së mbetur.

4. Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW dhe Ujësjetës Regional Prishtina,

Kjo marrëveshje me radhë që unë sot po e prezantoj para jush, ka për qëllim mbështetjen e fazës së dytë të zgjerimit dhe rikuperimit të infrastrukturës për furnizim me ujë të pijshëm. Qeveria e Kosovës me këtë marrëveshje është vetëm palë garantuese në mes të KfW dhe Kompanisë së Ujësjetës Regional Prishtina, për pjesën e projektit që parashihet të financohet përmes kredisë koncesionale.

Mbështetja për Kompaninë e Ujësjetllësit të Prishtinës është ofruar në sajë të një studimi të kryer nga ana e KfW-së dhe Kompanisë së Ujësjetllësit Prishtina mbi mundësitë e përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm. Marrëveshja për të cilën sot kërkohet mbështetjen tuaj parasheh financimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjetllësit, çka do të qojë drejtë zgjerimit të kapaciteteve të tanishme të furnizimit dhe uljes drastike të humbjeve teknike. Për më shumë, kjo pjesë e projektit do të krijojë parakushte të nevojshme për fillimin e fazës së tretë të projektit, gjegjësisht ndërtimit të fabrikës së ujit.

Kjo marrëveshje siguron financimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës ujore përmes një grati të Qeverisë Gjermane në një vlerë prej 11 milionë eurove, që është donacion, dhe përmes një kredie koncesionale në vlerë prej 6 milionë euro. Kthimi i pjesës së kredisë do të bëhet duke filluar nga viti 2020 drejtpërdrejtë nga Kompania e Ujësjetllësit Prishtina, ndërsa Qeveria do të ketë vetëm rolin e garantuesit. Norma e interesit për pjesën e kredisë është vetëm 0,75%, që bazuar në studimin e fizibilitetit të kompanisë do të jetë lehtë e mbulueshme gjatë kohës kur edhe parashihet kthimi i kësaj kredie.

5. Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut.

Në vazhdim. më lejoni që të them shkurtimisht disa fjalë rreth Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut. Bëhet fjalë, pra, për projektin e mbështetjes institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë të pijes në Mitrovicë.

Besoj që të gjithë pajtoheni që çështja e furnizimit me ujë të pijshëm është një nga çështjet shumë të rëndësishme për standardin e jetës së qytetarëve dhe rrjedhimisht si prioritet i lartë në shoqërinë tonë. Edhe përkundër investimeve të mëdha që janë duke u bërë në këtë fushë nga ana e buxhetit shtetëror, megjithatë nevojat në këtë sektor vazhdojnë të jenë të larta. Në këtë drejtim dua që edhe një herë të potencoj faktin se rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe për banorët e rajonit të Mitrovicës. Edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme pas luftës, gjendja në sektorin e furnizimit me ujë vazhdon të jetë ende në nivelin e pritjeve tona dhe për këtë arsye Qeveria, në bashkëpunim me donator, i ka kushtuar rëndësi të veçantë sektorit të ujit.

Në harmoni me mundësitë të buxhetore janë bërë edhe po bëhen investime kapitale nëpër kompanitë rajonale të ujit në tërë Kosovën dhe investimet e tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Për këtë arsye edhe ka filluar projekti në të cilin është përfshirë marrëveshja në fjalë. Objektiva kryesore e projektit është arritja e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm për popullatën e Mitrovicës.

Shuma totale e buxhetit të premtuar është 4.750.000 euro. Kontribut nga Luksemburgu donacion është 4.500.000 euro, kontributi vendor 250 mijë euro, kostoja e përllogaritur e punës nga Kompania Regjionale e Ujit në Mitrovicë.

Projekti planifikohet që të implementohet brenda 36 muajve dhe pritet të fillojë së shpejti pas ratifikimit, si dhe do të implementohet nga të dy palët.

6. Marrëveshja e fundit, Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Fillimisht, më lejoni që në lidhje me këtë marrëveshje në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'ju falënderoj për vëmendjen, për vënien e serishme në rend të dite të mbledhjes së Kuvendit Ratifikimin e Marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës me Bankën Botërore, përkatësisht Agjencionin e saj IDA.

I falënderoj edhe shefat e grupeve parlamentare që kanë mundësuar të diskutojmë dhe ta marrim përkrahjen për aprovimin e kësaj marrëveshje. Ky projekt do të zbatohet nga Ministria e Financave për komponentin e menaxhimit të financave publike, në njërin anë, duke përfshirë prokurimin si dhe Ministria e Administratës Publike për komponentin e menaxhimit të listës së pagave, burimeve njerëzore me shërbimin civil, si dhe modernizimin e sistemeve informatike të qeverisë, në anën tjetër.

Aktivitetet specifike për implementimin e këtij projekti do të përfshijnë edhe pjesëmarrjen e ministrave tjera të përzgjedhura të linjës dhe të institucioneve publike, siç është: Ministria e Bujqësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor të Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

Projekti përfshin shumën prej 8 milionë dollarëve dhe përbëhet prej 2 pjesësh. Pjesa e parë, në vlerë prej 3.6 milionë dollarësh, që është donacion, dhe pjesa e dytë, me vlerë prej 4.4 milionë dollarë, që është kredi. Marrëveshjet, pra, do të bëjnë financimin dhe zbatimin e projekteve për modernizimin e sektorit publik.

Duke ju falënderuar për vëmendje dhe mirëkuptimin tuaj, më lejoni që krejt në fund të ju lus për mbështetjen e këtyre marrëveshjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Sipas radhës, fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ : Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen që pasur me datën 4 maj të vitit 2011, i ka shqyrtuar të gjitha marrëveshjet të cilat janë në rend të ditës, ku kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit dhe aty është bërë një debat i hapur me ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, dhe pas kësaj debati të gjithë anëtarët e Komisionit kanë qenë pro ratifikimit të këtyre marrëveshjeve. Prandaj, i ftoj të gjithë

deputetët që ta përkrahin rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të bëhet ratifikimi i të gjitha marrëveshjeve të cilat i kemi sot në rend dire. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare, nëse dëshirojnë. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është munduar, ka bërë përpjekje dhe, besoj, ka qenë pjesë kreative e procesit të këtyre punëve, për aq sa na ka takuar si parlamentar, dhe pas analizave të bëra, vlerësimi ynë që miratimi ose përkrahja e këtyre marrëveshjeve është në dobi të shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve dhe pikërisht për këtë ajo ose mund të merret bukvalisht, të thuhet që përkrah një vendim të Qeverisë ose vendimin e Qeverisë, po vërtet konsiderojmë që këto janë në dobi të qytetarëve dhe, si të tilla, pa dashur që për secilën të deklarohemi veçmas, unë po e them që për të gjitha, do të thotë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës shpreh konstruktivitetin e vet dhe përkrah dhe do t'i votojë këto, do të japë votën për të gjitha këto marrëveshjeve që do të dalin në votim, për ratifikim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Deputetë të nderuar,

Unë, në emër të Grupit Parlamentar do ta bëjë një vlerësim të secilës marrëveshje veç e veç, shkurtimisht, dhe në fund do të deklarohem për atë se si do të votojë Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” për këto marrëveshje.

Së pari, është mirë që po i votojmë këto një nga një për shkak të natyrës së ndryshme të këtyre marrëveshjeve dhe jo të gjitha janë të pajtueshme, domethënë, për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Marrëveshja e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Bankën Botërore për grante dhe kredi afatgjata, në aspektin financiar duket të jetë një marrëveshje e dobishme, domethënë, nuk ka implikime shumë të mëdha buxhetore. Mirëpo, po ashtu duhet bërë e qartë këtu se kjo marrëveshje, sikur shumë tjera të mëparshme, është marrëveshje e cila na sjell më shumë asistencë teknike se sa që në fakt na ndihmon në ndonjë aspekt tjetër të zhvillimit. Ne jemi të vetëdijshëm dhe kemi qenë dëshmitarë që kjo asistencë teknike prej vitit 1999 e tutje nuk i ka sjellë kushedi çfarë dobie Kosovës. Pra, nuk është se na ka munguar asistencë teknike gjatë këtyre viteve, mirëpo po i shohim rezultatet. Pra, vetëm për hir të informimit, diku 3.5 miliardë janë dhënë euro, i janë dhënë Kosovës në asistencë teknike prej vitit 1999 e tutje dhe kemi vite sikur viti 2005, kur afro 80% të të gjitha donacioneve që kanë dhënë në Kosovë, faktikisht kanë qenë asistencë teknike. Ne konsiderojmë që koncepti i zhvillimit ekonomik në Kosovë duhet të jetë tjetër, pra duhet të ndryshojë nga ky çfarë e ka kjo qeveri, çfarë po e tregon kjo qeveri deri tash. Pra, nuk

ka zhvillim ekonomikë nëse nuk investohet më shumë në prodhim, nuk ka zhvillim ekonomik e as punësim të qytetarëve po qe se nuk fillojmë t'i zëvendësojmë të gjitha këto importe që po na hyjnë brenda dhe nuk konsiderojmë që një asistencë teknike, qoftë nga Banka Botërore apo nga tjetër kush do ta ndryshojë këtë gjendje. Mirëpo, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta mbështet këtë Marrëveshje të Bankës Botërore dhe po ashtu më duhet të them që kjo është hera e fundit që Lëvizja “Vetëvendosje” mbështet këso marrëveshje për asistencë teknike, me qenë se nuk konsiderojmë që Kosova ka nevojë e as leverdi që të hyjë në kredi për asistencë teknike, të cilat po ashtu na vinë nga jashtë.

Për sa i përket marrëveshjes së dytë me UNCTAD-in, këtu kostoja financiare nuk është shumë e madhe edhe natyrisht që softueri i cili ofrohet nga UNCTAD-i, sipas informatave që kemi arritur t'i mbledhim, është një prej softuerëve më të avancuar në botë sot sa i përket digjitalizimit dhe informatizimit të sistemit doganor. Mirëpo, duke pasur parasysh që kostoja financiare nuk është aq e madhe, kjo marrëveshje ka kosto politike të madhe për shkak se kjo marrëveshje bazohet në Rezolutën 1244. Pra, nëse e lexoni faqen 1 të përmbledhjes ekzekutive të marrëveshjes, paragrafi thotë kështu, po e lexoj: “UNCTAD-i është i autorizuar nga UNMIK-u për të vepruar në interes të tij në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me implementimin e marrëveshjes së tanishme. UNCTAD-i nga afër do të koordinoj aktivitetet e veta me ULEX-in, në veçanti me doganën e EULEX-it, pra doganën e EULEX-it, thotë, e cila vepron në Kosovë nën Kornizën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”. Pra, në njëërën anë, me deklarime verbale kjo Qeveri thotë se po bëjnë çmos për ta ndërprerë mbikëqyrjen ndërkombëtare përmbi Kosovën dhe janë deklarativisht prapë kundër vazhdimit të UNMIK-ut, të Rezolutës 1244, ndërkohë që në të njëjtën kohë na sjellin marrëveshje këtu që të ratifikohen, të cilat ia vazhdojnë jetën edhe UNMIK-ut, edhe Rezolutës 1244. Pra, unë konsideroj që kjo marrëveshje është e papranueshme dhe do të duhej të ishte e papranueshme për këtë Kuvend për shkak të kësaj kostoje të lartë politike që kjo e bartë. Natyrisht që kjo nuk është marrëveshje e vetmja që e vazhdon jetën e UNMIK-ut në Kosovës, mirëpo kjo është pjesë përbërëse e këtij vazhdimi dhe aq më keq është pjesë përbërëse të cilën po kërkohet ta ratifikojë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Për sa iu përket dy marrëveshjeve për ujësjellës, të cilat janë me KfW dhe Qeverinë e Luksemburgut, këto natyrisht që do ti mbështesim, janë marrëveshje të dobishme për Kosovën, ne jemi të vetëdijshëm se sa ka nevojë të investohet në infrastrukturën e ujësjellësit dhe përgjithësisht në infrastrukturën e përpunimit të ujërave të zeza në Kosovë. Mirëpo natyrisht që edhe këtu i kemi disa vërejtje, e veçanërisht në Marrëveshjen që është me Qeverinë e Luksemburgut, e cila i dedikohet rajonit të Mitrovicës. Pra, ne e dimë që rajoni i Mitrovicës apo ujësjellësi i Mitrovicës furnizohet me ujë nga Ndërmarrja Publike Ibër-Lepencit, e cila menaxhon edhe me liqenin e Ujëmanit, apo siç është quajtur më parë Gazivodë. Penda e Ujmanit ka një menaxhim dhe personel njëqindpërqind serb, i cili nuk i raporton asnjë institucioni kosovar. Pra këta, siç e dimë, janë emëruar drejtpërsëdrejti nga Nebojsa Qoviqi, i cili atëherë koordinonte ose ishte udhëheqës i Qendrës Koordinuese Serbe edhe për Kosovën. Prandaj, investimet atje të ofruara përmes Qeverisë së Kosovës mund të kenë konsekuenca të paparashikueshme edhe politike, po edhe faktike.

Së dyti, teknologjia e vendosur tek penda në liqe mirëmbahet nga një kompani serbe, që pas luftës dhe një donacion në këtë drejtim do të mund të gjuhëzohej një presioni serb që t'i shtynte palët, në këtë rast Qeverinë e Kosovës dhe atë të Luksemburgut, t'i ofrojnë tenderë kësaj kompanie. Pra, këto janë rreziqe që mund të dalin nga kjo marrëveshje, të cilat natyrisht që janë rreziqe politike, të cilat duhet t'i zgjidh kjo Qeveri.

Ndërsa, sa i përket Marrëveshjes me KfW-në, kjo është një marrëveshje kështu financiarisht e leverdishme për Kosovën, mirëpo po ashtu duhet pasur parasysh që ajo që nuk e tha ministri, ose në fakt që e përmendi, po që nuk mund të merret për të sigurt, është që ne kemi parë deri tash që ujësjellësit këtu nuk kanë qenë edhe aq të suksesshëm, domethënë, me menaxhimin e financave dhe me qenë se pagesa e kësaj kredie do t'i mëveshët ujësjellësit, ka shumë mundësi që në fund Qeveria e Kosovës të përfundojë ajo që duhet ta paguaj këtë kredi.

Po ashtu, desha të përmend edhe vetëm një gjë, për fund, që marrëveshjet që janë me Bankën Botërore dhe me Shoqatë apo asociacionet për zhvillim ndërkombëtar, ministri nuk i përmendi, por varen nga dy kushte kryesore. Kushti i parë, u përmend nga ministri, pra ratifikimi në Kuvend dhe, kushti i dytë është marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, domethënë e cila bartë me vete, domethënë, edhe një farë kushtëzimi për një kujdes më të madh të menaxhimit makro-fiskal të ekonomisë së vendit.

Pra, përveç marrëveshjes me UNCTAD-in, marrëveshjet tjera do të mbështeten nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se këto marrëveshje janë në interes të Kosovës, kështu që do t'i votojë për ratifikim në Kuvendin e Kosovës. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re i mbështet rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, natyrisht duke pasur në konsideratë interesin e vendit për të ratifikuar këto marrëveshje dhe vota jonë do të jetë “për” për të gjitha këto marrëveshjet, do të thotë për të gjashtë marrëveshjet që i kemi sot për ratifikim. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Sasha Rashiq e ka fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsjedavajući!

Parlamentarna grupa samostalne liberalne stranke je takođe razmotrila sve sporazume vlade Kosova sa partnerima. Smatramo da su vrlo pozitivni i od opšte interesa, pa ćemo ih svaki ponaosob, dakle svih šest podržati i glasati „za“.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+” Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BLJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“ posle analize svih sporazuma donela je odluku da glasi za sve sporazume, jer smatramo da su od krucijalne važnosti za našu državu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Të tjerë për fjalë nuk ka të lajmëruar.

Para se të fillojmë procedurën e votimit, ju njoftoj se për të kaluar këto marrëveshje, duhen së paku 80 vota “për”.

Të nderuar deputetë,

Konstatoj se në sallë janë 100 deputetë, erdhën edhe dy, pra kemi 102 deputetë, edhe pse me elektronikë kemi 106. Mirë, erdhën edhe dy, pra 104 janë prezentë.

Fillojmë me votimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 102 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore të 11 marsit 2011.

Vazhdojmë me votimin e marrëveshjes së dytë, Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Agjencisë së specializuar të Kombeve të Bashkuara për projektin softuerit për doganat.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 92 vota “për”, edhe me një votë me ngritje dore, 13 “kundër” dhe një abstenim, Kuvendit ratifikoi Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë Republikës së Kosovës dhe UNCTAD për projektin e softuerit për doganat.

Në radhë është votimi për marrëveshjen e tretë, Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 105 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Ju njoftoj se në sallë ishin dhe janë 107 deputetë.

Votojmë për marrëveshjen e katërt, Ratifikimi i Marrëveshjes në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt an Main dhe Kompanisë së Ujësjetllësit Regjional të Prishtinës.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 105 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt an Main dhe Kompanisë së Ujësjetllësit Regjional të Prishtinës.

Ratifikimi i Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 104 vota “për”, një “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës të Madh të Luksemburgut.

Dhe kemi marrëveshjen e gjashtë dhe të fundit. Votojmë tash:

Konstatohet se me 103 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Dhe, nëse jeni dakord, e marrim një pauzë prej 15 minutash, për të filluar me pikën e shtatë - debat. Besoj që jeni dakord.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, të mbështetur nga deputetë të tjerë

Deputeti Nait Hasani dhe grupi i deputetëve nënshkruar ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar për gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, informata për këtë çështje kanë dërguar zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi dhe ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi.

Radha e paraqitjeve është kështu: Deputeti Nait Hasani, në cilësinë e propozuesit paraqet arsyetimin e kërkesës për debat. Ftoj deputetin Nait Hasani, që ta marr fjalën.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kërkesën time për debat parlamentar për siguri dhe sundim të ligjit, të mbështetur edhe nga grupi i deputetëve, është kërkesë që ky Kuvend ka pasur nevojë ta trajtojë më

herët, por edhe sot nuk është vonë, për një përfundim të mendimit dhe gjykimit politik pas debatit të deputetëve.

Kjo kërkesë për një seancë parlamentare për çështjen e sigurisë dhe të sundimit të ligjit në Kosovë vjen si rezultat i shumë çështjeve të pazgjidhura dhe të vendosura keq ose me ose pa qëllim, edhe pse në politikë asgjë nuk ka pa qëllim.

Çështjet e sundimit të ligjit dhe siguria në Kosovë janë çështje që i preokupojnë të gjithë qytetarët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët vërtet e duan të mirën e vendit tonë.

Për debat kam paraqitur këto çështje shumë të rëndësishme për ne, për të ardhmen e vendit e të rajonit: siguria, ligji, drejtësia. Mos respektimi i institucioneve të Kosovës nga EULEX-i, mostransparenca e EULEX-it për punën që bën në Kosovë dhe standardet e dyfishta të vendosura në Kosovë nga UNMIK dhe tash nga EULEX-i, një standard për shqiptarë, tjetër për serbët.

Të nderuar deputetë,

EULEX-i ka ardhur me ftesë të institucioneve të Kosovës, ku edhe ne jemi pjesë e tyre, të zgjedhur me votën e qytetarëve të Kosovës, për ta vendosur sigurinë, sundimin e ligjit, drejtësinë dhe doganat në Kosovë.

Në këto fusha EULEX-i nuk ka arritur ta realizojë misionin e vet, për të cilën është përgjegjës. Jemi dëshmitarë se kufijtë e Kosovës me Serbinë nuk janë të siguruar. Në ato pika kufitare cenohet dhe shkelet kufiri ditën dhe natën me të gjitha mjetet teknike, motorike dhe në këmbë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë dhe bandat kriminale, trafikantët e drogës, trafikantët të qenieve njerëzore, kontrabandistë të mallrave dhe dilerë të pastrimit të parash. Atje është krijuar korrupsioni dhe nga administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut, dhe e EULEX-i tash. Atje nuk po luftohen këto dukuri nga faktori ndërkombëtar për sundimin e ligjit dhe sigurisë, EULEX. Për këtë jemi dëshmitarë të cenimit të sigurisë së njerëzve nga organet dhe strukturat paralele të Serbisë në Kosovë dhe të MUP-it e të BIA-s serbe. Pra, jem dëshmitarë të rasteve të shumta ku është cenuar e dhunuar siguria fizike dhe private e shqiptarëve dhe pasuria e tyre është djegur e shkatërruar nga strukturat paralele legale serbe. Është e shkelur Kushtetuta e Kosovës. Ndërsa EULEX vetëm ka bërë sehir, duke lejuar maltretimet e dëbimet nga shtëpitë e tyre që nga viti '99 e deri më sot.

Atje EULEX jo vetëm që nuk ka siguruar punën dhe sigurinë e gjyqtarëve e të prokurorëve të Gjykatës së Qarkut në veri të Ibrit, mjerisht, dhe vetë EULEX nuk guxon të dalë në veri pa marrë lejen nga organet dhe strukturat paralele serbe të instaluar nga Serbia e të siguruar nga MUP-i, BIA-a dhe snajperistët serbë të vendosur nëpër ndërtesa banimi, buzë Ibrit dhe në veri të tij.

Të nderuar deputetë, ministra,

Kjo nuk është e tëra. EULEX, si UNMIK-u dikur, kur flitet për shqiptarët ka tjetër tretman politik. EULEX jo në bazë të misionit të Bashkimit Evropian, të përfaqësuar në vlerat demokratike të demokracisë perëndimore, por në bazë të drejtuesve që e drejtojnë

EULEX-in në Kosovë, ka për qëllim ta degradojë çdo vlerë shqiptare. EULEX është duke luftuar vlerat tona kombëtare, luftën tonë të shenjtë për çlirimin e Kosovës nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. UNMIK-u dhe EULEX-i duke arrestuar dhe dënuar me vite ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kinse për krime kundër njerëzimi, e barazojnë luftën tonë çlirimtare me krime dhe gjenocidin serb. Fatkeqësisht, para kësaj dukurie institucionet tona heshtin dhe e lejojnë degradimin moral e politik.

Në Kosovë ende enden ish ushtarët e oficerët serbë, tashmë civilë të vendosur në institucione të EULEX-sit dhe të Policisë së Kosovës. Ata kanë vrarë e ther me thikë, bajoneta dhe kanë prerë me motosharra mbi 20 mijë civilë shqiptarë, kanë djegur dhe kanë plaçkitur mbi 100.000 shtëpi të shqiptarëve dhe i kanë dëbuar me dhunë rreth një milionë shqiptarë gjatë luftës. Për serbët, EULEX-i ka tretman e standarde të dyfishta, për dallim nga shqiptarët i dënon menjëherë. Ata gjoja kujdesen ta ruajnë qetësinë e stabilitetin politik në Kosovë, por në fakt lejojnë të shëtisin kriminelët e bandat serbe nëpër Kosovë. Këtë e dëshmon edhe arrestimi i tre kriminelëve serbë të BIA-s së Serbisë Predrag Zhelković, Milutin Radanović dhe Igor Joshinac, që ka qenë policë serb në Policinë e Kosovës, të akuzuar dhe të mbajtur në burg për 6 muaj me akuzë për blerje dhe mashtrim, për heqje veshkash gjatë luftës në Kosovë, duke i afruar një shqiptari 50 mijë euro. Lirimi i tyre pa asnjë arsyetim u bë pas 6 muajsh. Duke u bazuar në këto mashtrime e në kesi kriminelesh, është hartuar edhe raporti i Dick Martit për transplantim të organeve njerëzore dhe CD e famshme e rastit Bllaca e Nazmi Bllacës, me qëllim që të inkriminohet lufta jonë e shenjtë.

EULEX ka arrestuar këto ditë ata që kanë luftuar për lirinë e vendit të vet, ka arrestuar komandantin rajonal të Prizrenit Nexhmi Krasniqin dhe të tjerë për kinse krime kundër njerëzimit gjatë luftës në Kosovë. E vërteta është se Nexhmi Krasniqin e të tjerët EULEX i ka arrestuar me porosi të BIA-s e të MUP-it të Serbisë për hakmarrje, sepse komandanti regjional dhe drejtori i Policisë së Kosovës, Nexhmi Krasniqi, i ka arrestuar kriminelët e BIA-s Predrag Zhelkovićin, Milutin Radanovićin dhe Igor Johinacin. Për këtë rast mund të shihni në dosjet e prokurorisë dhe presioni që u është bërë organeve hetuese për t'i liruar këta kriminel pa u gjykuar, me urdhër të prokurorit të EULEX-it.

Të nderuar deputetë,

Në Kosovë me këso veprash inkriminuese nga EULEX dhe nga strukturat paralele e kriminale dhe bandat serbe, që veprojnë të lira në territorin e Kosovës, është kërcënuar siguria dhe jeta individuale e kolektive e qytetarëve tanë. Ata në këto kushte nuk kanë mundësi të mbrohen nga mbajtësit e rendit dhe të sundimit të ligjit.

Ky mision i Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX, që kinse për qëllim të sundimit të ligjit, rendit e drejtësisë në Kosovë, e shkel dhe e thyen çdo etikë e kodeks politik, duke hyrë nëpër institucionet e Kosovës, në Ministrinë e Transportit, Postë - Telekomit të Kosovës, të armatosur me armë të gjata automatike, ndërsa këso... skena, raste ke mundur të shohësh vetëm në grusht shtetet apo puçe ushtarake të bëra në shtetet e Afrikës. Kjo ka ndodhur nga EULEX për të dëshmuar forcën e vet ushtarake dhe politike, për të na treguar neve se në Kosovë nuk ka institucione të Kosovës, por ka EULEX. Kjo ka ndodhur për të prishur imazhin e Kosovës para Bashkësisë Ndërkombëtare me kërkesë të

Serbisë e politikës serbe, që Serbia ta përfitojë politikisht nga mos stabiliteti i Kosovës me për afrimin e marrëveshjes së stabilizim - asocimit me BE-në. Këto kontrole që u bënë në institucione të Kosovës nga EULEX, edhe pas një viti hetim nuk ka mundur të dëshmojë asnjë akuzë për veprime antiligjore të institucioneve në prokurori, por me këto veprime EULEX dhe ICO në Kosovë sillen si mbretër të perandorive mesjetare në mesjetë, duke emëruar e shkarkuar, vendosur drejtorë e guvernatorë të përfshirë së bashku vendorë e ndërkombëtarë në korrupsion e në krim ekonomik.

Tashmë duhet të pyesim, a ka transparencë EULEX për punën që bën në Kosovë? Cila është transparenca e EULEX-it ndaj qytetarëve? Transparenca e EULEX-it është dhe del në shesh e bëhet publike për punën e veprimet e veta që bën në Kosovë vetëm kur ndonjë nga misionet ose misionarët e EULEX-it, si Leu, i fyen e nënçmon ndjenjat tona njerëzore e kombëtare, duke luajtur me simbolet tona të shenjta, duke fyer skajshmërisht dinjitetin moral e politik, apo Kaposela, që tashmë deklaroi pasi është prishur me Përfaqësuesin Special Piter Feith për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore, i cili ishte i preferuari i Piter Feith, deklaroi se: “Një nga zyrtarët e kanë bërë kurban” dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë bëjnë politikë. Ata kanë torturuar qytetarët e Kosovës me deklaratat e tyre politike në shtyp e televizione se sot apo nesër do të arrestohet ky apo ai ministër, se jemi në hetim të rasteve të caktuara, se do të arrestohen peshqit e mëdhenj. Kjo tregon se qëllimi i EULEX-it nuk është drejtësia e sundimi i ligjit, por misioni i Serbisë e i politikës serbe në Kosovë. Kjo tregon se EULEX-i është i shndërruar në mjetë mekanizëm propagandistik, politik për të torturuar qytetarët dhe institucionet e Kosovës politikisht, duke ulur autoritetin politik para qytetarëve të saj e bashkësisë ndërkombëtare.

EULEX-si nuk është i interesuar të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën!

NAIT HASANI: EULEX-s nuk është i interesuar të vendosë sigurinë, rendin dhe sundimin e ligjit në doganat në Kosovë, sepse EULEX lejon banda kriminale, krim ekonomik, trafikim të qenieve njerëzore, pastrim të parave, korrupsion, ndërsa UNMIK, EULEX kanë hyrë në bashkëpunim në inkriminime joligjore me strukturat paralele serbe në dëme të Kosovës, duke shkaktuar humbje të pallogaritshme ekonomike në mallra të pa doganuara. EULEX ka lejuar dhe lejon, këtë e thotë edhe ministri i Punëve të Brendshme, strukturat paralele serbe në territorin e Kosovë për përfitime të përbashkëta materiale. A ka ardhur EULEX-i për vendosjen e ligjit në Kosovë? Nëse po, pse nuk i shkatërron bandat kriminale dhe strukturat paralele në veri? Kurse ministri i Drejtësisë kërkon partneritet me EULEX-in, po si mund të ketë partneritet me EULEX-in që ka ardhur për ta na sunduar, e jo për të vendosur rend dhe ligj, siguri në doganat në Kosovë.

Por, EULEX duhet të kuptojë, e këtë mund ta bëjë ky Kuvend, ju deputetë të nderuar, me votën tuaj duke nxjerrë një rezolutë apo rekomandime që EULEX duhet të dijë se në Kosovë ka një parlament që merr vendime dhe ka një Qeveri e institucione të sigurisë, të

rendit dhe të drejtësisë të afta për të vendosur siguri, rend dhe ligj, për të vendosur drejtësi për të gjithë, të barabartë para ligjit, pa dallim etnie, race, feje e gjinie.

Dhe, në fund, unë mendoj se EULEX në Kosovë mund të qëndrojë vetëm duke luajtur rolin e këshillëdhënësit për institucionet e Kosovës. Në të kundërtën, EULEX është kundraproduktiv, i tepërt në Kosovë sepse nuk ka arritur misionin për çka ka ardhur në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Unë kërkoj nga ju që për çështjen e sigurisë, rendit, ligjit e doganave të jepni edhe ju kontributin e juaj në debat, me rekomandime që do të jepni të nxjerrim afate kohore për institucionet e Kosovës dhe EULEX-in, për vendosjen në gjithë territorin e Kosovës sigurinë, rendin, ligjin, drejtësinë dhe për eliminimin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

Në bazë të kësaj, kemi nxjerrë rekomandimet:

- Vendosija e ligjit dhe e kushtetutshmërisë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës,
- Kërkohej nga gjithë institucionet e Republikës së Kosovës dhe Misioni ndërkombëtar në Kosovë që të respektohet kushtetuta dhe ligji në fuqi.
- Kërkohej nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare që në mënyrë urgjente të ndërmarrin hapa konkretë në shpërndarjen e strukturave të aparatit shtetëror të Serbisë në Kosovë.
- Kërkohej nga Misioni ndërkombëtar të bëjë implementimin e Planit të Pakos së Ahtisarit edhe në pjesën veriore të Kosovës.
- Propozoj që të formohet një delegacion nga Parlamenti i Kosovës, të shkoj në Bruksel e në Parlamentin Evropian për t'i prezantuar të gjitha këto shqetësime lidhur me punën e EULEX-sit. Kjo është në interes të Bashkimit Evropian dhe të Kosovës por edhe vetë të EULEX-it. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Hasani!

Fjalën ia kisha dhënë zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, zotit Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që shkurtimisht të japë një informatë për situatën e rendit dhe të ligjit nga prizmi i Ministrisë së Drejtësisë, duke pas parasysh dy kritere: e para, kompetencat që i ka Ministria e Drejtësisë, pra pa prekur atë që quhet pavarësi gjyqësorit dhe prokurorisë dhe, në anën tjetër, mandatin që e kam prej 22 prill deri më sot.

Të nderuar deputetë,

Ministria e Drejtësisë, si bërëse kryesore e politikave të cilat drejtojnë sistemin e drejtësisë, ka renditur bashkëpunimin dhe koordinimin e sistemit të drejtësisë, konkretisht

atë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me Këshillin Prokurorial, me Gjykatën Supreme dhe institucionet tjera ndërkombëtare të drejtësisë, si prioritete të saja.

Bashkëpunimet e para me këto institucione kanë filluar në drejtim të implementimit të 4 ligjeve bazë, të cilat janë miratuar në vitin e kaluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sikur që janë: Ligji për gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor për Republikën së Kosovës, Ligji për prokurorinë e shtetit dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Tashmë janë nënshkruar memorandumet për bashkëpunim me Këshillin Prokurorial për transferimin e plotë të personelit, dosjeve dhe aseteve nga Ministria e Drejtësisë të Këshilli Prokurorial, në përputhje me ligjin dhe me këshillin, si dhe në fazën e rekrutimit të 45 prokurorëve, të cilët priten që drejtpërdrejt me punën e tyre të ndikojnë në luftimin e kriminalitetit dhe sundimin e ligjit në vendin tonë.

Po në këtë drejtim është themeluar Këshilli konsultativ për drejtësi, në të cilin këshill pritet që të marrin pjesë bartësit e institucioneve të drejtësisë, të Qeverisë, të Kuvendit të Republikës, të Presidentit, përfaqësuesi ndërkombëtar civil nga EULEX-i, OSBE, organet gjyqësore dhe prokuroriale të Republikës së Kosovës, si dhe nga universiteti dhe shoqëria civile. Qëllimi kryesor i këtij këshilli është avancimi i sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe sundimin e ligjit, të zbatimit të strategjive të organeve gjyqësore dhe prokuroriale dhe të sistemit në tërësi të drejtësisë në Kosovë, duke siguruar kushte, por edhe duke propozuar dhe marrë masa të veçanta në fushën e gjyqësisë dhe të prokurorisë për të sunduar rendi dhe ligji në Republikën e Kosovës.

Në ndërkohë, me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjyqësisë në përgjithësi, në mes të tjerash është hartuar strategjia nacionale për reduktimin, gjegjësisht zvogëlimin e lëndëve të mbetura nga vitet e kaluara në gjykata. Midis tjerash, Ministria e Drejtësisë ka themeluar edhe Inspektoratin e Shërbimit Korrektues të Kosovës me qëllim të ngritjes së masave të sigurisë në burgjet e Republikës së Kosovës dhe respektimin e plotë të të drejtave të burgosurve.

Themelimi i këtij inspektorati do të përshpejtojë angazhimet e Ministrisë së Drejtësisë në parandalimin dhe adresimin efektiv të të gjitha rasteve potenciale dhe shkeljeve të supozuara të të drejtave nga stafi i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ministria e Drejtësisë ka sponsorizuar dhe me vendim të Qeverisë është themeluar Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë që nga viti '90 deri në vitin '99, i cili do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Qëllim parësor i këtij instituti është koordinimi, përcjellja dhe hulumtimi i krimeve të luftës kundër paqes, krimit të gjenocidit dhe shkelje tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare që kanë ndodhur ndaj popullit shqiptarë nga viti '90 deri në vitin '99.

Ky institut në punën e tij të përditshme do të ketë qëllime të drejta të parashtruara dhe do të jetë përgjegjës edhe për bashkëpunimin me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare.

Ndonëse pas një pune të vazhdueshme, në periudhat e fundit Qeveria e Kosovës ka arritur që të bëjë riparimin e objekteve të gjykatave në veri, në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për punë. Funksionalizimi i tyre i plotë mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të sundimit të rendit dhe të ligjit në Republikën e Kosovës.

Në takime të vazhdueshme javore, të mbajtura në mes të Qeverisë së Kosovës, përfaqësuesve të komponentës së drejtësisë së EULEX-it dhe shteteve anëtare të Kuint-it është fuqizuar nevoja dhe ideja e punës sonë që në mënyrë intensive të kemi kthimin e gjyqtarëve në veri të Republikës së Kosovës dhe funksionalizimin e gjykatave në kuadër të sistemit të drejtësisë të vendit tonë, të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës. Kjo çështje është diskutuar dhe vazhdon të diskutohet edhe në takime të rregullta të Bordit bashkërendues për sundimin e rendit dhe të ligjit.

Edhe përkundër punës së vazhdueshme dhe ofrimit të kapaciteteve të plota të Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe të adoptimit të ligjeve të reja, pengesat e hasura jo domosdoshmërisht nuk janë të natyrës juridike apo kryekëput do të thosha janë të natyrës politike, kërkohet një mobilizim më i gjerë i të gjitha strukturave të sistemit të drejtësisë në vend, por edhe një ndikim më i madh i faktorëve me ndikim për sundimin e rendit dhe të ligjit në Republikën e Kosovës.

Veç kjo situatë është e karakterit tejte të ndjeshëm politik. Ministria e Drejtësisë kërkon edhe njëherë nga EULEX-i që të angazhohet dhe të asistojë fuqishëm drejt kthimit të personelit vendor në veri, në mënyrë që të kthehet dhe të mundësohet kryerja e funksionimit vital të zbatimit të së drejtës në gjithë Republikën e Kosovës, me theks të veçantë në ato tri komuna.

Ministria e Drejtësisë tanimë në takimet e rregullta me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kryeprokurorin e shtetit në çdo rast ka shprehur gatishmërinë që të kthehet personeli vendor atje dhe t'i ketë kushtet maksimale për punë.

Ministria e Drejtësisë ka një koordinim të vazhdueshëm me EULEX-in, me Komisionin ICO, USAID dhe mekanizma tjerë ndërkombëtarë, me të cilët ndër të tjera bisedon edhe për procesin e transformimit të kompetencave në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit nga EULEX-i tek institucionet vendore.

Një prej qëllimeve tjera të Ministrisë së Drejtësisë është ndërtimi i infrastrukturës ligjore. Duke pasur parasysh se kjo është një ndër kompetencat apo do të thosha pikërisht është hartimi dhe operacionalizimi i politikave. Veprimtaria kryesore e Ministrisë së Drejtësisë është fokusuar në ndërtimin e mëturshëm të infrastrukturës ligjore dhe përmirësimin e asaj ekzistuese.

Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë ka paraparë që deri më 30 shtator të vitit 2011, t'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës gjithsej 10 ligje, të cilat drejtpërdrejt do ta rrisin efikasitetin dhe do të përmirësojnë jetën juridike në Republikën e Kosovës. Ligjet të cilat planifikohen që të procedohen gjatë kësaj kohe në Kuvendin e Kosovës do të jenë: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të

interesit në ushtrimin e funksionit publik, Projektligji për mbrojtjen e informatorëve apo personave raportues, Projektligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë përmbartimore, Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ekstradim dhe transferimin e të dënuarve, Projektligji për detyrimet, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale, Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe tanimë është proceduar Projektligji për amendamentimin e Ligjit të noterisë.

Në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, Kosova deri më tani qoftë përmes shkëmbimit të shkresave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ministria e Drejtësisë apo edhe përmes ratifikimit të marrëveshjeve që janë marrë përsipër, marrëveshjet e ish Jugosllavisë me shtete të ndryshme, ka arritur që të lidhë marrëveshje për ekstradim me Austrinë, Çekinë, Belgjikën, Britaninë e Madhe, Irlandën, SHBA-të dhe në fazën e fundit është në marrëveshje me Shqipërinë, Turqinë dhe Gjermaninë. Gjithashtu, përveç marrëveshjeve për ekstradim, Ministria e Drejtësisë ka lidhur marrëveshje edhe me Ministrinë e Drejtësisë së Maqedonisë dhe ka nënshkruar marrëveshje për transferimin e personave të dënuar dhe bashkëpunimin gjyqësor në çështje penale.

Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2010 dhe 2011 ka propozuar afër 80 propozim marrëveshje me shtete të ndryshme, të cilat pret që t'i konkretizojë në kohën dhe në vitin në vijim.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të përfundoj duke thënë që angazhimi i Ministrisë së Drejtësisë për rend dhe ligj, koordinimi i sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, plotësimi i legjislacion dhe harmonizimi i tyre me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kriteret e BE-së, funksionalizimi i gjykatave në tërë territorin e Republikës së vendit, fitimi i besimit të drejtësisë te qytetari të vendi dhe trajtimi i tyre pa dallim, forcimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe tranzicioni gradual i kompetencave nga EULEX-i në institucionet e Kosovës do të jenë prioritete dhe angazhime permanente të Ministrisë së Drejtësisë.

Unë jam i hapur edhe për pyetjet dhe për trajtime që mund t'i keni ju, të nderuar deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë!
Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Ne po ashtu kemi dërguar një raport edhe në bazë të kërkesës së deputetit Nait Hasani, të mbështetur nga deputetët tjerë, por edhe me Kryesinë e Kuvendit, ku ka edhe të dhëna statistikore. Megjithatë, desha që t'ju marrë 4 – 5 minuta dhe të bëj pak një elaborim të

gjendjes së sigurisë dhe pastaj, si tha edhe ministri i Drejtësisë, do të jemi në dispozicionin tuaj për pyetjet që mund t'i parashtroni.

Gjendja e përgjithshme e sigurisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës është e qetë dhe stabile, por mund të klasifikohet në suaza të brishtësisë, sidomos në pjesën veriore të vendit, por e gjithë kjo nën kontroll, si rezultat i angazhimit të të gjitha institucioneve përgjegjëse të sigurisë, duke filluar nga Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i, të cilët janë duke u angazhuar në ruajtjen e rendit dhe të situatës së sigurisë në këtë rajon, por edhe në tërë Republikën e Kosovës.

Marrëdhëniet ndëretnike në vend kanë shënuar një ngritje në nivel të vendit, mirëpo në pjesën veriore të Kosovës këto marrëdhënie janë në një nivel të ulët dhe herë pas here paraqiten tensione ndëretnike, të cilat shkaktohen nga incidentet të inskenuara nga grupet kriminale, të cilat janë të koordinuara me strukturat ilegale të sigurisë që veprojnë në veri të Kosovës, të financuara nga Qeveria e Serbisë.

Përkundër faktit se me ligjet pozitive në Kosovë, si dhe me trajtimin e këtyre çështjeve nga ana e institucioneve, të drejtat dhe liritë e komuniteteve pakicë janë më të avancuara në rajon, politika zyrtare e Serbisë po ndikon te komuniteti serb përmes formave të ndryshme që të mos pranojnë të integrohen në institucionet kosovare, duke mos pranuar realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Ky presion ndaj popullatës serbe është më i theksuar në pjesën veriore të Kosovës, e cila pjesë e vendit po mbahet nën tension.

Vlen të theksohet që në krahasim me vitet paraprake, sidomos para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, liria e lëvizjes së komuniteteve ka shënuar një përmirësim të dukshëm. Në Republikën e Kosovës individë dhe grupe ekstremiste në vazhdimësi me aktivitetet e tyre po tentojnë në ngrenë tensionet dhe të shkaktojnë një pasiguri tek qytetarët e Kosovës. Këto grupe janë shumë aktive, sidomos në veri të Kosovës, dhe janë të ndërlidhura me strukturat ilegale dhe me krimin e organizuar, ku si shkak i mosfunksionimit të ligjshmërisë dhe kontrollit joefikas nga organet shtetërore të Kosovës këtu është duke u zhvilluar kontrabandë me mallra të ndryshme, që ndikojnë negativisht në buxhetin e Kosovës dhe në zhvillimin ekonomik.

Edhe përkundër faktit se nga Policia e Kosovës janë ndërmarrë masa për parandalimin e aktiviteteve kriminale, zbulimin dhe vënien para organeve të drejtësisë të personave të dyshuar për këto raste, krimi i organizuar edhe më tutje paraqet një sfidë për mekanizmat e sigurisë në vend.

Llojet e ndryshme të krimit të organizuar, si kontrabanda me emigrantë, trafikimi me genie njerëzore, trafikimi me lëndë narkotike, tregtia me armë, korrupsioni dhe veprat tjera krijojnë një pasiguri tek qytetarët e vendit dhe paraqesin një imazh jo të mirë për vendin.

Institucionet e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim edhe me faktorin ndërkombëtar, janë angazhuar maksimalisht për krijimin e një infrastrukture ligjore dhe të dokumenteve strategjike të cilat kanë për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve

kosovare, me theks të veçantë të atyre të rendit dhe sigurisë, në luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë kontest, duhet veçuar disa nga dokumentet strategjike, si strategjia nacionale kundër krimit të organizuar, strategjia nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore, strategjia nacionale kundër narkotikëve, strategjia nacionale kundër terrorizmit, si dhe dokumentet tjera strategjike, të gjitha këto dhe me planet vepruese që i precizojnë më mirë obligimet dhe detyrat që dalin nga këto strategji.

Gjendja në kufijtë e Republikës së Kosovës paraqitet e qetë edhe përkundër faktit që në disa zona, në vijën e gjelbër, për shkak të kontrollit jo në nivelin e duhur është lehtë i kalueshëm dhe shfrytëzohet për kontrabandim.

Në kufijtë e Kosovës gjendja më e rëndë paraqitet në veri të vendit, pasi aty ushtrohet një kontroll sipërfaqësor nga organet e rendit dhe, si pasojë e kësaj gjendje, po vazhdojnë kontrabandat e ndryshme, të cilat përveç që ndikojnë negativisht në buxhetin e Kosovës, ato mallra paraqesin edhe një rrezik potencial për shëndetin e popullatës dhe mjedisit pasi që ato mallra nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli.

Dukuri e cila e kërcënon sigurinë nacionale është edhe migrimi ilegal i shtetasve nga shtetet e Azisë dhe Afrikës veriore, të cilët për shkak të krizave ekonomike të Greqisë dhe ndryshimeve politike dhe krizave tjera në Azi dhe Afrikë, po migrojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian, ku territori i Republikës së Kosovës shfrytëzohet si transit. Nuk përjashtohet mundësia që këta persona të kenë një të kaluar kriminale dhe mund të paraqesin një rrezik potencial për sigurinë e përgjithshme të vendit.

Mirëpo, në përgjithësi mund të thuhet që institucionet e Kosovës, përkatësisht Policia e Kosovës është mjaftë e aftë dhe e përgatitur që të kujdeset për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe ruajtjen e kufijve shtetërorë.

Niveli i gatishmërisë së Policisë së Kosovës për të marrë përgjegjësi të reja në aspektin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe ruajtjen e kufijve shtetërorë është vlerësuar lartë edhe nga Misioni Paqeruajtës i KFOR-it në Kosovë përmes transferimit të përgjegjësive nga KFOR-i tek Policia e Kosovës, në ruajtjen dhe menaxhimin e vijës kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Policia kufitare në vitin 2010 ka marrë përgjegjësinë e plotë të sigurisë së kufirit në pjesën me Republikën e Shqipërisë, në gjatësi prej 113.5 kilometra. Në vitin 2011 Policia kufitare ka marrë përgjegjësinë e dy sektorëve të parë në kufirin me Maqedoninë, në gjatësi prej 121 kilometri, sektori i tretë i fundit pritet të merret gjatë qershorit, konkretisht diku kah 17 qershori, pra komplet kufiri me Maqedoninë.

Ndërkohë kanë filluar përgatitjet për marrjen e përgjegjësive për menaxhimin e vijës së gjelbër të kufirit me Republikën e Malit të Zi. Është gatishmëria e KFOR-it që deri në shtator të këtij viti të merret po ashtu përgjegjësia nga Policia e Kosovës dhe është në

procedurë çështja e demarkacionit të kufirit, duhet nota verbale nga Ministria e Jashtme, komisioni i gatshëm edhe me Malin e Zi do të kryhet brenda këtij viti.

Si konkluzion, Republika e Kosovës viteve të fundit ka shënuar progres të dukshëm në aspektin e sigurisë dhe sundimit të ligjit. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e ngritjes së nivelit të profesionalizimit të institucioneve të rendit, të sigurisë, në radhë të parë të Policisë së Kosovës, por edhe si rezultat i përkrahjes dhe ndihmës së vazhdueshme nga faktori ndërkombëtar në Kosovë.

Sidoqoftë, për Ministrinë e Punëve të brendshme një sfidë që mbetet për t'u adresuar në një trajtë të përditshme, është sundimi i rendit dhe ligjit dhe luftimi i krimit të organizuar në pjesën veriore të vendit, gjithnjë duke ndërtuar qasje partneriteti dhe bashkëpunimi me të gjitha agjensionet e zbatimit të ligjit me ato vendore dhe ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën. I le të përgatitet deputeti Ismet Beqiri.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron të domosdoshëm këtë diskutim parlamentar që ka për qëllim të evidencojë lëshimet e mundshme të institucioneve, qoftë të atyre vendore apo ndërkombëtare.

Po ashtu, e vlerësojmë të drejtë dhe të domosdoshëm insistimin tonë që të kërkojmë qoftë nga institucionet vendore, apo ato ndërkombëtare që të rrisin ndikimin e tyre, angazhimin e tyre drejt shtrirjes dhe krijimit të kushteve që në tërë territorin e Kosovës të mbretërojë rendi dhe ligji, duke e përfshirë këtu edhe veriun e Kosovës, i cili është bërë pika më e ndjeshme e jona.

EULEX-i duhet të marrë në konsideratë insistimin tonë të pakontestueshëm që ne të insistojmë dhe të kërkojmë që rendi dhe ligji të mbretërojë edhe në veriun e Kosovës. Por, kjo nuk do të thotë se ne jemi kundër bashkëpunimit. Përkundrazi, ne jemi për një bashkëpunim, thellim edhe më të madh të bashkëpunimit me të gjitha institucionet ndërkombëtare, qoftë të Bashkësisë Evropiane, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që njëkohësisht janë edhe një prioritet i yni nacional dhe shtetëror për të aderuar në Bashkimin Evropianë dhe në NATO. Në këtë drejtim, deputetë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike gjatë këtij debati do ta japin kontributin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si grup parlamentar, pa dyshim do të jenë disa diskutues të cilët do të debatojnë sot rreth kësaj kërkesë që është për t'u debatuar, duke përfshirë zotin Demolli, po e përmendi qëllimisht dhe zotin Quni, por edhe të tjerët. Por, fillimisht më lejoni t'i them disa çështje në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

U përmendën disa nga çështjet që i kemi dhe janë të shkruara në materialin e ministrit të Punëve të Brendshme. Ajo që mund të them me përgjegjësi të plotë, është që disa nga këto strategji janë vetëm në letër, fatkeqësisht, me gjithë vullnetin dhe është mirë që të bëhet diçka më tepër në këtë drejtim.

Siguria dhe sundimi i ligjit, me gjithë disa nga rezultatet që s'mund të mohohen, padyshim që është larg asaj që e dëshirojmë dhe e meritojmë edhe si qytetarë, edhe si shtet.

U përmendën edhe në dy fjalët e mëhershme që i kishin dy ministrat. Veçmas ajo që është shqetësuese për ne, është siguria në veri të Kosovës, kur mendohet në veri të Kosovës duhet ta kemi të qartë që nuk ka të bëjë vetëm me Mitrovicën, por me disa komuna ku sundon shumica serbe dhe atë me autoritet dhe kompetenca dhe me obligime karshi ligjit dhe në shërbim të ligjit serb dhe të Serbisë. Nëse vlerësohet se atje është situata që u tha e qetë dhe e brishtë, mund të vlerësohet si e tillë nga fakti se atje nuk qeverisin dhe s'kemi asnjë institucion të mirëfilltë vendor. Për këtë, mund të themi se është e qetë, por jo se është e qetë se sundon ligji, ka siguri veçmas qytetarëve të Kosovës që janë të përkatësisë shqiptare.

Dy çështje që vërtetë mbeten shqetësuese dhe në asnjë mënyrë nuk mund të jenë alibi për atë se e ka kompetencë, këtë rast po e marrim EULEX-i, është thënë disa herë, vjedhja e dëshmive në dhomën e dëshmisë ose të dëshmive është shqetësuese. Çfarë sigurie mund të kërkojnë qytetarët tanë, kur ata që janë të obliguar të na sigurojnë dhe të ruajnë këtë vend, para syve të tyre, dhashë zoti që të mos jetë kështu që bashkë me ta i vjedhin ato dëshmi, dikë prej tyre, këtë mos e merrni akuzë, por kjo është realitet që ka ndodhur dhe kjo, si e tillë, asnjëherë derisa të zbulohet, nuk guxon të thuhet se është mbyllur nga kushdo qoftë. Po e përsëris, nuk mund të jetë asnjë mënyrë alibi të thuhet se këtë e ka EULEX-i. Po ashtu, përgjegjësia jonë nuk mund të anashkalohet as tek çështja e mbrojtjes së kufijve, as tek çështja e mos zbulimit të shumë e shumë rasteve, pse edhe jo të përkatësisë ose në rastet kur më së shpeshti janë viktimat shqiptarët nga ekstremistët serbë dhe raste të tilla kemi përplot. Ne asnjëherë si Parlament, si Qeveri nuk e kemi trajtuar në mënyrën më serioze të duhur këtë, për të cilën realisht me vite të tëra mungojnë edhe dënimet për njerëz të tillë, jo vetëm të krimit të vrasjeve të natyrës edhe politike, por edhe të vrasjeve, nëse mund të thuhet të gjithë qytetarët tanë, kur ka të bëjë me krimin e organizuar dhe të korrupsionit.

Rasti i djeshëm, që nuk dëshiroj në asnjë mënyrë ta politizoj, por po e them me përgjegjësi të plotë, që asnjëherë LDK-ja nuk ka qenë dhe nuk është që të mos hetohen rastet kur ka bazë për dyshim të natyrave të ndryshme. Kemi qenë dhe jemi që institucionet tona të jenë organe kompetente, këtë ta bëjnë. Por, duhet vepruar njësoj, duhet të jenë në nivel të detyrës njësoj, të mos përdorim arshinë të ndryshme. Rasti i

djeshëm në Prishtinë është dëshmia më e mirë se ajo që nuk mund të fitohet me votë, tentohet edhe në këtë mënyrë të dhunohet puna në një institucion i cili është në shërbim të qytetarëve. Nuk mund të ketë siguri të punëtorëve të komunës nëse gjatë ditës defilojnë makina të policisë gjatë gjithë kohës. Kushdo qoftë nën hetime, është mënyra se si bëhet kjo. Nuk bëhet me defilime dhe realisht sikur krijohen kordone policish, siç po ndodhë në Prishtinë ose siç ka ndodhur. Dhe rasti i djeshëm, me një shpejtësi marramendëse e dhënies së 30 ditëve burg për disa zyrtarë të komunës së Prishtinës, tentohet të thuhet se është një sukses. Unë vetëm po ju drejtohem, sepse është opinionimi publik që na shikon. Urdhëroni, hetoni njerëz që janë pasuruar brenda ditës, edhe këtu nëse jemi, kushdo qoftë. Urdhëroni, hetoni njerëz që bënë brenda ditës xhipa, troje, shtëpi marramendëse, me çmim marramendës, hetoni dhe ne do t'ju përkrahim, kushdo qoftë ai. Hetoni, por këtë nuk jeni duke bërë, nuk jeni duke e bërë, sepse dikujt i konvenon kjo. Edhe unë kam qenë kryetar komune, me rrogë. Harrojeni, të nderuar deputetë, që dikush i bënë këto, që dikush i ka bërë. Harrojeni, se kjo nuk mund të ndodhë asnjëherë.

Dhe, për t'ju lënë hapësirë kolegëve që do të ju thonë në mënyrë shumë taksative vërejtjet që i kanë edhe në mënyrë profesionale, më lejoni vetëm të them këtë, me rastin e Prishtinës po e përfundoj. Urdhëroni, shkoni në Thesarin e Kosovës, ku bëhen pagesat, shikoni sa pagesa janë bërë në fund të vitit me miliona euro ndoshta brenda 3 – 4 ditëve, janë bërë pagesa edhe për punët e pakryera, janë bërë pagesa edhe për punët që s'kanë filluar fare. Urdhëroni, nëse këto nuk janë bazë e hetimit, ku flasim me miliona euro, atëherë çfarë t'i themi një rasti, i cili nëse ka bazë, edhe një herë po e përsëris, ne i përkrahim organet e hetuesisë, por nuk përkrahim tentimin e rrëshqitjes së Kosovës në një shtet, në një shtet policor. Nuk e meritojmë këtë, le t'i kryejnë organet e veta secila punën e vet, por po e përsëris, shkoni në Thesar, shikoni çfarë ka ndodhur vitin e kaluar, hiq më larg, me pagesa të tilla dhe mos përdorni arshinë të ndryshëm, bile, bile edhe shumë më të rënda raste se sa kjo që ka qenë dje në komunën e Prishtinës. Mos pengoni ata që dëshirojnë të punojnë, pengoni ata që dëshirojnë ta keqpërdorin edhe një cent të këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zoti kryetar,

Zotërinj deputetë,

Siguria edhe sundimi i ligjit në Kosovë, si elemente thelbësore për një jetë normale të qytetarëve të Kosovës, po vazhdon të jetë problem ndër më kryesorët, si pasojë e një politike që nuk siguron as siguri e as sundim të ligjit.

Politikat e Qeverisë së Kosovës për fushën e sigurisë dhe të sundimit të ligjit po vazhdojnë të jenë politika që krijojnë çdo ditë e më shumë pasiguri dhe stabilitet me sundimin e ligjit.

Si pasojë e mosdijes apo e mosdashjes apo edhe më keq, e keqmenaxhimit të politikave të sigurisë, sot Kosova vazhdon të jetë një vend i pambrojtur, i shkelur me kushtetutë të dhunuar dhe me sovranitet të përdhosur, sidomos në veri, e jo ashtu siç thuhet në raportin

e ministrit të brendshëm, që situata është nën kontroll, stabile, e brishtë, e qetë e të tjera e të tjera.

Ju kujtoj që aty ku ka krim, nëse situata është nën kontroll, është vetëm nën kontrollin e kriminelëve, s'mund të jetë situata nën kontroll nga institucionet e sigurisë aty ku ka krim. Pra, ju lus që ta tërhiqni këtë fjali ose ta pohoni.

Si pasojë e të gjitha këtyre, ne kemi ardhur në një gjendje që vërtet situata në veri ka rezultuar me kufij të pambrojtur, të pakontrolluar e të pa vëzhguar, por të hapur për kontrabandë dhe për kriminelë. Me doganat e pakontrolluara nga institucionet e Kosovës dhe të kontrolluara e të shfrytëzuara mirë nga shteti serb dhe nga grupe banditësh, kriminelë ordinerë, me shkelje fizike, ekonomike e politike të sovranitetit dhe të rendit kushtetues në Kosovë nga Serbia, në bashkëpunim me bandat kriminale edhe nga veriu edhe nga jugu. S'ka se si të jetë ndryshe kur Ministria e Punëve të Brendshme, në vend që të zhvillojë policinë dhe të zhvillojë politika të sigurisë, ajo po vazhdon tek me këmbëngulje dhe fanatizëm partiak ta sabotojë, ta shantazhojë edhe të stopojë çdo zhvillim të Policisë së Kosovës, struktura bazë, garanci e sigurisë publike dhe shtetërore në Kosovë.

Problemet e krijuara në Policinë e Kosovës në vend që të garantojnë siguri e rend, po krijojnë pasiguri si pasojë e mosndërhyrjeve politike dhe si pasojë e ndërhyrjeve partiake dhe keqmenaxhimit të udhëheqjes nga majat e hierarkisë së saj dhe nga drejtimi i saj politik. Si pasojë, sot në Kosovë nuk funksionon zinxhiri komandues në gjithë Policinë e Kosovës.

U tha këtu që gjendja është nën kontroll. Unë e pohoj edhe një herë, jo që gjendja është nën kontroll në veri, po as Policia e Kosovës në veri nuk është nën kontroll. Policia e Kosovës në veri, duhet ta dimë edhe këtë fakt, e përbërë kryesisht nga komuniteti serb, nuk pranon t'i raportojë apo nuk pranon t'i shkruaj raportet me logon e Republikës së Kosovës. Pra, Policia e Republikës së Kosovës nuk e njeh Republikën e Kosovës. Se sa është nën kontroll, apo sa funksionon zinxhiri komandues në veri, tregon edhe fakti se komandanti i policisë në Zveçan, ndaj të cilit ka kallëzim penal, nuk i përgjigjet këtij zinxhiri. Në të njëjtin kohë ka kallëzim penal ndaj tij për kontrabandë dhe krim të organizuar, në të njëjtën kohë ai ushtron detyrën e komandantit të Policisë së Kosovës në këtë stacion.

Pra, se sa funksionon ky zinxhir dhe sa është nën kontroll situata atje, le ta dimë se nuk zbatohen urdhëresat e moslejimit të targave të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë me inicialet e qyteteve të Kosovës. Atje qarkullojnë targat e lëshuar nga Serbia dhe nuk lejohen targa të Republikës së Kosovës apo targa të vjetra KS. Madje, nëse një veturë nga jugu tenton të kalojë në veri me targa të Republikës së Kosovës apo me targa të KS të vjetra, nga Policia e Kosovës, me urdhër politik dhe me preferencën e tyre hiqen targat, si kusht për të kaluar në veri. S'ka se si të jetë ndryshe siguria në nivel, përderisa mekanizmi kryesor përgjegjës për sigurinë publike, Policia e Kosovës, vazhdon të jetë e pa përkrahur dhe e pastimuluar nga udhëheqja e saj hierarkike dhe politike. Përderisa në krye të kësaj policie gjendet një ministër kaq i papërgjegjshëm,

përderisa në këtë polici apo me këtë polici drejton një drejtor i përgjithshëm, i cili deri para 3 vitesh ishte i dyshuar dhe i hetuar nga Inspektorati i Policisë së Kosovës, hetimi ndaj të cilit urdhëruan të pezullohet me urdhër politik. Përderisa në këtë polici udhëheqin njerëz që janë të përmendur edhe në afera të ndryshme krimesh, si në rastin e Bllacës, siç është drejtori rajonal i Policisë së Prishtinës. Përderisa me këtë njësi apo me Njësinë e hetimeve të krimeve të rënda në rajonin e Prishtinës udhëheq një toger, natyrisht si ushtrues detyre, i cili në kohën e sundimit serb në Kosovë plagosi një shqiptar në qendër të Prishtinës dhe u lirua nga Policia e Serbisë pas 24 orëve, viktimat e të cilit edhe sot gjendet në gjendje paralize në Prishtinë, i njëjti oficer përfiton nga biznese të dyshimta. Përderisa fenomeni u.d. ushtrues detyre mbizotëron në polici, është kthye në një mjet shantazhi ndaj oficerëve të policisë, si për shembull, nëse marrim shembull vetëm rajonin e policisë së Mitrovicës, me u.d. janë: drejtori rajonal, shefi i operativës, komandanti i NJMO-së, i Njësisë speciale, komandanti i trafikut, komandanti i stacionit Jug, komandanti i stacionit Veri, komandanti i stacionit Skenderaj e tjerë e tjerë në zinxhir komandues të këtij rajoni. Por, ky fenomen nuk është vetëm në rajonin e Mitrovicës. Fenomeni u.d. vazhdon të jetë si mjet shantazhi tash e tri vite në Policinë e Kosovës, si kërcënim që në rast të mos dëgjueshmërisë së tyre ndaj politikës dhe udhëheqjes, ata mund të shkarkohen, eventualisht të mos emërohen apo të zyrtarizohet detyra e tyre përkatëse.

Ky fenomen është evident edhe në rajonin e Prishtinës, pos thuaj se edhe në të gjitha rajonet e Kosovës. Ky fenomen është edhe në rastin e ish ushtruesit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, i cili në një moment të përshtatshëm për politikën u shkarkua pa asnjë arsye, i cili sot gjendet në këtë sallë si koleg i ynë. Asnjëherë nuk u dhanë arsyet për shkarkimin e këtij ushtruesi detyre, sepse përderisa ishte u.d. ishte i lehtë edhe shkarkimi dhe shantazhimi i tij. Po ashtu, u.d. ishte edhe një nga udhëheqësit dhe drejtorët e policisë, ndër më të mirët, ndër më efikasët në luftimin e krimit, i cili jo që u shkarkua, por u arrestua nga Policia e EULEX-it, duke shkelur mbi moralin e policisë së vendit me rastin e tentimit të arrestimit të tij në zyrat e institucionit ku punonte.

Nga ana tjetër, politikat inferiore ndaj Policisë së EULEX-it dhe strukturave ilegale në veri nga ana e politikës së kësaj qeverie, krijon situata kur as Policia e Kosovës dhe as Policia e EULEX-it nuk ndërhyjnë dhe nuk guxojnë të ndërhyjnë në asnjë rast, qoftë edhe ordiner, me operacion në veri para se t'i informojnë strukturat serbe atje, e në anën tjetër EULEX-i merr kurajë të ndërhyjë për arrestimin në zyrat e Drejtorisë Rajonale të Prizrenit për ta arrestuar drejtorin rajonal, pa e njoftuar as edhe ministrin, i cili së paku është deklaruar se nuk dinte gjë.

Kjo ngjarje e tillë ka prodhuar pa siguri më shumë dhe arrestimi dhe akuzimi i tij dhe i grupit të quajtur të tij për gjëja krime lufte, demotivon të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë Policinë e Kosovës, të cilët e duan Kosovën të qetë dhe të sigurt.

Fenomenet e tilla, e qoftë edhe ato si ushtrues detyre të ngjashme, e mundësojnë kontrollin mbi të emëruarit e përkohshëm dhe krijimin e një rrjeti të kontrollueshëm në polici, e theksoj -krijimin e një rrjeti të kontrollueshëm në polici. Për krejt këtë tendencë të sabotimit të policisë dhe tendencës për të krijuar rrjet kriminal në kuadër të kësaj, është

përgjegjës udhëheqja politike e saj, drejtori i përgjithshëm i policisë, kurse përgjegjës për anarki dhe prodhim të politikave të tilla stagnuese, vazhdon të jetë ai i cili udhëheq me Ministrinë e Brendshme të Kosovës. E gjithë kjo anarki e krijuar në Policinë e Kosovës dhe në sigurinë e Kosovës nga menaxhmenti politik i Qeverisë së Kosovës dhe i gjithë ky sabotim në sundim të ligjit në Kosovë, nga individë të caktuar në kuadër të udhëheqjes së Policisë së Kosovës, ka prodhuar një pasiguri publike shtetërore, në vend që të ishte e kundërta. E gjithë kjo, jo për fajin efektivave të policisë, jo për fajin e policëve dhe shumicës së oficerëve të devotshëm të Policisë së Kosovës të cilët rrezikojnë jetët e tyre për ta siguruar vendin dhe qytetarët e saj, por për fajin e një grupi politiko - mafioz në udhëheqje të policisë dhe mbi të. Një gjendje e tillë, së paku ka shkaktuar mos efikasitet të luftimit të krimit në Kosovë, ku qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mos jenë të mbrojtur nga kriminelët të cilët veprojnë si në një arenë të lirë për krim.

Prandaj, zotërinj qeveritarë, para se të tentohet që policinë ta bëni partnere të shkeljes së ligjeve, duhet me urgjencë të hiqni dorë nga ndërhyrjet politike dhe partiake më të. Para se të tentoni që t'i keni "njerëzit tuaj" në pozita u.d. apo kudo qofshin ata, apo në hierarkinë e policisë si të atashuar të politikës e të politikanëve në polici, hiqni dorë nga tendencat për ta ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojeni edhe pak, regjia!

REXHEP SELIMI: ... Ju nuk keni të drejtë e as mandat që të përdorni policinë edhe Policia e Kosovës është institucion i vendit, jo pronë në duart e pushtetarëve. Para se të jeni përgjegjës, ashtu edhe siç vërtet jeni, ju duhet të ishit të përgjegjshëm dhe të edukuar për rolin që ka një polici në një shoqëri demokratike.

Para se të jeni argatë dhe të ankoheni për punën që e bën tanimë EULEX-i kundër jush, forcojeni Policinë e Kosovës, mbështeteni atë, bëjeni FSK-në ushtri dhe bashkëpunoni me bashkësinë ndërkombëtare dhe me NATO-n. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, kush e do fjalën? Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Sot para vetes kemi një debat i cili është thirr për gjendjen e sigurisë dhe zbatimin e ligjit në Kosovë dhe kemi edhe një raport të bashkangjitur këtij propozimi të debatit dhe shikuar nga ajo çka ekziston në raport dhe në fjalë të dy ministrave, dikasterët që i drejtojnë, po të vish nga jashtë diku që se njeh Kosovën, do të kishte dalë që këtu është gjithçka në rregull, zbatohet ligji, rendi, siguria, gjithçka është okej.

Lexohen fjalime të cilat absolutisht janë frazeologji të thata, ndërsa deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës kërkojnë sqarim të gjendjes faktike, të

asaj që është funksionim i jetës në territorin e Republikës së Kosovës në bazë të Kushtetutës të kësaj Republike.

Gjithë jemi dëshmitarë se në veriun e Kosovës ka instrumente të një shteti tjetër, që do të thotë ka agresion mbi një shtet, e këtë duhet pranuar sepse nuk funksionojnë institucionet tona, por funksionon institucionet e një shteti tjetër, plus kësaj kur i shtohen bandat kriminale, ato që janë të organizuara në mënyra të veçanta e që i shërbejnë kontrabandës dhe krimit, duke qenë në bashkëpunim edhe me një pjesë të mirë të atyre që vërtet u përmend këtu pasurimi i tyre në Kosovë.

Nuk është vetëm veriu i Kosovës, por është i tërë territori i Kosovës i cenuar sepse në këtë territor shëtisin pa u verifikuar mirë me targa të një shteti tjetër që nuk e pranojnë shtetin e Kosovës dhe askush nuk po ju del përpara që t'ju thotë stop. Nga fjalimi i propozuesit krejtësisht ishte kundër prezencës së EULEX-it në mënyrën se si i theksoi për gabimet që i ka bërë EULEX-i për këto veprime, po mos të harrojmë, prej 17 shkurtit 2008 obligim dhe përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës, e institucioneve të Kosovës është të ushtrojnë pavarësinë dhe sovranitetin mbi këtë territor, të ushtrojnë dhe të ndikojnë drejtpërdrejt në ndryshimin e gjendjes. 13 strategjitë që i pash këtu në dokument, nuk flasin për mekanizma të cilët duhet të jenë veprues në veriun e Kosovës dhe në përgjithësi në Kosovë. Unë po ju them se kufijtë e Kosovës cenohen në të gjitha anët, në veçanti në pjesët ku kufizimi bëhet me shtetin serbë, prej Svircës, Karaçevës, Muqibabës, Stançiqit e shumë fshatra tjera që çdo ditë alarmojnë qytetarët se hyjnë xhandarë serb në territorin e Republikës së Kosovës.

Këtu kemi dy komponentë të cilat duhet të garantojnë siguri, duhet të garantojnë rend dhe ligj, duhet të garantojnë jetë të lirë qytetarëve në Kosovë dhe këto janë: Qeveria e Kosovës bashkë me mekanizmat ndërkombëtarë që kanë marrë përgjegjësinë në Kosovës dhe ky komunikim duhet të jetë shumë i mirë mes tyre dhe institucionet e Kosovës duhet ta kryejnë punën e vet në mënyrë që të ketë rendë e ligj, t'i bëjnë veprimet e veta dhe të mos e lejojnë EULEX-in pra të merret me neve, por paraprakisht të bëjnë veprimet gjyqësia, hetuesia, mekanizmat policorë dhe të gjithë ata që e kanë për detyrë ta mbajnë rendin dhe sigurinë në vend. Kur kjo nuk bëhet, atëherë kemi ndërlikim të kompetencave dhe sharje pastaj mes vete, gjë që në fund të fundit nuk i lejon një pasqyrë të mirë Kosovës, përkundrazi i krijon një imazh shumë të keq edhe në bashkësinë ndërkombëtare.

Këtu kemi edhe paraqitje dëshirash, se ne e duam që në territorin e Kosovës të ketë rend e ligj, se ne duam të kemi kushtetutshmëri në veriun e Kosovës. Po nuk është thirr kjo Qeveri që të ketë dëshirë. po zbatim dhe zbatimi nënkupton çdo ministri brenda kësaj qeverie program të veçantë, meqë po themi që është specifikë për investim në pjesën veriore, me të gjitha instrumentet, duke u nisur nga Ministria e Ambientit deri te Ministria e Drejtësisë, e Mbrojtjes, e FSK-së, e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Nëse funksionon kështu, atëherë mund të themi se ka kontroll, ka rend, ka ligj, ka zbatim të Kushtetutës në territorin e Republikës së Kosovës.

Kemi raste kur vijnë e na lexojnë pasuset e kushtetutës këtu, kujt? Deputetëve të Parlamentit të Kosovës, të cilët e kanë aprovuar, e kanë përpilua dhe e kanë bërë atë kushtetutë. Nuk kemi nevojë neve të na tregojnë se dinë të lexojnë, po kemi nevojë të na tregojnë që zbatohet ligji, që kushtetuta është në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, meqë e kanë marrë përgjegjësinë. Edhe një herë po e përsëris, pas 12 shtatorit askush nuk mund të justifikohet për arsye se shumë mirë shkruan në Kushtetutën e Republikës së Kosovës cilat janë përgjegjësitë e kryeinstytucioneve. Dhe merreni me mend, tash kemi edhe deklarim për përfundimin e misionit të mekanizmave ndërkombëtarë dhe përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, me çfarë gjendje. Është e pakuptueshme krejt. Nuk ke sovranitet në territor, nuk funksionojnë institucionet e vendit dhe tash po përfunduaka një pavarësi e mbikëqyrur si proces!

Edhe elemente tjera të cilat po përcillen me deklarata të panatyrshme dhe të papërgjegjshme, mund të them, të funksionarëve ose të udhëheqësve tanë në Qeveri. Zëvendëskryeministri thotë - i jap leje zotit Stefanoviq që të vijë në Prishtinë, madje është i gatshëm edhe të takohet me te. Atij që pas çdo rundi të bisedimeve, nëse e keni përcjell, del e deklaron që do të punojë për ndarjen e Kosovës, që është territor i Republikës së Serbisë në bazë të Kushtetutës të Serbisë dhe thotë me kusht që të mos ketë fjalor politik. Po për çka do të bisedojë një përfaqësues i shtetit serb nëse vije në Kosovës, që e përfaqëson ndonjë institucion? Dhe, paramendoni, është edhe në gjendje të takohet me të, me një drejtor, në fund të fundit që e ka fye nivelin institucional tonin për arsye se ne shkojmë me zëvendëskryeministër, tjetri është një drejtor i një ministrie. Mua më duket krejt e papërgjegjshme kjo. Dhe para se të vijë në Prishtinë zoti Stefanoviq, duhet shteti serb t'i kërkojë falje Kosovës për të gjitha ato që kanë ndodhur, të bëjë dëmshpërblimin, pastaj le të tregojnë zotërinjtë a mund të shkojnë në Beograd si përfaqësues të institucioneve të Kosovës. a kanë qenë ndonjëherë në Preshevë, Medvegje e Bujanovc ta shohin pozitën e shqiptarëve në këtë pjesë administrative të shtetit serb, po që ata kanë të drejtë të jetojnë si gjithë popujt tjerë të lirë, dhe edhe më keq, a kanë qenë në veriun e Kosovës, të ecin qoftë si qytetarë të zakonshëm të lirë, qoftë si përfaqësues të shtetit të Kosovës, në mënyrë që të thonë - gjendja është nën kontroll, gjendja është e qetë, mirë është dhe paramendoni në raport çka kam parë, çuditërisht del që veç një organizatë edhe ajo shqiptare tek është parë në një vend ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A do ta vazhdosh fjalën Ahmet, a jo? Regjia, vazhdojani një minutë e më tepër pak.

AHMET ISUFI: ... Çdo ditë e cenojnë integritetin, sovranitetin, e cenojnë edhe dinjitetin e qytetarëve të Kosovës. Unë po e përfundoj me një porosi për Qeverinë, mos na vini me fjalime të bukura se s'kemi nevojë, ejani raportoni për veprimet që ndërrojnë gjendjen faktike në terren dhe që bëhet zbatimi i rendit dhe i ligjit, kjo është mënyra më e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Përafërsisht një vit më parë, me kërkesë të një grupi parlamentar patëm debatuar në këtë Kuvend për çështjen e njëjtë, por gjendja vazhdon të jetë po e njëjta si ka qenë.

Do të përqendrohemi në pjesën ku ka të bëjë me sigurinë në vend dhe pikë referimi do ta marrë një pjesë të raportit të ministrit të Punëve të Brendshme.

Në fillim të raportit, ndër të tjera thuhet, citoj: “Rezulton se në Republikën e Kosovës gjendja e përgjithshme e sigurisë është e qetë dhe stabile dhe mund të klasifikohet në suaza të brishtësisë në aspektin e sigurisë së brendshme, si rezultat i aktiviteteve dhe ngjarjeve që po vazhdojnë të jenë mjaftë aktive, sidomos në pjesën veriore të vendit, por e gjithë kjo nën kontroll”, vazhdon më tutje. Pra, me këtë ministri pranon se siguria në Kosovë është e brishtë dhe si e tillë është e kërcnueshme në çdo moment. Pra, nuk është arritur që të garantohet siguri e qëndrueshme edhe përkundër faktit se ka mbi 8000 pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe qindra të tjerë e EULEX-it. Për një vend me më pak se 11 mijë kilometra katrorë dhe me një numër të tillë të policëve, nënkuptohet se brishtësia e sigurisë nuk është rezultat i numrit të pamjaftueshëm të pjesëtarëve të rendit, por i një sistemi të ndërtuar mbrapshtë. Pra, shtrohet pyetja se pse autoritetet e rendit kanë dështuar dhe po dështojnë në garantimin e sigurisë në vend edhe 12 vjet pas përfundimit të luftës dhe 3 vjet pas pavarësisë së vendit. Kam përshtypjen se politikat e gabuara në fushën e sigurisë, eksperimentet brenda strukturës së autoritetit kryesor për garantim të sigurisë, pra të Policisë së Kosovës, dhe mungesa e ndërtimit të një sistemi efikas të sigurisë ka ndikuar për këtë gjendje të përgjithshme jo të mirë të sigurisë në vend.

Me raport janë renditur strategjitë dhe planet e veprimit, që gjithsej janë 13 sosh, por që për asnjërën prej tyre nuk mund të thuhet se janë arritur rezultate, jo pse këto nuk janë të mira. Krijohet përshtypja se strategjitë dhe planet e veprimit në Kosovë hartohen sa për të thënë që kemi plane strategji, por që implementimi i tyre në praktikë po thuaj se është i padukshëm. Kam bindjen se për ekzistencën e këtyre dokumenteve përpos një numri të kufizuar të zyrtarëve, të tjerët as që e dinë se ekzistojnë. E them këtë, sepse deri më sot nuk kemi parë që cilido autoritet i thirrur për zbatim të këtyre dokumenteve do të ketë raportuar se deri në ç’fazë janë implementuar ato, cilat kanë qenë rezultatet dhe cilat kanë qenë sfidat. Madje, po që se shikohet veprimi i autoriteteve, do të bindeni që ato janë në kundërshtim me vetë ato strategji, hartimi i të cilave edhe i kanë kushtuar buxhetit të vendit qindra mijëra, në mos miliona euro.

Do të ndalem vetëm në dy nga këto 13 dokumente për t’ju bindur se nuk është e mjaftueshëm hartimi i dokumenteve, qofshin ato edhe të mira, nëse ato nuk zbatohen.

E para, strategjia e luftimit të krimit të organizuar dhe plani i veprimi dhe e dyta, strategjia për sigurinë në shkolla.

Gjendja në këto dy fusha është si mos mëkeq dhe për këtë faji qëndron ose në strategjitë e hartuara gabimisht, që nuk e besoj, ose në paaftësinë për implementimin e tyre. Njëra nga këto të dyja është më se e sigurt. Për një gjë jam i sigurt, se faji nuk është tek pjesëtarët e thjeshtë të policisë, përkundrazi ata me nder i kryejnë detyrat e veta.

Krimi i organizuar po thuaj se e ka ngulfatur vendin dhe përpos disa veprimeve që më tepër ngjajnë në spektakle, rezultate tjera nuk ka. Nuk do të përmend raste, sepse edhe ashtu opinionimi është i njoftuar për veprimet kriminale dhe jo vetëm në pjesën veriore të vendit, ku ka prani simbolike të forcave vendore të rendit, por edhe në pjesët e tjera. Tashmë shtrohet pyetja: A janë aq të paafta autoritetet tona të rendit, apo është një pyetje mungesa e vullnetit politik e institucional për t'u përballë me krimin? Vetëm njëra nga këto është e sigurt.

E dyta, që besoj se është shqetësuese po sa është krimi i organizuar, është siguria në shkolla, apo më mirë të them pasiguria në shkolla të Kosovës.

Jemi të interesuar të dimë se sa ka ndryshuar gjendja e sigurisë nëpër shkollat tona prej se ekziston kjo strategji? Po thuaj se nuk ka ditë që qytetarët e Kosovës në media të mos shohin imazhe të dhunës nëpër shkollat tona, të cilat jo rrallë herë kanë përfunduar tragjikisht. A mund të pretendohet për cilësi të mësimit nëpër shkolla tona nën trusninë e huliganëve të ndryshëm që terrorizojnë shkollarët. Sot, në shumicën e shkollave tona fillore e të mesme ka prani të substancave narkotike, të cilat sigurisht as nuk mbillen dhe as nuk kultivohen në shkolla.

Zoti ministër,

Për këto, por edhe për çështje të tjera ju duhet të na raportoni neve e juve, vartësitë e juaj, se pse nuk po ka përparim në fushën e sigurisë, se pse këto strategji të plane të veprimit nuk janë të zbatueshme?

Një gjendje përafërsisht e njëjtë është edhe në sistemin e drejtësisë, i cili s'po arrin të gjejë rrugën e vet, pavarësisht deklaratave politike për, siç thuhet, angazhim për sundimin e shtetit të së drejtës. Besoj se ka kaluar koha e fajësimit të tjerëve për gjendjen e keqe në këta dy sektorë dhe është koha kur institucionet e vendit, në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë duhet të veprojnë në drejtim të krimit të një klime të sigurisë në vend. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS. Nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar "6+". Nuk ka të paraqitur.

Atëherë, dua t'ju njoftoj që janë deri tash të paraqitur 28 veta. Ne po punojmë edhe përafërsisht 40 minuta, po marrim pauzë dhe vazhdojmë sipas rregullores, në qoftë se s'ka ndonjë propozim nga grupet parlamentare.

Sipas radhës, Afëridita Berisha – Shaqiri është paraqitur.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Nga Raporti për gjendjen e sigurisë dhe sundimit të ligjit në vend, të cilin e prezantoi ministri i Punëve të Brendshme, rezulton se Republika e Kosovës në vitet e fundit ka shënuar progres të dukshëm në saje të ngritjes së nivelit të profesionalizimit të institucioneve të rendit dhe sigurisë. A thua, si mund të thuhet që është shënuar progres, kur institucionet tona fare ose sipërfaqësisht ushtrojnë kontroll në pjesën veriore dhe, si pasojë e kësaj gjendjeje, disa pika janë lehtë të kalueshme dhe shfrytëzohen për kontrabandim të ndryshëm, që ndikojnë negativisht edhe në buxhetin e Kosovës.

Qytetarët e Mitrovicës të cilët i kanë pronat e tyre në pjesën veriore ende nuk kanë të sigurt që t'i vizitojnë ato, e të mos flasim për shfrytëzimin e tyre. Në raport gjithashtu theksohet se krahasuar tremujorin e vitit të kaluar me tremujorin e këtij viti, kemi një rritje rreth 47% të veprave penale, ato të cilat në një përqindje simbolike ose fare nuk ndriçohen. Mos të harrojmë se vrasjen e 14 vjeçarit Leutrim Musliu, nga fshati Uglar i Gjilanit, i cili tërheq vërejtjen që siguria në Kosovë është duke u cenuar rëndë si pasojë e neglizhencës së organeve që duhet të merren me sigurinë e qytetarëve, sepse kjo vrasje është kryer nga pusia, që edhe një herë dëshmon pasigurinë e qytetarëve të Kosovës. Nga kjo konkludojmë që ende gjyqësori i Kosovës mbetet një ndër institucionet publike më të dobëta, sepse me mijëra raste kanë mbetur të pazgjidhura dhe nuk ka asnjë shenjë se kjo gjendje mund të përmirësohet. Prandaj, duhet të jemi të vetëdijshëm që nuk mund të krenohemi me situatën e sigurisë në vend derisa ende ekziston mos zbardhja e këtij rasti dhe i rasteve të tjera të cilat duhet të jenë një sinjal i keq për sigurinë dhe rendin në Kosovë.

Përderisa institucionet e Kosovës nuk kontrollojnë tërë territorin e Kosovës, mendoj në menaxhimin e kufijve dhe të doganave në veri, ku ndodhin çdo ditë disa incidente, të paktën nuk duhet të themi që kemi shënuar progres. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Koleg deputetë,

Unë do të ndalem kryesisht në disa segmente parimore të sundimit të ligjit, pa hy në çështje të sigurisë, sepse besoj që deputetët që janë më kompetent do të flasin për këtë temë.

Definitivisht, sundimi i ligjit nuk është deklaratë politike, nuk është dëshirë politike, po është kusht pa të cilin s'mund të ekzistojë dhe s'mund të ndërtohet një shtet demokratik. Madje, disa vende e quajnë edhe si vlerë kombëtare, sepse krijon një qëndrueshmëri të shtetit dhe Republika e Kosovës me kushtetutë, sundimin e ligjit, ndërtimin e shtetit të së drejtës e ka përcaktuar si një bazë të sistemit kushtetues. Por, tre vjet pas pavarësisë ne mund të gjykojmë sa është arritur kjo premisë, pa të cilën nuk ka shtet demokratik. Shteti

i së drejtës nuk është diçka që mund të zgjedhësh, por është diçka pa të cilën nuk mundesh dhe pa cilën nuk mund të funksionosh.

Unë do të ndalem në atë se cilat segmente të shtetit ligjor mund të cilësohen si të arriturat, cilat janë dobësitë dhe cilat janë sfidat, sepse nuk ka integrim të Kosovës brenda Bashkimit Evropian pa një progres në sferën e sundimit të ligjit.

Do të ndalem në tri segmente që mund të kualifikohen si suksese apo si të arritura, për të vazhduar pastaj me segmente tjera. Pa dyshim se kushti i parë për ndërtimin e shtetit ligjor është kuadri ligjor me standardet e Bashkimit Evropian dhe është një fakt që legjislacioni në Kosovë jo vetëm pas pavarësisë, por edhe menjëherë pas çlirimit ka filluar të standardizohet me kriteret e Bashkimit Evropian, sepse ne kemi bërë mirë që po i standardizojmë më herët, jo pastaj të humbim kohë vite të tëra për të harmonizuar legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Evropian. Mund të them se ligjet e Kosovës, filluar edhe nga kushtetuta, janë me standarde të larta të Bashkimit Evropian dhe në momentin kur do të hyjmë në raporte kontraktuale me Bashkimin Evropian, Kosova nuk do të humb vite sa i përket harmonizimit të legjislacionit, çfarë kanë bërë shtetet tjera të tranzicionit.

Gjithashtu, si një moment pozitiv i filluar, pa dyshim është fillimi edhe i reformës së sistemit gjyqësor, atë që ne e kemi quajtur segmentin më të pa reformuar të shoqërisë kosovare në periudhën e pasluftës. Tanimë janë hedhur konturat moderne të një sistemi gjyqësor dhe reforma ka filluar edhe pse, siç dihet, do të zgjatë bukur shumë.

Segmenti i tretë pozitiv, që do të doja ta dalloja, është funksionimi i Gjykatës Kushtetuese. Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese me gjithë diskutimet për vendimet e saja, kjo gjykatë ka treguar se këtu është i mundshëm ligji, këtu është e mundshme kushtetua dhe kjo gjykatë ka rivendosur kushtetutshmërinë dhe ka rivendosur në çështje shumë senzitive dhe mund të themi që ne po merremi model edhe për të mirë. Edhe pse kemi pasur dy kriza të rënda me largimin e dy ish presidentëve, ne merremi si rast i mirë se këtu ka funksionuar sistemi, sistemi kushtetues sepse është rivendosur kushtetutshmëria me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Pa dyshim, këto janë tri segmente inkurajuese, por jo të mjaftueshme për të thënë që Kosova është në rrugë të mirë të ndërtimit të shtetit ligjor.

Unë do të ndalem tash në lëshimet kryesore në drejtim të shtrimit të sundimit të ligjit dhe sfidat. Pa dyshim që dështimi kryesor është moszbatimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në tërë territorin e Kosovës. Edhe kushtetutshmëria, edhe ligjshmëria nuk kanë arritur të funksionalizohen në pjesën veriore të Kosovës, sepse atje ende nuk vepron i plotë sistemi kushtetues dhe sistemi legjislativ, për aq më tepër, atje kemi struktura kushtetuese dhe ligjore ilegale të paligjshme të Republikës së Serbisë, të cilat ende kanë disa celula dhe ende nuk ka arritur të vendoset ligji i plotë në Kosovë.

E dyta, kriteret selektive në luftimin e krimit. Do të thotë, ne e dimë se oazë e krimit në Kosovë është veriu, të gjitha formave të krimit, që nga krimi ordiner, që nga krimet e luftës, që nuk janë ndëshkuar e deri te kriminaliteti ekonomik apo edhe krimi i

organizuar. Atje nuk po luftohet krimi, nuk po luftohet krimi sa duhet dhe kemi një ngecje të dukshme në luftimin e krimit. Dhe, elementi i tretë, atje nuk është funksionalizuar as segmenti elementar për sundimin e ligjit, nuk kemi gjykatë dhe po bëhet një lloj loje politike që disa vite me funksionalizimin e Gjykatës së Qarkut dhe segmenteve tjera të gjyqësisë, që janë kusht elementar për të mundësuar sundimin e ligjit.

Kemi zbatim të ligjit në shumicën e territorit të Kosovës, por nuk kemi ende funksionalizim të ligjit në veri të Kosovës. Një shpresë e madhe e popullit të Kosovës në ngritjen e standardit të sundimit të ligjit ka qenë prezenca ndërkombëtare, sidomos misioni i EULEX-it, që është një mision i specializuar, që ka qenë një pritje e madhe e popullit të Kosovës që me ndihmën e EULEX-it do të vendosen standarde të sundimit të ligjit, por fatkeqësisht, në vend që t'i marrim praktikatat më të mira të sundimit të ligjit, praktikatat evropiane, ne kemi edhe praktikat të këqija të sundimit të ligjit, sepse ky mision ka dështuar në funksionalizimin e ligjit në veri, në kapjen e kriminelëve të luftës. Ka koketuar ndoshta dhe ka bërë edhe kompromise politike, në anën tjetër ka bërë spektakle, spektakle me persekutimin e personaliteteve të shquara, spektakle me cenimin e integritetit të institucioneve të Kosovës.

Natyrisht, të gjithë jemi të barabartë para ligjit, por mënyra se si EULEX-i ka bërë disa spektakle, në rastin e Prizrenit, në rastin e Ministrisë së Transportit dhe në rastet tjera, ku ka cenuar integritetin e institucioneve, pa dyshim nuk janë praktikatat të mira. Nuk janë praktikatat, sepse në këto raste janë përfshirë zyrtarët të cilët edhe ashtu kanë qenë gjithmonë të devotshëm ndaj sundimit të ligjit dhe asnjëherë nuk kanë paraqitur problem. Dhe, ne kemi parë ndoshta edhe spektakle që kemi parë edhe në disa vende tjera, për shembull në disa vende ku janë luftuar grupet mafioze dhe janë bërë spektakle, më tepër fushata se po luftohet krimi se sa politikatat e vërteta të luftimit të krimit.

Dhe, natyrisht që Kosova në të ardhmen, në qoftë se dëshiron të hyjë në raporte kontraktuale me Bashkimin Evropian, duhet sa më shpejtë të japë tregues konkret të progresit në sferën e sundimit të ligjit dhe padyshim që EULEX-i është ai që duhet të japë këtu shembujt më pozitiv, por institucionet e Kosovës duhet ta marrin përgjegjësinë, duhet ta kërkojnë përgjegjësinë që ato të marrin përgjegjësinë e plotë për sundimin e ligjit, sepse praktikatat ndërkombëtare kanë treguar vetëm kur Qeveria vendore mëveshët me përgjegjësi dhe adresohet përgjegjësia, atëherë Qeveria vendore është edhe më efikase dhe kemi një progres, sepse gjithmonë ekzistimi i dy palë kompetencave është një alibi i mirë për të ikur prej përgjegjësisë. Ne e dimë përvojën 10- vjeçare me UNMIK-un, ku në fakt UNMIK-u nuk ka bërë asgjë në vendosjen e sundimit të ligjit, në anën tjetër institucionet e Kosovës kanë pasur një alibi gjithmonë duke thënë që kjo nuk është kompetencë jona, apo ky është dështim i UNMIK-ut. Nuk do të donim që ne të hyjmë në një cikël të ri të administrimit ndërkombëtar. Kosova nuk ka nevojë për një riciklim të administrimit ndërkombëtar, ne do të donim që sa më shpejt: institucionet e Kosovës, gjykatat, Policia, institucionet tjera, të ndeshen me kompetencat, ta marrin përgjegjësinë dhe të vendosin sundimin e ligjit, sepse sundimi i ligjit është i nevojshëm për Kosovën, për qytetarët e Kosovës, nuk është i nevojshëm për politika ndërkombëtare, nuk është i nevojshëm për interesa parciais, por është i domosdoshëm për të ecur Kosova përpara. Ne duhet t'i arrijmë standardet, së paku duhet të

pretendojmë në standardet që kanë arritur shtetet e tranzicionit të vonshëm, shtetet që tani po presin anëtarësim në Bashkimin Evropian, në mënyrë që vërtet të mos humbim kohë edhe në aspiratat tona legjitime që ne të bëhemi pjesë e familjes evropiane. Për ta bërë këtë, vërtet është dëshirë legjitime, por rruga deri te kjo është një sfidë e madhe dhe kjo do të kërkojë vërtet ndërtimin e një shteti demokratik, ku sundimi i ligjit nuk është parullë e fushatave parazgjedhore, nuk është deklaratë politike, por është filozofi e funksionimit të një shteti të ri, sidomos të një shteti të ri, sepse praktika ka treguar që shtetet që në fillim të ndërtimit, vendosin bazat e sundimit të ligjit, janë shtete të suksesshme. Është shumë më problem, pas funksionimit afatgjatë të rivendoset shteti ligjor.

Kosova ka një rast të mirë që tani si shtet i ri, si shtet që po fillon t'i ndërtojë mekanizmat e vet kushtetues, të vendosë parimet e sundimit të ligjit dhe si një shoqëri ku ligji është një vlerë kombëtare, të bëhet pjesë e shoqërisë evropiane. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit!
I nderuar kryesues i Kuvendit,
I nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Materiali i prezantuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për këtë pikë të rendit të ditës është titulluar si Raport për gjendjen e sigurisë dhe sundimit të ligjit në vend. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, konsideron se nga përmbajtja e këtij materiali, shihet qartë se kjo shkresë assesi nuk mund të quhet raport, sepse ka mangësi të shumta, nuk është e strukturuar mirë, dhe thjesht nuk pasqyron gjendjen reale të sigurisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Hartuesi për përpilimin e raportit, është bazuar në disa makro-tregues të situatës së përgjithshme në Kosovë, si dhe në disa makro-tregues të ndryshëm të aktivitete policore në sigurimin e rendit dhe qetësisë publike, të cilët vërtet paraqesin një bazë të mirë për një raport të suksesshëm, por që fatkeqësisht në rastin konkret nuk janë shqyrtuar në mënyrë analitike dhe studimore, andaj si rezultat i punës së këtillë, ne para vetes kemi një shkresë që përcillet me shumë dobësi, një shkresë sipërfaqësore, jo gjithëpërfshirëse, vende- vende kontradiktore dhe cila është larg pasqyrimit të realitetit kosovar në sferën e sigurisë dhe sundimit të ligjit.

Të nderuar deputetë,
Në vazhdim do të paraqes para jush dhe para opinionit kosovar argumente lidhur me vlerësimin e tillë të kësaj shkrese.

E para, në pjesën hyrëse të raportit, jepet një vlerësim tejet i përgjithshëm që në masë të konsiderueshme është edhe i pakuptueshëm. Një gjë të tillë e theksoi edhe kolegu Makolli nga koalicioni “Kosova e Re”, në të cilën thuhet: “Në Republikën e Kosovës,

gjendja e përgjithshme e sigurisë është e qetë dhe stabile, por mund të klasifikohet në suazat e brishtësisë në aspektin e sigurisë së brendshme”

Nga ky vlerësim, nuk mund të kuptohet se në Kosovë, a është gjendja e sigurisë stabile, apo është e brishtë, kurse në realitet ekziston dallim i madh ndërmjet asaj që është stabile dhe asaj që është e brishtë? Por, edhe nga disa konstatime të potencuara në vijim të vetë raportit, shihet qartë se aktualisht në Kosovë nuk mund të flitet për gjendje stabile të sigurisë. Kështu për shembull, në faqen 4 të raportit, citoj, thuhet: “Krimi i organizuar edhe më tutje paraqet një sfidë për mekanizmat e sigurisë në vend”. Ndërsa, një faqe me tutje thuhet: “Gjendja në kufijtë e Kosovës, paraqitet e qetë edhe përkundër faktit se disa zona në vijën gjelbër, për shkak të kontrollit jo në nivelin e duhur, është lehtë i kalueshëm dhe shfrytëzohet për kontrabandim”, andaj shtrohet pyetja se për çfarë stabiliteti të sigurisë në Kosovë mund të flitet nëse vendi është i rrezikuar nga krimi i organizuar dhe kufijtë e tij janë lehtë të lalushëm, respektivisht në një vend ku sipas raportit, ushtrohet kontrolli sipërfaqësor i kufijve dhe ku vazhdohen kontrabandat e ndryshme, të cilat e dëmtojnë jo vetëm buxhetin e Kosovës, por e rrezikojnë seriozisht edhe shëndetin e popullatës dhe mjedisin në përgjithësi.

E dyta, ndonëse në titullin e raportit përmendet shprehja: “Sundimi i ligjit në vend”, në tërë dokumentin nuk haset asnjë e dhënë, analizë apo vlerësim lidhur me këtë komponentë tejet të rëndësishme për funksionimin e një shteti demokratik, çfarë pretendojmë dhe dëshirojmë të jetë vendi ynë.

Pasi që sundimi i ligjit nuk është trajtuar fare në raport, unë do të theksoja se sipas Kushtetutës të Kosovës, sistemi juridik është unik, i pandashëm, i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron qasje të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Por, në realitetin tonë kosovar ai nuk është unik, sepse fatkeqësisht ai nuk zbatohet dhe nuk funksionon në tërë territorin e Kosovës, sidomos në ato regjione ku veprojnë të ashtuquajturat ” struktura paralele serbe”, të cilat me keqardhje duhet pranuar se janë aktive që nga 10 qershori i vitit 1999 e të cilat nuk kanë qenë të mandatura as nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, as nga Rezoluta e 17 korrikut 2007, e as nga Kushtetuta e Kosovës.

Dihet mirë se këto struktura veprojnë de fakto nën autoritetin e Qeverisë së Serbisë dhe kanë shtrirë juridiksionin e tyre në pjesët e ndryshme të Kosovës, duke vepruar, qoftë nga territori i Serbisë apo nga territori i Kosovës. Këto struktura paralele, herë- herë kanë vepruar bashkë apo nën kulmin e njëjtë me institucionet ndërkombëtare. Strukturat paralele serbe në Kosovë përbëhen nga strukturat e sigurimit, të gjykatave, të administratës, të arsimit, të qendrave për kujdes shëndetësorë dhe strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, për lëshimin e dokumenteve personale.

Qeveria serbe, që nga viti 1999, në vazhdimësi i ka financuar strukturat paralele në Kosovë, kurse vetëm për vitin 2010, Beogradi zyrtar ka ndarë mbi 40 milionë euro për këto struktura, pjesë e të cilave janë edhe gjykatat paralele serbe. Duke pasur parasysh këtë aktivitet të strukturave paralele serbe, që shtrihet në një pjesë të madhe të territorit të Kosovës, domosdo shtrohet pyetja bazike- A mund të flitet fare për sundimin e ligjit

në Kosovë? Dhe, pastaj pyetja e radhës- Cilët janë hapat konkret që po ndërmerr Qeveria e Kosovës për ta shtrirë pushtetin e vet në tërë territorin e vendit?

E treta, në raport bëhet fjalë për ekzistimin dhe veprimtarinë e grupeve ekstremiste serbe, duke theksuar citoj:” janë shumë aktive, sidomos në veri të Kosovës dhe janë të ndërlidhura me strukturat paralele dhe me krimin e organizuar, ku si shkak i mosfunksionimit të ligjshmërisë dhe kontrollit joefikas nga organet shtetërore të Kosovës, merren me aktivitet kriminal”. Nuk ka fije dyshimi se përgjegjësia kryesore për ekzistimin dhe aktivitetin e këtyre dhe të gjitha grupeve tjera të ngjashme, bie mbi Qeverinë e Kosovës, sepse udhëheqësit dhe zyrtarët e saj paguhën nga taksat e popullit për t’i luftuar grupet e tilla, për të ushtruar kontroll më efikas, për ta funksionalizuar sundimin e ligjit si dhe për t’i ofruar të gjithë qytetarëve të Kosovës një jetë më të qetë dhe më të sigurt.

E katërta, në raport potencohet se janë hartuar 13 strategji dhe plane të veprimit në fushën e sundimit të ligjit. Mirëpo, nga vetë raporti nuk mund të kuptohet se cilat kanë qenë rezultatet konkrete të hartimit të tyre, gjë që na bënë të dyshojmë se strategjitë e tilla, kanë qenë shpenzime të kota të cilat kanë mbetur thjeshtë strategji dhe plane në letër, sepse në raport nuk është paraqitur asnjë informatë e vetme mbi rezultatet e disa prej këtyre strategjive, si për shembull: strategjisë nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore, strategjisë nacionale për grumbullimin e armëve të paligjshme, strategjisë për siguri në shkolla e tjera.

Dhe e pesta, e meta tjetër e këtij raporti, qëndron në pjesën e konkluzioneve, e cila përveç dy vlerësimeve të përgjithshme mbi sigurinë e sundimin e ligjit dhe për sfidat lidhur me pjesën veriore të Kosovës, nuk përmban asnjë konkluzion, respektivisht rekomandim konkret, qoftë për veprimtarinë në krye të organeve kompetente për sundimin e ligjit, qoftë për punën e ardhshme të tyre.

Krejtësisht në fund do të theksoja se duke pasur parasysh faktin se Kosova ndodhet në vendin e 114 për nivelin e korrupsionit, në grup me: Beninin, Bolivinë, Gabonin, Indonezinë dhe Ishujt Solomon, pastaj faktin se Kosova është vendi ku vidhen provat në vetë stacionin e Policisë, Kosova është vendi ku arrestohen komandantët e policisë, siç ishte rasti me komandantin e Prizrenit, pastaj duke pasur parasysh përmbajtjen e raportit, por edhe realitetin kosovar në rrafshin e sigurimit dhe zbatimit të ligjit, i cili në dokumentet relevante ndërkombëtare, është përshkruar në këtë mënyrë, citoj: “Kosova ka qenë dhe ka mbetur parajsë e kriminalitetit kompleks, trafikimit dhe korrupsionit të grupeve klanore, të lidhura me strukturat politike”, cituar nga Majkel Emerson, Tajfor Gjasiss in Kosovo, janar 2010. Pastaj përshkrimi tjetër:” luftimi kundër trafikimit të drogave në Kosovë, akoma është në fazën fillestare,” marrë nga raporti i Progresit 2010.

Pastaj thënie tjetër: “Interferimet politike pengojnë luftën efektive kundër krimit të organizuar”, po ashtu nga raporti i Progresit 2010, na bëjnë që ne si deputetë të Grupit Parlamentar të LDK-së, tmerrësisht të brengosemi sikurse për sigurinë e popullatës së Kosovës, ashtu edhe për sundimin e ligjit në Kosovë dhe njëherësh të kërkojmë prej

Qeverisë së Kosovës, që të ketë një qasje shumë më serioze se sa atë që tanimë e ka në këto dy sfera tejet të rëndësishme: për jetën, trupin, dinjitetin dhe mirëqenien e qytetarit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Shumë të nderuar deputetë,
Unë e kam pasur ndërmend të flas edhe dje, por dje kam pasur problem ta di se cilës përkatësi i takoj, isha arushë apo diçka tjetër. Uroj që në të ardhmen ky Parlament ta ruajë dinjitetin e vet dhe deputetët të jenë shumë të kujdesshëm me fjalorin, së paku për hir të deputetëve dhe elektoratit të tyre dhe dinjitetit të Parlamentit.

Sa i përket raportit të ministrit Rexhepi, do të orientohej kryesisht në raportin që ka të bëjë me sigurinë. Më lejoni të them se në informatën e ministrit Rexhepi, në një pjesë thuhet se në Republikën e Kosovës, gjendja e përgjithshme e sigurisë është e qetë dhe stabile. Pajtohem, zoti ministër, dhe mbi bazën e dijes dhe informacioneve të mia profesionale, meqë deri para pak muajsh kam qenë vetë në krye të Policisë së Kosovës. Bile, nëse më lejoni do të shkoj edhe më tutje përtej këtij konstatimi. Gjendja e sigurisë është shumë më e mirë ngaqë është perceptimi ndërkombëtar i krijuar nga raporte të sponzoruar nga kundërshtarët, nga kundërshtarët e pavarësisë dhe të demokracisë kosovare. Gjithashtu është më e mirë sesa flasin raportet e progresit, sepse sikur akoma nuk po arrijmë të ndërtojmë një mekanizëm efikas të raportimit për të arriturat tona apo raportet po i shndërrojmë në statistika të qarta dhe të mbështetura në fakte.

Gjithsesi gjendja është shumë, shumë më e mirë ngaqë artikullohet politikisht dhe për nevojat e çastit e të rastit. Ky nivel i sigurisë është rezultat i punës së devotshme deri në vetëmohim të policëve të Kosovës. Ju e dini se policët tanë akoma nuk kanë sigurim, as për jetën e tyre dhe as për shëndetin, megjithatë, ata futen në situata nga të cilat ndoshta mund të mos kthehen më kurrë, megjithatë ata e mohojnë veten, për ta pohuar shtetin dhe për ta vendosur rendin e për ta zbatuar ligjin.

Nuk ka fije dyshimi se ky nivel i sigurisë është edhe rezultat i mbështetjes së vazhdueshme, posaçërisht tash e katër vjet që Qeveria e zotit Thaçi po i bën Policisë së Kosovës. Madje vendimi i fundit shumë i guximshëm për rritjen e rrogave: për policët, doganierët, zjarrfikësit, ushtarët dhe oficerët korrektues, meriton të lavdërohet nga të gjithë, sepse është dëshmi e përkushtimit për forcimin e sektorit të drejtësisë. Mbase nuk e di a ju ka ra në sy një fakt, që mund të jetë rast i veçantë në botë. I pari i Policisë së Kosovës sot, e ka rrogën më të madhe se sa Kryeministri i Republikës së Kosovës, kjo nëse nuk flet shumë, diçka, megjithatë flet. Do të ishte shumë joprofesionale dhe unë do të isha shumë i padrejtë nëse nuk do të shtoja edhe se, para së gjithash shtoja edhe se, para së gjithash dhe mbi të gjitha ky nivel i sigurisë është meritë edhe i KFOR-it dhe e vet qytetarëve të Kosovës që vazhdojnë të besojnë fuqishëm në Policinë e Kosovës dhe forcën ushtarake ndërkombëtare, për EULEX-in më vonë. Për këto

vlerësime, dëshmojnë statistikën, sidomos krahasimet me nivele të sigurisë të shteteve stabile. Në demokracitë stabile, situata e sigurisë vlerësohet me numra dhe me anketime qytetarësh. Nëse i merrni statistikën e lëvizjeve të krimit dhe i krahasoni me statistikën e ngjashme të vendeve me nivel të sigurisë së lartë, do të çuditëni se si në shumicën e rasteve ne jemi më mirë, e në disa raste jemi afër mesatares evropiane. Do shihni se te disa vepra penale: plaçkitje, grabitje, vjedhje, jemi më mirë edhe se shtetet skandinave dhe se shkalla e zbulueshmërisë është mbi 90%, shërbehuni me statistika, bëni krahasime, analiza, artikuloni profesionalisht, rezultati del ky.

Sa për respekt dhe për informimin tuaj, vetëm vitin e kaluar Policia e Kosovës, ka shkatërruar 29 grupe të krimit të organizuar dhe ka arrestuar 178 persona për krime ekonomike dhe korrupsion, plus 799 raste janë dërguar në Prokurori. Këto shifra flasin për përkushtimin e organeve të rendit për luftimin e krimit, sidomos atij ekonomik, kurse në anën tjetër, nëse doni ta vlerësoni situatën e sigurisë dhe të jeni korrekt me situatën, gati në të gjitha anketat me qytetarët që janë bërë në këtë vend, për ndjenjën e tyre të sigurisë, përgjigja ka qenë se janë të kënaqur me nivelin e sigurisë në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Me informatën e ministrit Rexhepi, në vazhdim të vlerësimit se situata në përgjithësi është e qetë dhe stabile, vazhdohet me tutje, në suaza të brishtësisë si rezultat i aktiviteteve dhe ngjarjeve që po vazhdojnë, sidomos në pjesën veriore, por gjendja është nën kontroll.

Unë do të shkoj më tej dhe mbase do të përpiqem të jap edhe vlerësimet e mia. Së pari, integriteti territorial është i mbrojtur dhe atë është i mbrojtur nga mekanizmi më i fuqishëm ushtarak që e ka bota sot. Integriteti territorial nuk shkelet me këmbë njerëzish me kravata, që ndonjëherë hyjnë e dalin pa na pyetur nëpër pikat tona kufitare. Të gjithë e dimë se si shkelet integriteti territorial, prandaj ky shqetësim nuk duhet të na mendojë edhe as të na nuk duhet t'i shqetësojmë qytetarët tanë.

Së dyti, çështja e veriut të Mitrovicës, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, është çështje e sundimit të ligjit, pra ushtrimit të sovranitetit tonë shtetëror, nuk është çështje politike. Çështje politike ka bërë UNMIK-u, dhe tani vazhdon të trajtojë si të tillë edhe EULEX-i, paska që EULEX-i është mision i zbatimit të ligjit, me mandat ekzekutiv dhe ka juridiksionin në të gjithë atë pjesë dhe fatkeqësisht ndonjëherë edhe ne sikur jemi ndrojtur aq shumë sa edhe ne kemi filluar të besojmë se atje çdo gjë është politike. Kjo nuk është ashtu. Aq politike e ka bërë sot EULEX-i situatën e sigurisë atje, flas nga përvoja ime e punës me ta, sa që, qoftë edhe një arrestim ordiner, ata shkojnë dhe bisedojnë me liderë joformal në veri të Mitrovicës e besa edhe në Beograd, para se ta arrestojnë një kriminel ordiner. E them me shumë kompetencë.

Më kujtohet vjet kur isha drejtor i përgjithshëm i Policisë, patëm marrë vendim për ta mbështetur operacionin e ART-së, për heqjen e antenave ilegale. Zhurmë e madhe që bërë atëherë që të mos ndërmarrim atë veprim, sepse thuhej se prishej situata e sigurisë në Kosovë. Madje- madje, kolegët e mi ndërkombëtar patën kërkuar nga vartësit e mi të urët që ata të deklarohen përmes video konferencës në Bruksel, se edhe Policia e

Kosovës mendon se heqja e antenave ilegale cenon seriozisht sigurinë publike në Kosovë. Shyqyr që asaj radhe nuk gjetën një vartës të urtë për ta bërë këtë konferencë në i hoqëm antenat një herë, i hoqëm edhe dy herë.

Po në anën tjetër, në pjesët tjera atë Kosovës, EULEX-i nuk qan kokën fort as për ndjeshmëri politike, as për Kushtetutën tonë, madje as për vetë institucionet e sigurisë të Republikës së Kosovës. Më duhet ta përsëris edhe për hir të kolegjalitetit edhe të respektit dhe të besimit që kam në personin që ka qenë drejtor i Drejtorisë rajonale të Prizrenit. Ndërhyrja e EULEX-it në Drejtorinë rajonale të Prizrenit, është e pa shembull. Është pak të thuhet jo profesionale. Ka pasur 101 mënyra tjera që drejtori t'i përgjigjet procedurës, DHE në një mënyrë ka qenë ajo, të cilën ai e zgjodhi vetë, shkoi dhe ju përgjigj organeve të drejtësisë.

Atë ditë EULEX-i e ka cenuar rëndë sigurinë. Që nga ajo ditë kushdo mund të vë maskë në kokë dhe të futet në cilindo stacion të policisë dhe të arrestoj ke do. Kjo është praktikë e pashembullt, jo vetëm në demokracitë stabile, por edhe në disa merita të brishta që janë duke u zhvilluar në Evropën Juglindore. Sidoqoftë, kjo u bë.

Pse është kjo kështu? Sepse EULEX-i vazhdon të trashëgojë mentalitetin e UNMIK-ut, metodologjinë e punës, madje edhe të personelit. Ka shumë gjykatës, ka shumë prokurorë, ka shumë policë, sidomos në veri të cilët vetëm e kanë ndërruar uniformën, këta mund të jenë njerëz më të mirë të mundshëm, por mentaliteti i tyre është i vjetër, misioni është i ri, mandati është i ri dhe këto nuk shkojnë bashkë. Prandaj, duke qenë se e kanë këtë mentalitet, ata vazhdojnë të mos e respektojnë, as imunitetin e deputetëve, ata vazhdojnë të mos i respektojnë as institucionet tona, si ato që ishin në rastin e Prizrenit, por as ndaj qeveritarëve. Nuk është ndoshta ego e tyre, por është praktikë e ngelur nga UNMIK-u, prandaj ata vazhdojnë derisa dikush t'ua kujtojnë se tash kanë ndërruar rrethanat.

Unë nuk dëshiroj që EULEX-i të dështojë, nuk dëshironi as ju dhe as qytetarët e Kosovës, sepse dështojmë ne. Jam i vetëdijshëm edhe profesionalisht që ne duhet të punojmë bashkë me ta, madje janë të domosdoshëm dhe është mirë që kemi mbështetjen ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit, por duhet që urgjentisht të sqarohet një herë mirë mandati, sepse ata herë thonë jemi ne përgjegjës për diçka, e herën tjetër thonë jeni ju, zakonisht për rezultate janë përgjegjës ata. EULEX-i duhet të ndërrojë qasjen dhe të reformohet dhe me këtë ne, duhet të ndihmojmë jo duke miratuar çdo që thonë, e bëjnë ata vetëm sa për t'ua bëjnë qefin atyre, e për t'u hyrë në qejf, por duke u përpjekur që të korrigjohemi dhe ndryshojmë bashkërisht. Kështu më vonë do të pëlqehemi reciprocikisht më shumë. Fundja, ky është partneriteti.

Sektori ynë i sundimit të ligjit, sidomos pjesa politike dhe ajo administrative e ekzekutivit, duhet natën dhe ditën, kudo e kurdo të jenë pro aktiv dhe të marrin iniciativa dhe ta bëjnë punën ku të munden dhe si të munden vetë e pastaj ne t'i pyesim ndërkombëtarët e kanë bërë apo jo? E jo sidomos pjesa administrative e ekzekutivit të pyesim vend e pa vend, kohë e pa kohë gati për çdo çështje a ta bëjmë këtë punë kështu, a ta bëjmë ashtu? Besoj shumë se përkushtimi i Qeverisë i vitit të kaluar, për

masa në veri të vendit, pjesë e të cilave aktivitete isha edhe unë, për ndryshimin e mjedisit të sigurisë së sigurisë në veriu, besoj që do të vazhdojë dhe në këtë nuk kam asnjë fije dyshimi. Propozoj që nga ky debat të nxirret një, së paku t'i dërgohet një letër Parlamentit Evropian e së shumti të nxirret një deklaratë për t'u sqaruar, për t'i shprehur shqetësimet tona në raport me misionin e EULEX-it.

Dhe në fund, meqë mu përmend emri, dëshiroj që t'i përgjigjem deputetit Selimi se është e vërtetë se ka pasur mes meje dhe kolegëve të mi ndërkombëtar konfrontime gati të vazhdueshme, kemi pasur koncepte krejt ndryshe profesionale, sidomos rreth situatës së sigurisë në veri, ka pasur madje edhe llafe me anglishten evropiane se janë në telashe me mua, por megjithatë askund, në asnjë rast nuk kam pasur shantazh, e para. E dyta, edhe sikur të kishte, nuk ka shantazh as shqip e as anglisht e mos të flas për gjuhët tjera që mund të më shantazhoj mua, sidomos ju e kuptoni sepse atëherë isha gjeneral, keni qenë edhe ju gjeneral, zoti Selimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Janë dy replika. E para, e Donika Kadaaj- Bujupit dhe, e dyta, e Rexhep Selimit.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Duke marrë parasysh që këto deputeti paraprak iu referua fjalës së Grupit Parlamentar të Aleancës dhe foli për etikë dhe moral, unë prita që para kritikave që do t'i jap për deputetët dhe sugjerimeve se si të flasin, do të reagojë edhe për veprimet e kryeministrit, i cili dje gjatë gjithë ditës ka bërë shkelje të Rregullores në këtë Kuvend. Në fund të fundit, Kuvendi është shtëpia e përfaqësuesve të popullit, ndërsa nuk është binë për sfilatat e kryeministrit, i cili e shkel Rregulloren dhe e merr fjalën sa herë t'i teket atij. Prandaj, nëse duam të jemi etik dhe parimor, të paktën brenda një fjalimi të jeni të saktë ju. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sa për njoftim, Kryeministri e ka marrë fjalën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe me Rregullore ka të drejtë. Në rregull!

Sipas radhës, zoti Selimi, e ka fjalën. 2 minuta replikë.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do t'i përgjigjem me replikë, ndoshta jo si formë përgjigjeje, por si formë pyetjeje, kolegut deputet, ish- ushtruesit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm, apo kolegu gjeneral, siç thotë.

Unë e kuptoj shumë dhe vërtet e kam çmuar dhe vazhdoj ta çmoj krejt kontributin e gjeneral Selimit në kuadër të Policisë së Kosovës, por kërkoj në një pyetje të më përgjigjesh: Meqë ju paskeni pasur konfrontim me ndërkombëtarët, ju kanë shkarkuar ndërkombëtarët apo kryeministri i Kosovës, ta kemi të qartë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: A dëshiron të përgjigjesh apo? Kundër replikë, 1 minutë keni dhe të mbyllet.

BEHAR SELIMI: Si duket sot është dita e Selimëve, por unë e them publikisht dhe me shumë përgjegjësi se unë me vetë iniciativë, motivi mund të jetë gjetur në ato konfrontime, motivi mund të jetë zbuluar edhe nga diskutimi im, por iniciativën për t'u larguar e kam marrë vetë pas 11 vjetësh shërbim të vazhdueshëm për vendin dhe ishte koha e zgjedhjeve. U futa zgjedhjeve, tash jemi kolegë së bashku këtu. Ju faleminderit në pyetje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Aurora Bakalli, e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Një nga proceset e rëndësishme të sigurisë së Kosovës, padyshim se është edhe siguri i kufijve administrativ të saj. Në mënyrë që të arrihet kjo, Komisioni Evropian ka zhvilluar një koncept i cili është paraparë që të zbatohet edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, pjesë e së cilës është edhe Kosova. Ky koncept është menaxhimi i integruar i kufirit, që sipas nocionit të Unionit Evropian, nënkupton bashkërendimin dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin në lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave si dhe vendosjen e një sistemi efikas të menaxhimit të kufirit, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përgjithshëm i kufijve të hapur për të kontrolluar mirë dhe të sigurt. Po e përsëris kufijve të hapur për t'u kontrolluar mirë.

Me këtë formë të menaxhimit të kufirit, Kosova do të duhej bërë bashkërendimin e punës ndërmjet doganave të saj, policisë kufitare dhe Agjencionit Veterinar dhe Fito-sanitar të cilët të koordinuar do të lehtësonin lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Parimisht, për t'u realizuar ky koncept, medoemos çdo vend në Ballkan, enë mesin e tyre edhe Kosova do të duhej hartuar strategji kombëtare dhe plan të veprimit për implementimin e menaxhimit të integruar atë kufirit. Kosova ka një strategji lidhur me menaxhimin e integruar të kufirit, por në implementimin e saj, përveç një numrit të theksuar të trajnimeve dhe të seminareve dhe përpjekjeve të ngadalshme për kompletimin e infrastrukturës ligjore, ende nuk mund të shihet një qasje serioze në jetësimin substancial të saj. Këtë e them duke pasur parasysh rëndësinë e këtij koncepti në ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të Kosovës në rend të parë, e më pastaj në ruajtjen e tregut nga produktet e mangëta për nga kualiteti .

Të kujtojmë rastin e fundit me Jaffa- keksin, të importuar nga Serbia, i cili në bazë të analizave të bëra nga Instituti përkatës në Slloveni, është konstatuar se në foljen plastike ka përmbajtës të dëmshëm, benzofen dhe katër-metil benzofen dhe konsumimi i tyre paraqet rrezik serioz për shëndetin.

Të ndalemi dhe të mendojmë se pse kjo analizë për përmbajtjet e dëmshme të këtij produkti, nuk është bërë nga institucionet tona për kontrollin e kualitetit të mallrave, por ajo është bërë në një vend tjetër. A do të thotë kjo se ne realisht kemi një numër të konsiderueshëm të produkteve të cilat janë në qarkullim në tregun tonë dhe se mund të jenë të dëmshme serioz të shëndetit të kosovarëve? E gjithë kjo shpie në dy përfundime.

Njëri, se dikasteret përkatëse, në këtë rast AVUK-u nuk paskan kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe infrastrukturore për t'i kryer këto detyra, gjë që sugjeron për një qaje jo serioze në një fushë e cila padyshim është ndër më të rëndësishmet për sigurimin e vitalitetit të shëndetit të përgjithshëm të banorëve të Kosovës dhe përfundimi tjetër, se dikush ka bërë përlogaritje fitimprurëse nga mosfunksionimi i këtyre dikastereve kaq jetike për Kosovën, madje edhe nëse paguhet me çmimin e shëndetit të qytetarit.

Tanimë, pa u bërë viti i aprovimit të Ligjit për menaxhimin dhe kontrollin e integruar të kufirit shtetëror, do të bëhen ndryshime dhe plotësime në mënyrë që i njëjti ligj të aprovohet në vitin 2011. Gjithashtu, pas një viti nga aprovimi i strategjisë për menaxhimin e integruar të kufirit, do të ketë ndryshime në këtë strategji dhe atë në drejtim të ndarjeve të qarta buxhetore dhe ndarjes së saktë të përgjegjësisë, elemente të cilat kanë karakter bazik në fillimin e përpilimit të çdo strategjie. Kjo as më pak e as më shumë sugjeron për një paaftësi institucionale për të draftuar dokumente strategjike afatgjate.

Sistemi elektronik i BMS-së i ndërlidhur me regjistrin civil në bazë të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, si dhe me bazën e të dhënave për lëshimin e vizave, deri me tani ka mbetur vetëm një ide në letër. Derisa në të kundërtën vlera e funksionalizimit të kësaj ideje, do të ishte disa herë më e madhe kur si produkt final i kësaj, do të ishte një Kosovë më e sigurt nga krimi i importuar, nga mallrat e pakontrolluara dhe çka është më e rëndësishme, funksionalizimi i saj do të siguronte rrethana të përshtatshme për një shëndet të përgjithshëm më të mbrojtur në Kosovë.

Ndërkaq, edhe vërejtjet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2010, janë të shumta, ku sugjerohet që Kosova do të duhej shpejtuar procesin e implementimit të menaxhimit të integruar të kufirit dhe se deri me tani, Kosova është ende në fazat e hershme të adresimit të sfidave që dalin nga menaxhimi i integruar i kufirit. Gjithashtu, baza ligjore ende nuk mundëson implementimin e nevojshëm të menaxhimit të integruar të kufirit, për faktin që ligji që rregullon këtë fushë, nuk është implementuar në tërësi dhe mungojnë një numër i konsiderueshëm i udhëzimeve administrative.

Autoritetet kosovare, konsiderohet nuk kanë kapacitete të mjaftueshme të planifikimit dhe se nuk janë në gjendje të marrin pronësinë kur kemi të bëjmë me implementimin e sistemit të teknologjisë informative. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi ende nuk ka përfunduar dhe ka pasur një numër incidentesh në kufirin me Maqedoninë, gjë që sugjeron për mungesë të bashkëpunimit të policisë në mes të dy vendeve.,

Sugjerohet në përmirësimin e kapaciteteve të Shërbimit Doganor të Kosovës dhe të policisë kufitare, në mënyrë që lufta kundër krimit ndërkufitar të intensifikohet. Kufijtë e Kosovës thuhet se nuk janë të sigurt sa duhet, këtë e tregojnë rastet e konsiderueshme të qarkullimit me dokumente të falsifikuara nga Kosova për në Evropë, ndërkaq veriu i Kosovës vazhdon të mbetet sfida më e madhe, jo vetëm porta 1 dhe 31, por i tërë

kufiri verior nuk është në mbikëqyrje adekuate, gjë që paraqet shqetësim madhor për sigurinë e vendit në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti, Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Shumë keq që ministri Rexhepi nuk është, ndoshta po na sheh te bufeja, për shkak se po dua ta e nis këtë paraqitje me një konstatim që e ka dhënë në informatën ose raportin e tij, dhe e cila vërtet e qet në dilemë krejt çka po flasim sot, sidomos për këtë pjesën e EULEX-it. Thotë se e gjithë kjo është nën kontroll, domethënë situata në veri, si rezultat i angazhimit të gjitha institucioneve përgjegjëse të sigurisë, duke filluar nga Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i, të cilët janë të angazhuar maksimalisht në ruajtjen e rendit dhe të situatës të sigurisë në këtë rajon, por edhe në tërë Republikën e Kosovës.

Të nderuar,

Raporti është bërë më 22 prill, ndërkaq më 27 prill, po i njëjti ministër thotë: “Zot runa prej EULEX-it”. Tash pyetja është- a duhet të na ruaj Zoti prej EULEX-it, a duhet ta lusim Zotin, lëna EULEX-in, se sipas raportit zyrtar të Ministrisë të zotit Bajram Rexhepi, EULEX-i është duke u angazhuar maksimalisht në ruajtjen e situatës të sigurisë në Kosovë. Këto janë probleme që vërtet çudisin me atë çka e dëgjojmë sot, çka lexojmë në raport dhe çka dëgjojmë në televizion ose në konferenca për media të ministrave dhe të politikanëve tjerë.

Duhet ta dimë edhe besoj që vjen ministri Rexhepi të na shpjegojë se a ka bërë hajgare në këtë raport, a ka bërë hajgare kur ka thënë : “Zot, runa prej EULEX-it” ose ka bërë dy herë, po në të njëjtën kohë, është problem se kjo logjikë është dëmtuese. Në rekomandimet që deputeti Nait Hasani i ka paraqitur, por po ashtu u thanë edhe gjatë fjalimeve këtu , ose t’i dërgojmë një letër Brukselit ose të shkojmë një delegacion i deputetëve në Bruksel për t’i thënë se EULEX-i nuk po punon mirë, unë po besoj që më së pari duhet treguar ministrit Rexhepi, a po punon mirë a jo, ose ministri Rexhepi të na shpjegoj neve a po punon mirë a jo, edhe mos të na vendos në këtë situatë, ku njëherë thotë: “Zot, runa prej EULEX-it”, herën tjetër thotë: “Zot lëna EULEX-in këtu”

Problemet e tilla janë më shumë se veç çështje deklaratës, por realitetin ne e dimë cili është. Shtrirja e autoritetit të shtetit në krejt territorin e vendit është problem që po vazhdon edhe më tutje, ka degraduar pas shpalljes së pavarësisë, fatkeqësisht. E dimë prej 18 Shkurtit, kur janë kallur pikat kufitare dhe doganore në veri dhe situata ka vazhduar me degradim të mëtutjeshëm. Kontrolli i kufijve është i brishtë, jo vetëm në veri, por edhe në pjesët tjera edhe në pjesën e Dardanës edhe në pjesën që lidhet me Malin e Zi dhe ky problem nuk është përcaktuar ose nuk është raportuar, nuk është futur brenda kësaj informate të ministrit. Sundimi i ligjit ose sundimi mbi ligjin që po

ndodh në Kosovë, po vazhdon të na prekë të gjithëve, jo vetëm prej vendorëve, por edhe prej ndërkombëtarëve, në këtë rast. Ne e dimë dhe duhet ta themi qartë se, jo vetëm gjatë kësaj periudhe prej EULEX-it, por edhe më herët, procese gjyqësore, politike ka pasur në Kosovë, fatkeqësisht për shumë njerëz në Kosovë edhe më tutje nuk ka përfunduar lufta. Pra edhe më tutje përballen me çështje që kanë të bëjnë me luftën dhe është e dëmshme, jo vetëm për ta, është e dëmshme për Kosovën, sepse ata njerëz kanë luftuar për vendin e vet, për ne, për të gjithë dhe, edhe më tutje që 12 vjet pas luftës, përballen me çështje që kanë të bëjnë me periudhën e luftës. Dihet që janë procese politike dhe procese gjyqësore- politike dhe këto procese normalisht që po e mbajnë peng edhe stabilitetin e vendit në përgjithësi.

Shkatërrimi i resurseve nacionale, është një prej pikave ose pyetjeve që do t'ia bëja secilit prej ministrave që janë përgjegjës për sektorin e sigurisë. Po, a dini se në Kosovë nuk ka vlerësim cilat janë resurset nacionale të Kosovës. Nëse e shohim atë që po quhet strategji e sigurisë nacionale, është një dokument total jo profesional, është një dokument i cili asnjëherë nuk e përmend se cili është realisht kërcënimi ndaj sigurisë së Kosovës, dhe cili është realisht kërcënimi ndaj shtetit të Kosovës. Unë e di që ka shumë kërcënime, ne e dimë të gjithë, por kërcënimi kryesor në atë dokument thuhet se është analfabetizmi, nuk përmendet asnjëherë Serbia, nuk përmenden asnjëherë strukturat ilegale të Serbisë në Kosovë, ndërkaj ne në këtë periudhë ne sot po flasim ose e kemi një prej rekomandimeve për përfundim të këtij debati që duhet shkatërruar ose shpërndahen strukturat e aparatit shtetëror serb. Por, në dokumentin kryesor të shtetit të Kosovës për sigurinë nacionale, kjo nuk figuron askund. Domethënë Qeveria e Kosovës nuk e shih si kërcënim për siguri në Kosovë, ekzistimin e strukturave ilegale ose të aparatit shtetëror të Serbisë ose gjendjen në veri të Kosovës, por edhe në pjesët tjera, nuk është vetëm në veri të Kosovës gjendja e rëndë, ka edhe në pjesët tjera të cilat po vazhdon funksionimi i këtyre strukturave.

Kontrabanda, ne e dimë të gjithë dhe kemi dëgjuar deklarata të llojllojshme që veriu i Kosovës është oazë e kontrabandës edhe e krimit të organizuar edhe si të tilla këto deklarata i kemi dëgjuar edhe para shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Me këtë kriter, pas djegies së pikave kufitare dhe doganore, atëherë ajo nuk është oazë, veriu i Kosovës është planet për kontrabandën edhe krimin e organizuar, sepse nëse deri atëherë kanë ekzistuar disa pika kufitare doganore të cilat e kanë kryer punën e vet deri në një masë, ndoshta jo më profesionale në, më të mirën të mundshme sikurse është dashur ta kryejnë, tash fare nuk i kemi dhe normalisht që vetëm e ka zgjeruar mundësinë dhe hapësirën për kontrabandë edhe për krim të organizuar. Por, pikat kufitare doganore, nuk duhet të shihen vetëm elemente të ndaljes së kontrabandës dhe krimit të organizuar, kanë të bëjnë me konceptin e ekzistimit të shtetit, kanë të bëjnë me atë se cili është shteti i Kosovës, ku shtrihen kufijtë e Kosovës.

Kërcënimet tjera të vazhdueshme që i bëhen Kosovës, stabilitetit të Kosovës, janë e dhe ato që kanë të bëjnë me kërcënime rajonale, kërcënime globale, sikurse është terrorizmi ndërkombëtar, që as në këtë raport nuk parashihen ose nuk vendosen, nuk përcaktohen

se cilat janë sukseset e Kosovës në këtë drejtim, dhe ne e dimë të gjithë se Kosova duhet të vazhdojë dhe të fuqizohet në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Problem tjetër është edhe mosfunksionimi i mirë i institucioneve të sigurisë. Ne e dinë që Kosova e ka një Këshill të Sigurisë Kombëtare ose Këshilli i Sigurisë së Kosovës, sikurse quhet, por asnjëherë deri tash nuk kemi parë ndonjë produkt të qartë të këtij këshilli sikurse duhet ta luajë rolin ky këshill, sikurse e luan rolin nëpër vendet tjera sovraane. I vetmi produkt është se ajo strategjia e sigurisë nacionale për të cilën e thashë më herët se është vetëm një letër e kotë.

Tendencat për politizimin e sektorit të sigurisë kanë vazhduar. Policia e Kosovës megjithatë po mbetet edhe më tutje nën tryshninë e atyre që quhen reforma strukturale brenda policisë, ndërkaq komunikimi mes shtyllave të policisë edhe më tutje mbetet i parregulluar mirë, sidomos dihet, domethënë mes shtyllës së hetimeve dhe shtyllës operative, për të cilat komunikimi, forma e komunikimit të tyre edhe në nivel qendror, edhe në nivele rajonale dhe në nivele lokale, duhet definitivisht të përmirësohet nëse duan që të kemi efekt dhe nëse duam që të kemi funksionim, funksionalitet më të mirë të policisë në zbardhjen e rasteve edhe paraqitjen e tyre në organet tjera të drejtësisë, pra në prokurori. Liria e lëvizjes të qytetarëve është një prej elementeve që e përcakton se sa ka siguri në Kosovë, dhe ne e dimë qartë se nuk mund të shkohet në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës, është për gjynah për të dëgjuar dhe për të parë që udhëheqësit e shtetit të Kosovës...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Unë, po ju tregoj se nuk ia zgjas më askujt kohën e diskutimit edhe ty po ta zgjas kohën një minutë, se janë paraqitur edhe 26 veta, s'ka mundësi, flisni atë që e keni shkruar dhe mos u ngatërmoni në fjalët tuaja. Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pjesën dërmuese nga diskutimet që patën kolegët deputetë nga qasjet e ndryshme, besoj që u thanë shumë gjëra të rëndësishme, që tregon se ka qenë e nevojshme një pikë e tillë e rendit të ditës të jetë në Parlamentin e Kosovës dhe besoj që kështu do të vazhdojë edhe me diskutime të tjera dhe unë do të përpiqem që të mos i përsëris ato për të cilat në shumicën e diskutimeve pajtohemi me ... perspektivat që i dhanë vetë deputetët lidhur më këtë temë.

Më lejoni së pari t'i them dy fjalë te Policia e Kosovës, për të vazhduar pastaj edhe atë që dua ta ngrit. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që Policia e Kosovës, është një polici e re, e krijuar, është shtylla e shtetit dhe ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm që, si deputetë, si institucione në përgjithësi, që këtë institucion tepër të rëndësishëm të shtetit, si shtyllë kryesore të mos e përdorim në asnjë mënyrë për politikën ditore. Nuk

ka asnjë dilemë që Policia e Kosovës ka nevojë shumë dhe mendoj se është koha, në këto 10 vjetët e fundit është ndërtuar atë sa për të filluar e reflektuar drejtoria e Policisë, udhëheqja e policisë të reflektojë të gjitha ato fenomene negative që janë brenda saj, njerëzit e tillë të cilët u përfolën meqë të tillët nuk duhet të kenë vend të policisë, por ne duhet të inkurajojmë udhëheqjen policore që vazhdimisht duke arritur profesionalizmin, të bëjë edhe një vetëkontroll për gabimet-lëshimet. Dhe, në anën tjetër atyre duhet t'u shkojë porosia e qartë:” mos e dëgjoni politikën se ata nuk ju shkojnë mbrapa” Policia duhet ta ketë të qartë, : “politika i lenë në lloç”, të vazhdojnë ta mbështesin ligjin, ta respektojnë ligjin, sepse shefat e tyre shkojnë e vijnë dhe për punën dhe mos punën e tyre përgjigjen ata vetë. Për atë edhe është shtyllë e policisë, kështu do të doja të jetë edhe për Prokurorinë edhe për gjyqësinë.

Të nderuar kolegë,,

Folëm për rendin ligjin në këtë vend. Të gjithë e dimë sa është instaluar, sa është i zbatueshëm dhe i respektuar rendi dhe ligji në Kosovë, rendi, ligji dhe kushtetutshmëria, mungesa e zbatimit ose implementimit të ligjit dhe të kushtetutshmërisë në një pjesë të territorit të Kosovës. Kemi thënë që në një territor, në një pjesë të territorit të Kosovës, mosrespektimi ose mos implementimi i ligjeve të Kosovës dhe vetë Kushtetuta, është cenim i drejtpërdrejtë i territorit të Kosovës, e kjo është pjesa veriore e Kosovës dhe aty ku nuk ka, ku nuk respektohet, nuk pranohet shteti dhe kushtetutshmëria, asgjë nuk është nën kontroll dhe si e tillë duhet të jetë pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve të vendit për ta futur nën kontroll këtë pjesë të Kosovës, që është tërësisht jashtë kontrollit kushtetues.

Në qoftë se mendojmë për trazira, në qoftë se mendojmë për tanke, nëse mendojmë për dhunë, mund të themi se gjendja është e qetë, por ne po flasim për një dhunim institucional, një dhunim kushtetues dhe si e tillë është në aspektin ligjor, në aspektin juridik, gjendja atje është jashtë kontrollit, për të cilën duhet të bëjmë përpjekje për ta implementuar. Nuk është dje, nuk është sot, është për këto 10 vjet, mirëpo duhet të fillohet të bëjmë hapa konkret në kthimin e ligjshmërisë edhe në territorin e Kosovës, për të cilin pajtohemi të gjithë.

Dua të them gjithashtu, tash pas një kohe do të mblidhet Komiteti për mbikëqyrjen e implementimit të pakos së Ahtisarit dhe mendoj se është momenti që strategjia dalëse e pavarësisë së mbikëqyrur, është momenti të flitet qartë për të arriturat ose implementimin e kësaj pakoje dhe ku nuk është implementuar. Po thonë të gjithë, për të gjithë është e qartë që pakoja e Ahtisarit është implementuar 100% në pjesën ku kontrollohet nga shteti i Kosovës, nga institucionet e Kosovës dhe nga qytetarët të cilët e pranojnë shtetin e Kosovës, sikur që mund të them që nuk ka as zero progres, progresi është zero në pjesën veriore të Kosovës në implementimin e pakos së Ahtisarit. Dhe, shtrohet pyetja pastaj të shihet se cili është angazhimi i faktorëve mbikëqyrës ndërkombëtar në implementimin e pakos së Ahtisarit dhe a është fajtorë, në këtë rast, shumica në Kosovë për vazhdimin e një pavarësie të mbikëqyrur? Çka në realitet po bëjnë mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar për ta implementuar pakon e Ahtisarit në pjesën veriore të Kosovës? Dhe, kjo mendoj që duhet të jetë çështja kryesore e cila kërkon implementimin dhe për implementimin e pakos së Ahtisarit meritë kryesore

është e vetë institucioneve të Kosovës, popullit të Kosovës në këtë pjesë të territorit ku ka qenë në mbikëqyrje të Kushtetutës të Kosovës.

Është koha që ndoshta ICO-ja të dislokohe në Mitrovicë dhe të ndihmojë në implementimin e pakos së Ahtisarit dhe jo nga Prishtina, të arriturat e Prishtinës t'i nxjerrë si të vetat.

Këtu u fol shumë edhe rreth raporteve vendor dhe ndërkombëtar. Problemi kryesor për mendimin tim i funksionimit të institucioneve të ligjit, qoftë te misioni ndërkombëtar dhe të institucioneve vendore dhe vetë institucionet e Kosovës, është problemi i mosbesimit. Po që se institucionet e Kosovës nuk e shtrojnë qartë para misioneve ndërkombëtar se këtë vend, po se nuk e themi hapur se misionet, njerëzve pranë misioneve të Kosovës nuk ju besojnë institucioneve e Kosovës, kanë mosbesim, nuk ka partneritet, ka mosbesim dhe në qoftë se kjo nuk shtrohet qartë për të gjetur dhe ndërtuar besimin e ndërsjellët për të realizuar secili detyrat e veta ligjore, ne nuk mund të ecim përpara, nuk ka partneritet, ku ka mosbesim, nuk ka partneritet. Ne mund të flasim përditë për partneritet, por në realitet asnjë veprim deri sot nuk kemi parë partneritet, si mund të quhet? Por, dëshmia më e mirë se nuk ka partneritet është ajo që ka ndodhur me drejtorin e Policisë së Prizrenit. Shkojnë punëtorët e misionit që deri dje kanë qenë kolegë të tij, i futen në zyrë, e arrestojnë drejtorin e Policisë, ministri i rendit nuk din, ministri i Drejtësisë nuk din, vetë drejtori i Policisë nuk din dhe kjo është shenjë e mosbesimit, kjo është shenjë e ofendimit në tërësi të atyre që në një mënyrë apo tjetër janë përfaqësues të popullit. Ka të tillë që thonë nuk kemi si t'ju besojmë atyre se ata janë të gjithë kriminelë, nuk bën, nuk mundem me ta të funksionoj, janë të tillë si janë.

Shiko, paragjykime kemi, ata kanë për neve, na kemi për ta, mirëpo ata duhet të kuptojnë një gjë, ne jemi përfaqësues të këtij vendi, që ato institucione të mira, të këqija që janë, këta deputetë që janë këtu të mirë e të këqij, me vota të vjedhura dhe të pavjedhura, qysh do që le ta quajnë, na jemi këtu përfaqësues të popullit dhe ata duhet të punojnë me neve në qoftë se donë ta ndërtojnë këtë vend, të na ndihmojnë ta ndërtojnë vendin. Sikur që ne, ata që na kanë dërguar ashtu siç janë, duhet të bashkëpunojnë me ta për të ndërtuar këtë partneritet, sepse unë jam i bindur në politikën edhe qëllimin e Bashkimit Evropian, që ka për qëllim të ndihmojë Kosovën, por veprimet që i bënë misioni i tyre këtu absolutisht shkojnë në drejtimin e kundërt nga atë që e ka qëllim misionit, qëllimi i Bashkimit Evropian.

Ministri nuk kërkon, ministri punon, ministri shtyn, sepse ka përgjegjësinë para qytetarëve. Nuk kërkohet nga EULEX-i që t'i krijojë kushtet në Mitrovicë, punohet dhe gjendet rrugë me ta, të punohet bashkë për të krijuar kushte që edhe gjykatat tona të vendosen, gjykata të vendoset në pjesën e veriut, prandaj mendoj që zoti ministër duhet ta angazhojmë maksimalisht, të bëhet data, të bëhet përcaktimi i datës, afati ligjor, kur Gjykata e Qarkut në Mitrovicë do të fillojë punën me gjithë gjyqtarët dhe prokurorët? Duhet afate ligjore, duhet afate kohore për ta ndërtuar agjendën. Çdo gjë tjetër na mbetet vetëm në letër dhe shtyhet. Unë e di se ju e keni marrë një problem të trashëguar, mirëpo ky problem dikur duhet të fillojë të zgjidhet dhe mendoj se është momenti që ju të insistoni në afate kohore në fillimin e Gjykatës në pjesën veriore të Kosovës.

Gjithashtu të inkurajohet dhe të shtyhet Prokuroria e Kosovës, është shteti që të fuqizohet, të marrë kompetenca dhe të luaj rolin e Prokurorisë së shtetit ashtu siç e kanë shtetet e tjera.

Dua në fund t'i them edhe dy fjalë rreth imazhit të ndërhyrjes. Shikoni çka po ndodhë te ne. Merren djemtë të cilët para 13 vjetëve kanë luftuar për lirinë e kësaj Kosove dhe trajtohen bash sikur me qenë mafioz. Keni parë skena se si futen në gjykatë. Dikush qëllimisht do ta paraqet Kosovën si vend kriminal, me imazh të tillë të dëmtuar, sepse këta njerëz nuk dinë ta respektojnë ligjin, gjë që që 12 vjet, 13 vjet ne e kemi demonstruar të kundërtën, çdo herë në dispozicion të organeve të drejtësisë. Cila është arsyeja që 8 djem, 10 djem mbahen ose 20 djem 30 djem mbahen në burg, cila është arsyeja? Ikin, largohen, pengojnë drejtësinë, asnjëra nga këto nuk është? Cila është arsyeja të trajtohen të tillë, njerëzit të cilët e kanë sjellë lirinë në Kosovës? Ende pa marrë vendim gjyqësor, të mbulohen kokat e tyre me thasë. Çfarë trajtimi, cila është arsyeja? Nuk ka arsye tjetër përveç një të paraqesë këtë vend i cili ende nuk është i pjekur për ligjin, të paraqet këtë vend që ende këtu janë banda kriminale, dhe kujt i konvenon kjo?! Këtyre i konvenon logjikës së UNMIK-ut për zgjatur sa më shumë misione të tilla.

Zoti ministër tha dje, tha 25 euro i kushton mbajtja a e të një burgosuri në burgun e Dubravës. Pse i mbajnë njerëzit kur ata janë gjithmonë në dispozicion të ligjit, prandaj kërkoj që nga deklaratimet të kalojmë në vepra dhe jo pastaj të vijë një moment të kërkohej falje ndaj njerëzve dhe ju e dini edhe në fund dua ta mbyllë me atë thënien e famshme: "askush mbi ligjin", por shihet që shumë kush mbi ligjin dhe shumë kush qysh po ka qejf po bën me ligjin, varësisht qysh po ia lypin interesat politike.

KRYESUESI: Ju faleminderit, mendoj se është koha për pauzë të drekës, deri në orën 15:00, pastaj vazhdojmë. Janë edhe 25 deputetë të paraqitur.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Do të ndalem edhe unë në dy pika shumë të rëndësishme që lidhen me çështjen e sundimit të ligjit për siguri në vend, në radhë të parë me gjendjen në veriun e Kosovës.

Mungesa e kontrollit efektiv nga ana e institucioneve të Kosovës, në veçanti të atyre të sigurisë në pjesën veriore të vendit, për më shumë se një dekadë ka krijuar një gjendje të konservuar e cila është gati të shpërthejë në çdo moment. Shqiptarët e paktë që kanë mbetur në veri, jetojnë ende në ankth duke mos pasur të garantuar as nivelin më minimal të sigurisë. Ata shkojnë në shkolla dhe për blerje të ushqimit, me mjete të blinduara dhe akti më i thjeshtë i daljes në oborrin e shtëpisë së tyre, ua rrezikon jetën. Sulmet ndaj tyre mbesin të padiskutuara, të paketuara, dhe të pa dënuara, ndërkaq edhe

sulmi më i vogël ndaj pjesëtarëve të komuniteteve tjera, ngritët si çështje në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Strukturat kriminale në veri, ashtu siç konfirmohet edhe nga Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme që u lexua sot nga ministri, vazhdojnë punën e tyre të udhëhequra nga qëllimi final i Beogradit që të kthejë kontrollin e vet në Kosovë dhe të qojë në ndarjen finale të Kosovës, i cili është thënë shumë herë, paraqet skenar jashtëzakonisht të rrezikshëm për të gjithë rajonin. Fatkeqësisht, Qeveria e Kosovës nuk paraqiti si parakusht për hyrje në dialog me Serbinë shuarjen e këtyre strukturave kriminale dhe ilegale të cilat financohen, mbështeten dhe udhëhiqen nga Beogradi. Kjo i ka lënë hapësirë Serbisë që në një hanë të hiqet si palë konstruktive në zyrat e Brukselit, derisa vazhdon me dekonstruktivitetin e vet dhe shkeljen e integritetit territorial të Kosovës çdo ditë e me intenzivisht.

Është për keqardhje po ashtu që provokimet e Serbisë vazhdojnë edhe tani pasi ka filluar dialogu dhe hiq më larg se sot, kryenegociatori serb Stefanoviq deklaroi se nuk i duhet fare leja nga autoritetet e Kosovës për të hyrë në Kosovë, duke dëshmuar edhe një herë mospranimin e institucioneve të Kosovës nga ana e Serbisë. Po ashtu do të ndalem edhe te puna e EULX-it, siç e dimë të gjithë, janë bërë rreth 3 vjet të operimit të EULX-it në Kosovë dhe ne ende presim, qytetarët e Kosovës ende presin që ky institucion të fillojë zbatimin e mandatit të vet edhe në veri.

Zbatimi uniform i ligjit në tërë territorin e Kosovës, është çështje fundamentale. Fatkeqësisht, deri tani është bërë shumë zhurmë e pak punë dhe kjo mungesë e veprimeve tregon se edhe EULEX-i po shkon rrugës së UNMIK-ut duke lejuar që veriu të shndërrohet në një vend me qetësi dhe siguri të rrejtshme ku shkëndijat e dhunës me pasojë të paparashikueshme, mund të shpërthejnë në çdo moment. Nëse vërtetë EULEX-i nuk dëshiron ta pranojë dhe ta zbatojë mandatin e vet për veri, atëherë presim që të bashkëpunojë që këto kompetenca t'i kalojnë institucioneve të vendit, në mënyrë që të fillohet menjëherë me veprime konkrete drejt integritetit të kësaj pjese.

Është shqetësuese që për moskthimin e gjykatave të Kosovës dhe funksionimin e tyre në veri, si arsye përdoret mospajtimi i Serbisë. Nëse EULEX-i mendon të marrë leje nga Serbia për çështje që janë ekskluzive të brendshme të Kosovës, atëherë me këtë veprim është në kundërshtim me mandatin e vet dhe me neutralitetin në të cilën thirret, derisa thirren se janë mision për sundimin e ligjit, është pikërisht ky mosveprim i tyre që po kontribuon më së shumti në lulëzimin e krimit në veri dhe në mos sundim të ligjit, ashtu siç është paraqitur edhe në shumë raporte ndërkombëtare për Kosovën, në veçanti ai i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, është pikërisht ky insistim i përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, se pa pëlqimin e Serbisë nuk mund të ketë vendosje të autoritetit në veri që më së shumti e dëmton dhe e minon çdo deklaratë se sundimi i ligjit është prioritet.

Ndërkaq, sa i përket sistemit gjyqësor në përgjithësi, përkundër miratimit në vitin e kaluar të një numri të ligjeve bazike për funksionimin normal të gjyqësisë që

përfshinte edhe Ligjin për gjykata, sistemi gjyqësor mbetet pjesa më e brishtë dhe më e ndikueshme nga politika në Kosovë, derisa do të duhej të ishte e kundërta.

Besimi i qytetarëve në këtë sistem, do të mbetet minimal derisa nuk sigurohen kushte për një gjyqësor tërësisht të pavarur dhe apolitik, ashtu siç parashihet në Kushtetutën e vendit. Praktikë korruptive dhe standardet e dyfishta në gjykime e dënime, vazhdojnë të mbesin shqetësuese dhe kjo së bashku me mungesën e efektivitetit për shkak të tej ngarkesës me numër tepër të lëndëve në krahasim në numrin e gjyqtarëve, e bënë funksionimin e gjykatave një ndër sfidat më të mëdha në sferën e sundimit të ligjit. Ju faleminderit!

Drejtimitin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit! deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën, le të përgatitet Sadri Ferati.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Çështja e sundimit të ligjit paraqet një nga sfidat kryesore për Kosovën, nisur nga fakti që Kosova është në procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe në procesin e shtetndërtimit, problemet në fushën e sundimit të ligjit, kanë qenë jo të vogla.

Sundimi i ligjit në Kosovë, është barrë e Policisë së Kosovës dhe sistemit të drejtësisë me çka paraqitet edhe një dallim në fuqinë dhe efikasitetin e këtyre dy institucioneve. Por, këto institucione, posaçërisht komponenti i gjyqësisë dhe Prokurorisë, janë treguar të dobëta në funksionalizimin e qëndrueshëm të sundimit të ligjit. Që nga paslufta e deri me sot, roli i pranisë ndërkombëtare mbetet pothuaj se përcaktues në zhvillimin e sektorit të sigurisë dhe të drejtësisë e me këtë edhe në vendosjen dhe forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë.

Mungesa e qartësisë së mandatit të misioneve ndërkombëtare, veçanërisht EULEX dhe UNMIK, si dhe mungesa e një strategjie nga institucionet e Kosovës për t'i trajtuar sfidat në veri, ka krijuar hapësirë të madhe dhe klimë të favorshme për strukturat ilegale, të cilat e kanë shfrytëzuar për të forcuar edhe më shumë ndikimin e tyre në Kosovë. Kjo situatë mund të ilustruhet nga nxjerrja jashtë funksionit të pikave doganore 1 dhe 31, që Kosovës po i sjellin humbje të mëdha. Ndër sfidat kryesore në veri të vendit, janë mosekzistimi i institucioneve të Kosovës dhe veprimtaria ilegale e strukturave ilegale. Edhe më tutje mekanizmat shtetëror për zbatimin e ligjit nuk kanë arritur ta shtrijnë praninë dhe aktivitetin e tyre në tërë territorin e Kosovës, ndërsa në anën tjetër, qeveria e Serbisë me aktivitetet e saja në Kosovë, vazhdon t'i mbështesë strukturat ilegale, duke u ofruar mbështetje financiare, duke filluar nga gjyqësia, shëndetësia, arsimi dhe shërbimet e tjera komunale.

Edhe në mungesë të pranisë së institucioneve vendore, EULEX ka përgjegjësi dhe mandat ekzekutiv në veri. Ky mision dorëzohet në luftimin e krimit të organizuar dhe

krijimin e mjedisit të sigurt për të gjithë qytetarët. Grupet e caktuara të interesit ekonomik dhe politik në veri, janë të interesuar në ruajtjen e status-kvo në veri. Kufijtë e pakontrolluar krijojnë një klimë të përshtatshme për kontrabandim të mallrave nga Serbia në Kosovë dhe anasjelltas duke krijuar kështu mundësi për përfitim material. Nga raportet e ndryshme, besohet se ekziston një lidhje në mes grupeve kriminele me strukturat ilegale në veri. Për këtë luftimi i krimit nuk duhet të mendohet vetëm në veri të vendit, por në tërë Kosovën dhe grupet që kanë lidhje me krimin në veri, të luftohen po ashtu edhe bizneset që stimulojnë kontrabandën.

Atëherë, a vlen refreni i Qeverisë dhe i kryeministrit se askush nuk është mbi ligjin? EULEX nuk po i kryen punët për të cilat është ftuar në Kosovë duke filluar nga vendosja e doganave në veri, funksionalizimi i gjykatave në Mitrovicë, krijimin e kushteve për lëvizjen e lirë të shqiptarëve në territorin e Kosovës, mos arrestimin e as ngritjen e asnjë padie ndaj serbëve për krimet e kryera ndaj popullatës civile, mos nxjerrja para drejtësisë të anëtarëve të vet për kontrabandë duke e bërë në Kosovë e shumë të tjera e në anën tjetër arreston ushtarët dhe eprorët e UÇK-së për ta njollosur Luftën Çlirimtare të Kosovës, për të barazuar viktimën me agresorin, apo bastisjen dhe vjedhjen e zyrave të Shoqatës së Veteranëve të Luftës në Deçan, me qëllim të vjedhjes së ndonjë informate, me qëllim që më vonë këto të përdoren kundër vetë ushtarëve të UÇK-së.

Duke pasur parasysh këto elemente, duket qartë se për të pasur një shtet ku ka sundim të plotë të ligjit, është një sfidë e vërtetë dhe nuk mjaftojnë vetëm deklaratat se një shtet ka sundim të ligjit, por duhet të ketë veprime konkrete në këtë fushë. Përderisa sundimi i ligjit paraqet një proces me të gjerë se vetëm implementimi i ligjit, atëherë kemi të bëjmë me një varg institucionesh të cilat e bëjnë të mundur sundimin e ligjit në një shtet. Sundimi i ligjit paraqet një nga fushat më të rëndësishme të cilave duhet t'u kushtohet rëndësi gjatë procesit të integritetit, por gjithashtu parqet një kriter mjaft të rëndësishëm për hyrje në BE.

Qeveria e Kosovës krijon një taks-forcë për luftën korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar në koordinim me EULEX-in dhe institucionet tjera. Në të njëjtën kohë, ishim dëshmitarë të një lufte, fjala është mes zyrtarëve të lartë të Qeverisë dhe e atyre ndërkombëtar në lidhje me arrestimet e zyrtarëve të Qeverisë për korrupsion. Lufta për korrupsion dhe krim të organizuar nuk duhet të jetë një shtytje nga jashtë, por një nevojë për të përmirësuar imazhin e vendit, sundimin e ligjit dhe garantimin e lirisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nëse jeni dakord, shkurtoni pak fjalimet se edhe 24 deputetë janë të lajmëruar për diskutim. Mendoj që me 5 minuta thoni mjaft. Pra, shkurtoni vetë diskutimet se s'po dua të merret vendim.

Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën, le të përgatitet Shaip Muja.

SADRI FERATI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë përshëndes iniciativën dhe përkrahjen e Parlamentit që të debatohet për këtë çështje. Vërtet çështjet e sigurisë dhe të sundimit të ligjit janë çështje shumë me interes dhe mendoj se është një fushë e cila nuk e ka arritur progresin e pritur në Kosovë, në përgjithësi, prandaj duke dashur të kursej kohë, unë shpejt do të koncentrohem në pjesën që unë e shoh me interes të veçantë në këtë temë dhe që lidhet me veriun.

Të gjithë njohësit e mirë të situatës momentalisht në veri, besoj se seanca të tëra nuk do të mjaftojnë për të përshkuar se cila është situata momentale atje. Por, nga ana tjetër gjatë paraqitjes së dy ministrave- të Drejtësisë dhe atij të Punëve të Brendshme, ne konstatuam me të drejtë një përshkrim të një gjendjeje të vështirë dhe në mungesë të hapave të parë konkret se si të shkohet më tutje dhe të shënohet progres i nevojshëm. Ne jemi po ashtu të hendikepuar ngase një partner tejet i rëndësishëm siç është EULEX-i për të vu rend, rregull, për t'i kontribuar sigurisë dhe për të vendosur sundimin e ligjit në atë pjesë ne sot nuk kemi asnjë informacion zyrtar, së paku asnjë nivel të informatave nuk kemi një raport për të parë se cili është vlerësimi i vetë EULEX-it për mungesën e rezultateve në atë pjesë.

E di se ato që ne i kemi si informata publike apo që mund t'i konstatojmë se mund të jenë të gjitha pengesa, dalin të natyrës se Beogradit si një partner që stërmadhohej në atë pjesë, i mungon vullneti dhe e gëzon mungesa e bashkëpunimit të Beogradit në këtë fushë, në atë fushë dhe se gjithmonë gjatë gjitha pretendimeve dhe veprimeve të dobishme dhe konkrete, të gjitha veprimet ndërpriten në momentin kur thuhet që Beogradi nuk ka interes. E di se këtu mungojnë ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Integritetit Evropian, por unë përmes zëvendëskryeministrit, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme, do të kisha adresuar një pyetje konkrete. Ne të gjithë e dimë se 5 vende të Bashkimit Evropian nuk e kanë pranuar Kosovën, dhe shihet se cili është opstrukcioni dhe pengesa që i bëhet Kosovës gjatë të gjitha pretendimeve, qoftë në bashkëpunimet regjionale, qoftë në anëtarësimin nëpër mekanizma ndërkombëtar, ndërsa 22 vende të Bashkimit Evropian që e kanë pranuar Kosovën dhe shtrohet tash pyetja gjatë ecjes dhe progresit të Beogradit drejt nënshkrimit të kandidatit, por edhe në anëtarësimin në Bashkimin Evropian, cila është puna jonë dhe cili është reagimi i Bashkimit Evropian në sanksionimin e Beogradit në këtë sjellje që ajo po e bën?

Sundimi i ligjit nuk është thjeshtë një ambicie politike që do ta cenonte misionin e EULEX-it në atë pjesë, por sundimi i ligjit janë vlera të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë, në vetë sundimin e ligjit, por dhe stabiliteti në atë pjesë dhe bazohet në vlerat universale dhe në vetë misionin e EULEX-it që e ka për atë pjesë. Dhe, çështja e dytë që është shumë me interes për të parë se cila është mbështetja vërtet e Bashkimit Evropian për EULEX-in, është një çështje e një blerje të kohës, është çështje e bindjes deri në pafundësi të Beogradit apo është realisht një mision real i cili mund të realizohet. Pritjet e opinionit kosovar dhe institucioni i Republikës së Kosovës, në këtë drejtim kanë qenë shumë të mëdha, dhe fundi nga këto dilema dhe vështirësi që i kemi, pa qare shtrohet një dilemë. Në këtë ecje të Beogradit, në momentin kur cilindo nënshkrim të parë që do ta vendosë Beogradi, do të lejohet që me Kushtetutën ekzistuese ai të nënshkruan këtë

progres kah integrimet evropiane. Unë po besoj se, nëse ndodhë kjo, atëherë gjithçka është në lajthitje. Prandaj, në rend të parë unë mendoj se puna e institucioneve të Republikës së Kosovës, duhet të jetë në vazhdim të partneriteti, në fuqizimin e aktorëve dhe të misionit ndërkombëtare që, në atë pjesë të Kosovës të realizojnë misionin e tyre, por edhe njëkohësisht që të matet edhe fuqia e përkrahjes së këtyre misionëve dhe institucionet e Republikës së Kosovës, në përgjithësi që të mund t' i kryejnë punët e tyre. Ne tani prapë edhe këto ditë e kemi aktuale realizimin e implementimit të pakos të presidentit Ahtisari, e implementuar në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe pikërisht opstrukcioni dhe pengesat që i bëhen institucioneve të Republikës së Kosovës në atë pjesë, shtrohet pyetja tash në të vërtetë ku jemi.

Beogradi sillet në stilin që institucionet e Republikës së Kosovës dhe Kosova e kanë pranuar pakon e Ahtisarit, prandaj unë nuk kam obligime, hajt çka do të nxjerri plus. Prandaj e gjithë kjo situatë, unë mendoj që përgjigjen duhet ta gjejmë në partneritetin, në institucionet e Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe atje të marrim përgjigje se cili është qëndrimi i Bashkimit Evropian në raport me avancimin e statusit të Republikës së Serbisë drejt anëtarësimit, në këtë Kushtetutë apo ka kritere në këtë çështje, cila është mbështetja e misionit të EULEX-it në sundimin e ligjit? Pra, pastaj të gjithë bashkë të veprojmë të implementojmë, qoftë planet e deritashme që i kemi pasur apo edhe të hartojmë strategji të reja, fundi i fundit në mënyrë që institucioneve të Republikës së Kosovës t'ju krijohet hapësira që nga prezenca, sepse në veri po e rrumbullakoj me një formulim të përgjithshëm, ekziston një deficit i tillë i sundimit të ligjit që prej lirisë të menduarit edhe deri tek lufta e krimit të organizuar. Prandaj, marrë në përgjithësi, po e them, jemi shumë të vetëdijshëm se situata është shumë e vështirë, por edhe nuk duhet të sillemi sikur situata është pa shpresë. Dhe, unë mendoj që, pas këtij debati dhe këtyre konkluzioneve nuk duhet që kjo temë të konsiderohet e shterur, por që shumë shpejtë para Parlamentit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, të shtrohen detyrat konkrete, në mënyrë që edhe atje të shënohet progres. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Shaip Muja, le të përgatitet deputeti Albin Kurti.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra, deputetë,

Unë do të mundohem të jem pak më i shkurtër, me propozime pak më konkrete, sepse shumica nga deputetët, shqetësimet e veta, të cilat gjatë diskutimeve i dëgjuam, ndoshta dhe i kanë përmbushur ato që unë kisha për t' i thënë. Meqë ne sot jemi duke diskutuar për kërkesën e deputetit Nait Hasani, për ligjshmërinë, sigurinë, Kushtetutën, implementimin e pakos së Ahtisarit, unë mendoj që siguria në Kosovë rrezikohet kryesisht nga veriu, por është edhe shtrirja gjeografike dhe prezenca institucionale e EULEX-it në institucionet tona, nuk është shumë e kënaqshme.

Çka unë propozoj, mendoj që për veriun duhet definuar roli i UENIT në veri, ata nuk janë treguar deri më tani partner të qëndrueshëm. Ato shihen nga raportet të cilat janë bërë deri me tani, qoftë nga përfaqësuesi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ose nga

manifestimet atje që bëhen dhe lidhshmëria e tyre me institucionet paralele të Serbisë në Republikën e Kosovës.

Dy, EULX-i jo vetëm që duhet të jetë aktiv, por edhe prezent në veri. Stafi i EULEX-it dhe organizmat ndërkombëtar, duhet të shkojnë të jetojnë në veri, jo të shkojnë si vizitorë, po të jetojnë atje, të jenë 24 orë me veprimtarinë e vet me të gjitha segmentet e sigurisë të veprimeve aktive që e kanë edhe mandatin dhe tutje.

Për KFOR-in, mendoj se nuk duhet të reduktohet absolut. Ne jemi duke dëgjuar se do të reduktohet, por mendoj se nuk duhet të reduktohet pa u adresuar funksionimi i pikave kufitare dhe gjyqi në veri. KROR-i duhet të jetë prezent, do të thotë kur funksionalizohen të gjitha pikat kufitare në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Statusi i kandidatit për Serbinë gjatë bisedimeve që ne do t'i kemi, ndoshta në pikat tjera duhet të ndërlidhet edhe me pranimin e sovranitetit të veriut, me theks të veçantë nga Republika e Serbisë, të tërhiqet nga veriu me segmentet e veta.

Qeveria e republikës së Kosovës, po ashtu duhet të jetë më aktive në këto katër pikat tjera, qoftë në qëndrimin e saj për UAMIN, qoftë për qëndrimin e saj për EULEX-in dhe KFOR-in, po ashtu. Pra, propozoj që Komisioni për rend dhe ligj, së bashku me një grup parlamentar tjetër më të zgjeruar, të paraqesin një rekapitullim dhe një analizë më të qartë të situatës dhe në një seancë të radhës, të bisedohet dhe të shihet që këto shqetësime të paraqiten edhe në Bruksel, por edhe në Kombet e Bashkuara për prezencën edhe të UE-nit edhe të EULEX-it, i cili ka marrë mandatin edhe nga Parlamenti Evropian. Do të thotë, me homologët tonë të Parlamentit Evropian, ne duhet t'i paraqesim shqetësime të cilat janë duke u evidentuar praktikisht për veprimtaritë që është duke i bërë edhe EULEX-i, dhe në mënyrë institucionale të paraqiten shqetësimet ose të plotësohen ose të reduktohet prezenca e tyre në Kosovë.

Propozoj po ashtu që çdo muaj së paku të analizohet situata, jo me kërkesë të një deputeti të Parlamentit, por Komisioni për Rend dhe Ligj, së bashku me komisionet tjera përgjegjëse se është edhe si problem multidisiplinar, të jetë një lloj raportuesi në Parlament mbi situatën, të arriturat, sukseset të cilat janë duke u implementuar, qoftë edhe në veri sepse nuk ka asnjë kuptim që ne, në mënyrë përshkruese të themi çdoherë se është duke u arritur. Ministrat dhe Qeveria janë implementues. Parlamenti nuk duhet të jetë konkludues, i cili duhet vetëm të përshkruajë për situatën, prandaj, ne duhet të kërkojmë një raport më praktik për kohën, afatet të cilat janë imperativ dhe kërkesë e popullit edhe është edhe i zhvillimit të Kosovës që mos të zihet peng edhe në integritet e ardhshme të cilat ne po i synojmë edhe jemi të obligueshëm në aspekt kushtetues. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Albin Kurti, le të përgatitet deputeti Sali Asllanaj.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para 3 vjetëve, kur ne të “ Vetëvendosjes” e kundërshtonim ardhjen e EULEX-it, zyrtarët që sot po e kritikojnë EULEX-in, ishin me EULEX-in e kundër “Vetëvendosjes”. Në deklaratimet e tyre publike e zyrtare ishin kundër nesh, në debate televizive ishin kundër nesh, kurse atëherë kur ne ndërmerrnim ndonjë aksion a aktivitet kundër EULEX-it, këta na dënonin publikisht dhe e ndërsenin policinë kundër nesh.

Përse është kështu, pse këta njerëz ndryshuan dhe si ndryshuan? Një pjesë të tyre u bie ndërmend që EULEX-i është i keq vetëm atëherë kur cenohen personalisht ose kur rrezikohen kolegët e tyre partiak, pjesa tjetër duket e paaftë që ta analizojë qenien dhe karakterin e mekanizmave ndërkombëtar dhe vetëm kur përballen me pasojat e skajshme të veprimeve të atyre mekanizmave, vetëdijesohen se çka na paskan qenë ato. Para se të jetë problemi te aksionet spektakulare të EULEX-it, apo të mentaliteti i personelit të EULEX-it, problemi qëndron te baza legale dhe juridike e EULEX-it, pra para se të jetë problemi te njerëzit e EULEX-it, problemi konsiston në përshkrimet e vendeve të punës të tyre.

Misioni i EULEX-it dhe jo mendësia apo sjelljet e ndokujt në EULEX, janë problemi themelor. EULEX-i bazohet në dokumentin e veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt të vitit 2008. Jo rastësisht, 13 ditë para se të shpallet pavarësia e Kosovës, janë kujdesur që t’ia vendosin bazën EULEX-it, e cila është botuar në “Gazetën Zyrtare” të Këshillit të Bashkimit Evropian, më 16 shkurt 2008, pra vetëm një ditë para se të shpallet pavarësia e Kosovës.

Neni 3.h) i këtij dokumenti thotë se EULEX-i mund të marrë edhe përgjegjësi të tjera, pavarësisht ose në përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, që të sigurojë edhe të mirëmbajtje promovimin e sundimit të ligjit, rendin publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë e rëndësishme të Këshillit të BE-së. Me këtë nen, EULEX-i pajiset me fuqi ekzekutive praktikisht të pakufizuara edhe në spektrin e tyre, natyrisht përveç që janë të pakufizuara në kohëzgjatjen e tyre.

Kur fuqive ekzekutive të EULEX-it, i shtohet edhe imuniteti nga ligji në Kosovë, i pjesëtarëve të tij dhe fakti që EULEX-i bazohet edhe në Rezolutën 1244 e në 6 pikëshin e Ban ki Munit, gjithnjë duke mos e njohur pavarësinë e Kosovës, për veprimet e EULEX-it mund të befasohemi vetëm me ata që janë befasuar. EULEX-i, pra është veç se shtylla e parë e re e UNMIK-ut, ajo që dikur ishte Shtylla e parë e UNMIK-ut, përkatësisht policia dhe Departamenti i Drejtësisë, tash është të EULEX-i. Asgjë nuk ka ndryshuar në këtë aspekt.

Por, si e definojnë EULEX-i vetveten? EULEX-i veten e quan : “operacion për menaxhimin e krizave”, pra, jo për zgjidhjen e krizave, për menaxhimin e krizave. A thua se krizat janë këtu për të qëndruar këtu, por për t’u menaxhuar. Menaxhimi i krizës nënkupton që do të ketë kujdes që kriza të mos shpërthejë, por jo edhe të eliminohet plotësisht. Dhe, prej nga vjen kjo? Vjen prej korrikut të vitit 2006, konceptit për menaxhimin e krizave të Javier Sollarës, pararendësit të baroneshës Eshton. Në korrik të vitit 2006, Bashkimi Evropian si pjesë të politikës së jashtme dhe sigurisë e ka etabluar konceptin e menaxhimit të krizave dhe mishërim i këtij koncepti është EULEX-

i si mision i cili e definon veten si operacion për menaxhimin e krizave. Në këtë kuptim, misionet ndërkombëtare në Kosovë duke përfshirë edhe EULEX-in, fizikisht janë misione të pasluftës, por politikisht janë misione të paraluftës. Këta janë këtu në mënyrë që lufta e konfliktet të mos shpërthejnë sërish, sepse po të ishin misionet e pasluftës, atëherë paradigma do të ishte zhvillimi, jo stabiliteti. Me vetë faktin që doktrina e tyre themelore është stabiliteti dhe janë këtu për ta menaxhuar krizën, kjo tregon se ata vetëm kujdesen që të mos rishfaqet konflikti, përkatësisht të mos ndodhë shpërthimi i krizës, sepse: zhvillimi, demokracia, drejtësia nuk janë fjalët e tyre. Fjala e tyre e parë dhe e fundit është stabiliteti. Ky është stabiliteti i Kosovës, makro-politik në funksion të stabilitetit rajonal.

Prandaj, edhe kur thonë njerëzit e EULEX-it, sundimi i ligjit, nuk e mendojnë as drejtësinë për qytetarët, as të drejtat për qytetarët, kur thonë sundimi i ligjit, e mendojnë stabilitetin e përgjithshëm. Gjithashtu, është e vlefshme të theksohet që në këtë kuptim nuk mund të thuhet që EULEX-i ka dështuar, sepse ai nuk na konsideron vend normal, që duhet për t'u zhvilluar me demokraci, me drejtësi e kështu me radhë. Në krahasohemi me vatrat e tjera të krizës, nëse lexohen gazetatat kryesore nëpër botë, nëse shihen deklaratat e zyrtarëve e diplomatëve të rëndësishëm të qendrave të vendosjes, atëherë shumë thjeshtë kuptohet që në krahasohemi me: Afganistanin, me Palestinën, me Bosnjën dhe, nëse jemi më mirë se ata, konsiderohet që është mirë edhe në Kosovë.

Kosova në këtë aspekt është disi e kundërt me Greqinë. Greqia është një vend normal, me situatë anormale, ndërkaj Kosova konsiderohet si vend jo bash normal, por me situatë normale. Prandaj edhe në raportet e ndërkombëtarëve, sidomos të EULEX-it në: Bruksel, Nju Jork, Uashington, Londër, Berlin, Paris e tjera, thuhet situata në Kosovë është e qetë, por e tensionuar, tamam siç po flet edhe ministri Rexhepi, e brishtë, e qetë, stabile, nën kontroll, por e tensionuar. Çka domethënë kjo e qetë, por e tensionuar? E qetë, por e tensionuar domethënë e qetë, më mirë se në Afganistan, e tensionuar, ndërkombëtarët duhet të vazhdojnë të rrinë këtu, me fuqitë e tyre ekzekutive. Unë nuk jam kundër prezencës së bashkësisë ndërkombëtare këtu, por kundër karakterit të kësaj prezence, kjo është prezencë sunduese, sepse kanë fuqi ekzekutive dhe imunitet prej ligjit. Pra, qenia e EULEX-it është problem, para se të jenë aksione spektakulare të EULEX-it. Neve po duhet veç të na ndodhin këto aksione, të arrestohen ushtarët e UÇK-së, për të marrë vesh valla qenka i keq EULEX-i. Lexoni dokumentet bazë të EULEX-it dhe merrni vesh që është i dëmshëm, sepse është i padrejtë.

Në raportin që e lexova, njoftimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme, flitet gjithmonë për marrëdhëniet ndëretnike, shumë shpesh aty. Unë mendoj se kjo është e gabueshme. Konflikti nuk vjen prej dallimit etnik a kombëtar, por pse njerëzit e caktuar janë në listë të rrogave në Beograd. Duke folur për tensionet ndëretnike në Kosovë, Ministria e Punëve të Brendshme, po dëshiron t'i fajësojë serbet lokal dhe ta shfajësojë Beogradin, me të cilin kjo Qeveri po bisedon në Bruksel. Pra nuk është puna pse dikush flet shqip e dikush serbisht edhe tash aty ka konflikt. Nuk është dallimi kombëtar ai i cili e prodhon konfliktin, por janë programet hegjemoniste të Beogradit, për një shekull e gjysmë i kanë pasur 24 programe, prej Garashaninit e deri te Dobrica Qosiqi e Milloesheviqi, pra 24 programe. Nuk është puna që ai serbi atje po i rreh shqiptarët apo po i vret

shqiptarët në veri ose kudo tjetër për shkak se ai është serb e ky është shqiptar, por nuk është tensioni ndëretnik, as konflikti nuk është shqiptaro-serb, konflikti është shqiptaro-Serbi, sepse në këtë mënyrë po shfaqësohet Beogradi, kur thua ti - marrëdhënie ndëretnike ose tension ndëretnik.

Dhe, tjetra që desha të them, është se ne nuk mund t'i përkrahim këto 4 pika të rekomandimit. Dorën në zemër, tri të parat pak a shumë janë përmendur edhe dje në atë mocionin. E para nuk është votuar me shumicë, por e dyta dhe e treta janë votuar edhe ne konsiderojmë që tri pikat e para tashmë janë përfunduar. Problemi me pikën e katërt është se ne nuk jemi për implementimin e pakos së Ahtisarit se mendojmë se ajo hedh farën e Bosnjëzimit në Kosovë edhe nuk mund të jesh edhe për planin e Ahtisarit edhe tash të çohesh për ta kritikuar Piter Fejthin, EULEX-in se EULEX-i vjen prej IESDIPI- atij misionit për siguri dhe mbrojtje të Bashkimit Evropian, politikës të Bashkimit Evropian për Mbrojtje dhe për Siguri. Pra, në njërin anë e pranon planin e Ahtisarit e në anën tjetër kritikon Piter Fejthin dhe EULEX-in, kjo është hipokrizi. Plani i Ahtisarit është i padrejtë, është i dëmshëm edhe implementimi i planit të Ahtisarit në veri, a e din çka shkakton? Vetëm komunën e veriut të Mitrovicës, kurrëgjë tjetër. Edhe mos harroni nuk mundet EULEX-i neve të na bëj sovranitetin, nëse e kemi shpallur Kosovën të pavarur, po e bëjmë sovranë, ama tjetërkush nuk ta bën sovranitetin. Sovraniteti nuk të dhurohet prej dikujt tjetër, ose e merr vet ose nuk e merr hiq e kur nuk je ti sovran, është dikush tjetër. Pra, mendoj që duhet vullnet politik për këtë gjë edhe duhet të jemi më shumë të sinqertë edhe më serioz edhe ndaj qytetarëve edhe me njëri tjetrin.

Edhe, tjetra që besoj se është e rëndësishme është që- a e a e dini në çfarë shtate jemi ne? Në kohën e Serisë, në vitet e '90-ta kemi qenë si ai i burgosuri politik të cilin e rrahin e torturojnë, por nuk lëshon pe edhe i ka qëndrimet politike. Prej burgut kemi kaluar në spital. Tash pacienti, domethënë bëhet fjalë për një person për të cilin ,prapë mjekët, kolegji i mjekëve vendos, nuk ekziston më dhuna e kohës të Serbisë, por na kemi kaluar që 12 jemi në spital, por po dua të them ndryshimi nuk vjen prej mjekëve, nuk vjen prej motrave medicinave, ndryshimi vjen prej atyre që gabimisht ju kanë thënë pacientë e nuk janë pacientë. Kur të organizohen e të mobilizohen ata që i kanë karakterizuar gabimisht si pacientë, atëherë vjen edhe ndryshimi. Prandaj, po më duket që po e kapim pak problemin prej bishtit e jo nga koka ku është e kjo është e kjo është baza legale juridike e EULEX-sit si vazhdimësi e UNMIK-ut dhe gjithçka çka ka ndodhur këtu pas luftës që ka filluar dhe ka mbaruar me Rezolutën 1244. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Sali Asllanaj e ka fjalën, le të përgatitet Halit Krasniqi.

SALI ASLLANAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Përsëndetje për zëvendëskryemministër,

Ministër e Punëve të Brendshme,

Unë do të filloj së pari me EULEX-in, sepse edhe nga fjala hyrëse e deputetit Hasani, ishte pikë kryesore e vërtetimit puna e EULEX-it, që mendoj se situata e sigurisë dhe

ligjshmëria në Kosovë është diçka një koncept më i gjerë se vetëm EULEX-i dhe vetëm një segment i sigurisë në Kosovë është EULEX-i.

Unë kisha dashur që më shumë të orientoheja që t'i shikojmë dobësitë tona, të organeve tona për të cilat këto organe janë përgjegjës ndaj neve dhe ndaj Parlamentit japin llogari, e më pak ndaj misionëve të huaja të cilat kanë ardhur si një fryt i një procesi të gjatë të ecajakes së Kosovës së pavarur. Në këtë aspekt unë mendoj që nëse pretendojmë që të ecim nga Evropa, atëherë edhe fjalët që përdorim këtu ndaj EULEX-it, do të duhej të ishin shumë me masë, sepse nuk kemi variant tjetër të ecim nga lindja. Konsideroj që agjenda e EULEX-it nuk është ajo e duhura, nuk është ajo që na pëlqen të gjithëve, por në të njëjtën kohë, konsideroj që realisht kemi pasur nevojë, i kemi vlerësuar edhe tek e fundit kemi ftuar EULEX-in që të vijë në Kosovë.

Tjetër, kisha dashur që të vlerësoj edhe EULEX-in tonë, të themi Policinë tonë të Kosovës. Spektakulariteti i EULEX-it, disa arrestime që bënte, diçka të ngjashme bëri edhe Policia jonë në Prishtinë sikur dha për të kuptuar që në një komunë ku kjo qeveriset nga një parti tjetër, mund të bëhen gjëra të tilla dhe mund arrestohen një grup i nëpunësve civil, që për mendimin tim duke e njohur problematikën e administratës komunale, vërtet nuk do të duhej të kishte arsye. Krimet eventuale që ndodhin në administratën komunale, janë krime me letra dhe jo me fjalë dhe çfarëdo pune që ka bërë dikush të keqe, mundet me dokument të dëshmohet dhe në asnjë mënyrë të bëhen aso arrestime spektakulare që për mendimin tim dhe kam të drejtë ta kem një perceptcion të tillë që mund të jetë si një tendencë të frikësimit të opozitës, sepse atë komunë e udhëheqë kryetari i opozitës, kryetari Isa Mustafa, i cili ka dëshmuar se di të qeverisë dhe di të udhëheqë komunën. Prandaj kisha pasur dëshirë që në një mbledhje të ardhshme nëse ka mundësi të thirret edhe drejtori i përgjithshëm i Policisë dhe të japë një përgjigje adekuate lidhur me atë se si ka shkuar ai proces.

Tjetër, unë kisha dashur që të pajtohem me disa deklarime dhe me diskutimin e të zotit Selimi, i cili dha shifra që për krime ordinere themi në Kosovë, objektivisht qëndrojmë diku afër ndoshta edhe në mesatare me të gjitha vendet e botës dhe të Evropës, por kisha dashur që të potencoj edhe atë që aktiviteti dhe puna e Policisë, sot matet me sa është njeri ta luftojë krimin e organizuar, kontrabandën dhe korrupsionin. Në këto tri aspekte mendoj që objektivisht kemi dështuar dhe vetëm si dështim i tillë, e kemi sot EULEX-in. Në atë moment kur zoti ministër do ta ketë epror organizativ, kryeministër, por epror të vetin të veprimit do ta ketë ligjin, në atë moment kur ministri i Punëve të Brendshme do të thotë që po, unë jam në gjendje pa e këqyrë emrin, mbiemrin dhe biografinë e secilit, të marrë masa ligjore ndaj secilit që e shkel ligjin, në atë moment nuk do të kemi nevojë për EULEX-in. Deri atëherë ju qoftë për hair të gjithëve EULEX-i. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputetë! Veç po ta përkujtoj që këtu ndaj nesh kanë përgjegjësi ministrat, kurse drejtorët janë vartësit e ministrave dhe ekzekutiv dhe ne nuk kemi punë me drejtorët. Ju faleminderit shumë. Vazhdojmë.
Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar e të respektuar kolegë deputetë,

Më herët është dashur ta trajtonim këtë rend të ditës, që do të bëhej edhe kryetemë e ditës, sepse është kryekapitulli i jetës sonë në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen dhe ky vlerësim do të na shoqëroj gjatë. Madje, sa më shumë të krijohet distanca në ardhmëri, do të çmohet e të vlerësohet më shumë, sepse është kryefjalë e sistemit tonë të vlerave të nëpërkëmbura, të cilat janë të vlerësuara e të çmuara në çdo kohë prej se ka filluar civilizimi në çdo meridian të këtij globi.

Të nderuar deputetë,

Nga 12.000 të vrarë gjatë luftës çlirimtare, nga 2500 dëshmorët, nga afër 5000 të rrëmbyer, 1.821 prej tyre, që ndryshe i quajmë të pagjetur, janë ende pa varre, dhjetamijë të plagosur që vuajnë nga pasojat e gjymtimit, qindra fshatra janë shkatërruar, dëme të pallogaritshme ende saktësisht, në shtëpi të djegura e me pasuri të shkatërruara, dhe si tërësi, përbëjnë tragjiken tonë të dhimbshme dhe krenare, që jo ky brez, se nuk mund t'i harrojë, por as sa të ekzistojë kjo botë jona, gjithmonë do të kujtohet me pietet dhe nuk mund të abstrahohet se këto i ka bërë Serbia me çmendurinë e saj.

Gjatë luftës në bjeshkët dhe në vargmalet e Malishevës, janë strehuar mbi 250 mijë qytetarë të Malishevës dhe të komunave të tjera të Kosovës. Vetëm në vargmalet e Bjeshkëve të Berishës janë strehuar 85 mijë qytetarë, ndërsa pjesa tjetër në: Pagarushë, Gurbardh, Panorç, Turjakë, Burim, e në Male të Sverkës, Damanekut, Bubavec dhe të tjera.

Gjatë luftës në Malishevë janë kryer tri masakra mizore nga forcat militare e paramilitare serbe mbi civilët e paarmatosur, për të cilët asnjëherë nuk është përgjigjur askush...

KRYETARI: Halit, kthehu në temë, se larg ke shkuar!

HALIT KRASNIQI: Zoti kryetar, unë jam në temë për të cilën e kam kërkuar këtë seancë.

Therjet me thika dhe torturat tjera mesjetare që zor se mund të përshkruhen realisht, plot trishtim dhe të paharrueshme që nga Gullboci, Burimi e deri në Bellenicë, kështu mund të vazhdoj me përshkrime rrëqethëse gjithandej në tërë anën e Llapushës, për të vazhduar me lemeri e dyshim se mund të hyjë në hak e të ngarkohem me mëkate, sepse mund të mos bëj përshkrim të saktë për dhunën në tërë Drenicën, në gjithë Dukagjinin, pothuaj se anë e kënd Llap e Gollak, në Shalë të Bajgores, në Nerodime, Kaçanik e deri në Karadak.

Në çdo arrestim të djemve të UÇK-së pas luftës, të gjitha këto kujtime të rënda i kanë ringjallur keq të gjithë ata që e kanë përjetuar luftën. Kështu ka ndodhur edhe në Malishevë me rastin e arrestimit të djemve të UÇK-së. Të gjithë këta djem të arrestuar, iu kishin përkushtuar shërimit të plagëve të luftës dhe ndërtimit të jetës së re, pa rënë ndesh asnjëherë me ligjet e shtetit të ri që po krijonim këto dhjetë vjet. Edhe më tepër i ka

irrituar lajmi i dhënë në mediat elektronike me gjeneralitete të ish- administratës serbe, që të jepnin ide dhe ta krijonin bindjen se skenari është bërë në Beograd dhe është zbatuar me besnikëri nga EULEX-i. Sepse ato vendlindje të arrestuarve nuk janë të komunave të Rahovecit, të Therandës e të Drenasit, që kanë qenë nën administrimin e dhunshëm të Serbisë. Ky fakt në përshkrimet e publikuara tanimë, i ka lajthitur zyrtarët që e kanë konstruktuar këtë proces, duke ua zbuluar adresën nga e kanë marrë gjithë narracionin somnambul e hiçkokian.

Masakrat gjatë luftës të bëra nga Serbja, do të ishin më të mëdha dhe më të numërta, sikur mos të ishin atëherë, pikërisht këta djem të armatosur dhe në uniformë të UÇK-së, të cilët janë burgosur tani. Këta djem, së bashku me shokët e tyre të uniformuar, penguan pikërisht ato personazhe me uniforma të ushtrisë dhe të milicisë së Serbisë, për të cilët janë burgosur, se do të vazhdonin të masakronin civilë të paarmatosur. Jo vetëm Brigada 121, por asnjë brigadë e UÇK-së, nuk ka shkelur ligjet e luftës. Asnjëherë nuk ka shkelur, nuk ka kaluar në Serbi për të masakruar gra e fëmijë e për të dhunuar, ashtu siç bëri ushtria dhe milicia e Serbisë në Kosovë. Madje as këtu në Kosovë, në vendbanime me serbe civilë, nuk ka ndodhur një gjë e tillë edhe pse të gjithë, vendorë e ndërkombëtarë jemi të bindur se ka ekzistuar teorikisht një mundësi e tillë, sikur mos të ishte ai kod që i ka ndaluar dhe udhëhequr ushtarët e UÇK-së.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vetëm për këtë ngjarje ky Parlament është dashur të takohet në një seancë me rend të ditës: Çfarë sistemi të vlerave po ndërtojmë, cili është misioni i EULEX-it, a është ky mësimi për shtetin juridik të së drejtës, sa është në shërbim të Serbisë ky mision dhe sa në shërbim të mandatit që ka?

Ne e dimë se përmes personelit të shteteve, të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, Serbia do të bëjë ndikimin e saj brenda EULEX-it. Dhe, qëllimet e Serbisë i njohim fare mirë, gjithashtu edhe strategjinë e saj për t'i ndëshkuar të gjitha personazhet e luftës së UÇK-së, për të armiqësuar skenën politike dhe konfrontimin e shqiptarëve me misionet e bashkësisë ndërkombëtare.

Qëllimin e parë, për t'i ndëshkuar personazhet e luftës e ka arritur pjesërisht, por ende nuk ka mundur ta realizojë në masën e kërkuar dhe të dëshiruar prej saj! Qëllimin e dytë, armiqësimin e skenës politike e ka realizuar mjaft mirë bile, herë-herë në mënyrë mjaftë përfekte, aq sa qytetarët e ndershëm i përshkon mornica me drithërima nga koka deri të këmbët, sepse realizohet në mënyrë jashtëzakonisht perfide, duke ndërtuar një perceptim publik, me motive pseudo-patriotike, duke plasuar teori e koncepte pseudoatdhetare si imediat për t'u zgjidhur tani dhe hiq më vonë çështjen shqiptare, duke i atribuar vetës përshkrime me cilësorët për të krijuar aureolën për kondicion skënderbegian, për parimësi e devocion të Abdyl Frashërit, për sens diplomatik e pragmatizëm politik të Ismajl Qemajlit, për oratori të Fan Nolit, për guxim e erudicion të Ukshin Hotit, dhe më përpjekje të sikletshme për të shpërfaqur diçka, bile diçka çka do qoftë nga karakteri dhe rrezatimi i auroles se komandantit legjendar Adem Jasharit, i cili në këtë kohë, as në

aparencë dhe as në frymë, me përmasat e krijuara të kryeheroit, nuk mund të emitohet çfarëdo përpjekje dhe nga kushdo qoftë edhe më pak në këto imazhe që shpërfaqemi.

Ndërsa, qëllimin e tretë, që gjithashtu shumë e dëshiron Serbja, konfliktin me mbështetësit tanë të faktorit ndërkombëtar, kohë pas kohe e bëjmë të atakueshem edhe këtë objektiv, nëpërmes disa zhvillimeve e skenarëve të katapultuar nga zyrtarë ndërkombëtarë, në të shumtën e rasteve, kryesisht zyrtarë të shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, në të cilët skenarë jemi hendikepuar dhe i kemi përvetësuar me naivitetin e pafalshëm.

Lëvizje e radhës e skenarëve të Beogradit zyrtar dhe të implementuar nga EULEX-i, është edhe kjo valë e arrestimeve, nëse flasim me gjuhën juridike, të mos themi me motive të dyshimta.

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,
Këtë seancë është dashur ta mbajmë edhe vetëm për rastin e arrestimit të drejtorit të policisë për regjionin e Prizrenit. Jo pse është arrestuar një oficer i lartë i policisë së regjionit, por për mënyrën e arrestimit. Duke mos respektuar autoritetet e larta zyrtare të shtetit tonë dhe duke dashur të bëjë spektakël gjatë arrestimeve, misioni i EULEX-it, atë ditë ka rrezikuar jetën e policëve duke krijuar motive për konfrontim me armë të drejtuar njëri kundër tjetrit, dy skuadra policie të të njëjtit shtet. Unë kam besim të plotë në deklaratat e Ministrit Rexhepi, por ai duhet të kërkojë përgjegjësi nga dy drejtorët e tij në Prishtinë, të cilët e kanë rrezikuar jetët e policëve të tyre dhe imazhin e shtetit, pa dijeninë e të cilëve në asnjë mënyrë nuk ka mundur të zhvillohet operacioni. Është arrestuar njeriu që ka krijuar rend dhe ka urdhëruar respektimin e ligjit për më se dhjetë vjet në regjionin e Prizrenit dhe gjetiu ku është kërkuar prej tij dhe ku e ka kërkuar detyra atë. Ndërsa, për më se dhjetë vjet tolerohen shkelësit e ligjit dhe cënuesit e Kushtetutës së vendit në veri të Kosovës.

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë!
Kjo seancë është dashur të mbahet gjithsesi edhe vetëm për një zhvillim tjetër në këtë ditë. Ka ndodhur një precedent tjetër edhe më i rëndë, ndaj të cilit nuk do të duhej të ishte kaq indiferent ky Parlament. Në këtë ditë është shkelur akti themeltar i këtij shteti. Është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Duke e ndalur në bisedë, deputetin Fatmir Limaj, në ndërtesën e EULEX-it për më se dy orë, është krijuar precedent i përdhosjes së vlerave më sublimë të këtij shteti të prodhuara nga ky institucion më i lartë shtetëror. Çfarë kuptimi ka përmbajtja e Kushtetutës, nëse ne lejojmë që ajo të shkelet para syve tanë. Çka mbetet e shenjtë tani këtu nëse do të lejojmë, nuk do të ishte e tillë kjo Kushtetutë dhe çka ka të paprekshme, nëse nuk do të ishte e tillë kjo Kushtetutë, si në çdo shtet juridik? Secili prej nesh e, edhe deputeti Fatmir Limaj, nuk mund t'i ikë përgjegjësisë nga ligji, eventualisht po të gjendet ndonjë fakt se ka rënë ndesh me të. Por, Kushtetuta e përshkruan qartë, kur dhe si. Këtë e ka bërë logjika juridike dhe eksperiencia në shtetet ligjore të së drejtës, duke njohur shembuj abuziv dhe zyrtarë abuzues, si autori i historisë së trilluar të 80 milionëve. Duke kujtuar këtë histori linçimi e promovuar për Deputetin Fatmir Limaj, çdo ndjekje, jo për motive nga lufta e UÇK-së, që për satisfaksion në çfarëdo, gijotina e akcilit përfundoi, e bën hero, por për çfarëdo skenari

tjetër, dhe motive tjera, e bën të pabesueshëm për publikun edhe kur verdikti të bëhet i plotfuqishëm nga instancat kompetente.

Ndalet në bisedë informative deputeti që duhet të gëzojë me kushtetutë mbrojtje dhe imunitet, ndërsa lejohen njerëz të tjerë në veri të vendit tonë, të shkelin ligjin. Lejohen të mos respektojnë rendin kushtetues dhe të bëjnë hapur veprime inkriminuese, të vendosin rend e ligj të xhunglës, duke përdhosur sistemin e vlerave juridike dhe gjithçka që është krijuar këtu nga vendorë e ndërkombëtarë. Vetvetiu, patjetër dhe gjithsesi më imponohet pyetja logjike: përse ka ardhur këtu misioni i EULEX-it dhe cili është mandati i tij?

Edhe më të dyshimtë dhe më trishtueshëm i bën këto arrestime koha kur këto veprime janë bërë. Lënda, thuhet se është e para 12 vjetëve. Në këtë kohë kur është hapur kapitulli i bisedimeve me Serbinë, pse u vendos pikërisht tani në këto zhvillime të urdhërohen arrestimet? Edhe më të dyshimtë, edhe më të dhimbshëm e bën fakti se kriminelët e shumtë, që i ka Serbia edhe në pozita të ndryshme lokale, e gjetiu nëpër Serbi, nuk është ndërmarrë ndonjë fushatë ndaj tyre. Edhe më të dyshimtë e bën procesi, fakti i tolerimit të kriminelëve të njohur të cilët livadhisin brenda kufijve të Kosovës, përkatësisht në veri të saj, para syve të personelit të EULEX-it dhe para syve të publikut.

Këtu në këtë foltore, për EULEX-in paraqes një kërkesë: Lironi nga burgu djemtë e lirisë dhe burgosni zyrtarë serbë dhe të tjerë që ushtruan dhunë e terror të asaj përmase trishtuese, saqë e lëvizi gjithë ndërgjegjen botërore dhe mobilizoi tërë atë potencial njerëzor, gjithë atë teknikë e teknologji luftarake nga toka, nga uji dhe nga ajri, të cilin nuk e kishte parë ky kontinent! Ndërsa për Brukselin parashtroj një kërkesë gjithashtu të vetme: të kërkoj nga EULEX-i që të respektoj misionin e tij, duke vendosur rend e ligj në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit,

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në se jeni dakord, shkojmë në 5 minuta. A jeni dakord? Kush është “për”? Ju faleminderit! Kush është “kundër”? Mirë.

(Reagim nga salla)

Mirë, u votua për 5 minuta. Vazhdojmë.
Fjalën e ka deputeti Ardiana Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Një prej arsyeve pse e kisha kërkuar fjalën, është edhe ky 5 minutshi, mirëpo po provoj t’i shfrytëzoj vetëm 2. Mendoj se gati nuk mbeti kurrgjë të them më pas fjalimeve të fundit.

Sidoqoftë, po e përsëris diçka që e kam thënë më herët, mendoj se 11 vjet institucione, 12 vjet pas luftës Kosova po sillet prapë në mënyrë goxha absurde. I gjithë Kuvendi i Kosovës, gjithë ditën ka diskutuar sa i keq është EULEX-i. Prapë është kthyer sistemi kur krejt Kuvendi i Kosovës, njerëzit e zgjedhur të Kosovës flasin se sa të këqij janë të

tjerët, pa mbërri kurrë ta shohë veten. Unë e kam një bindje të thellë se ndoshta ka gjasa të jetë pak e gabueshme, që vendet më të fuqishme dhe më stabile në botë janë të tilla se krejt kohën e kanë këqyr veten e nuk i kanë këqyrë të tjerët se i kanë këqyrë punët e veta. Kam pasur shumë të diskutoj, shumë është thënë këtu, mirëpo edhe një herë po i lus kolegët të mendojnë pak kur flasin për sigurinë në veri, ndoshta kishte me qenë mirë njerëz të zgjedhur të Kosovës të fillojnë prej vetvetes, jo individualisht nuk po flas pa fyerje, mirëpo të fillojë Kosova prej vetvetes, ta shoh vetën, ta sheh vetën a i kemi kryer ne punët të cilat na kanë besuar votuesit në lidhje me siguri në veri, t' i shohim njerëzit të cilit ne i kemi zgjedhur si Kuvend, që është Qeveria e Kosovës, a e ka kryer pjesën e vet të punës në veri të Kosovës, e tek aty e tutje të dalim edhe të shohim se çka po bënë EULEX-i. Mendoj se qasja reverse prej kësaj që e thashë unë, të fillojë fillimisht me EULEX-in dhe në mes të kohës të harrojmë krejt që edhe ne kemi obligime, që edhe ne kemi faj, që edhe ne nuk po japim shembull as të sundimit të ligjit, as të përmirësimit të kushteve në arsim, as në shëndetësi, as në siguri, as në liri të lëvizjes, e në asnjë aspekt i cili do t'i kishte dhënë shembull ndërtimit të një shteti solid, një shteti i cili mund ta joshë dike, kushtimisht po them pa cinizëm ndoshta edhe të vijë për të kërkuar azil në Kosovë. Ne po ndërtojmë një vend prej të cilit edhe shqiptarët po lypin të ikën edhe po e akuzojmë EULEX-in qysh nuk po mund ta integrojnë veriun e Kosovës. E di sa kontraverze mund të jenë fjalët, mirëpo qasja ime personale ka qenë e këtillë gati qe 10 vjet në institucione e do të vazhdojë të jetë e tillë. Shtete të fuqishme janë ato të cilat fillimisht e shikojnë vetën, individë të fuqishëm janë ata të cilët fillimisht e përmirësojnë veten para se t'i akuzojnë të tjerët edhe institucione të zonja dhe të fuqishme do të jenë ato të cilat janë fillimisht janë kritike ndaj vetvetes e mandej ndaj të tjerëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, edhe për kohën. Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën, le të përgatitet Aalbulena Haxhiu.

GËZIM KELMENDI- I nderuar kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë të nderuar,

Në fjalën time unë do t'i qasem temës të sigurisë dhe sundimit të ligjit nga një këndvështrim pak më ndryshe edhe jo të zakonshëm për diskursin politik në vend. Jam i bindur se çështjet e sigurisë dhe sundimit të ligjit, duhet shikuar para së gjithash nga aspekti i mundësive për parandalimin e keqpërdorimit të ligjit dhe me këtë shtimin e sigurisë në vend.

Konsideroj se zhvillimet aktuale në shoqërinë tonë nuk na mundësojnë këtë. Vlerat etike dhe morale të shoqërisë sonë janë duke u dëmtuar nga dita në ditë. Fëmijëve dhe rinisë sonë nuk jemi duke iu ofruar shembuj dhe mundësi e që ata të ndërtojnë personalitete të shëndosha, të jenë në gjendje t'i përballojnë epshet dhe ambiciet egoiste të përmbushjes të interesave personale dhe materiale.

Teza kryesore e diskutimit tim është se pa qytetarë të shëndoshë në aspektin moral, ne nuk mundemi të flasim për një shoqëri të sigurt ku do të sundojë ligji. Sot e

dymbëdhjetë vjet nga paslufta, Kosova po përballet me shumë dukuri negative dhe kundërnjerëzore të cilat për ne nuk kanë qenë fort të njohura dhe fare pak prezent. Lufta kaloi, por sot ne ballafaqohemi nga egoja dhe dëshira e të tjerëve për të mbisunduar me ligjin. Trafikimi me qenie njerëzore, krimi i organizuar, prezenca e një numrit të madh të shpive publike dhe bastoreve sportive, rënia e vlerave morale dhe njerëzore, dhuna në familje dhe në shkolla, vëllavrasje dhe vetëvrasja, rrëmbimet, mashtrimet dhe vjedhja, haraçi apo siç thuhet në popull reketi ndaj ndërmarrjeve private, konsumimi me substanca narkotike si dhe të gjitha këto, duke përfshirë edhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe parasë publike, prerja legale e pyjeve, cenimi i integritetit territorial të Kosovës, në veçanti në pjesën veriore dhe perëndimore, që unë në fjalimin e mëhershëm e kam cekur kryesisht në aksin rrugor Pejë – Kullë – Rozhajë dhe Pejë - Çakorr – Andrijevicë. Të gjitha këto dukuri dhe fenomene negative që bie ndesh me vetë qenien njerëzore dhe me sundimin e ligjit, janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë.

Dalëngadalë po zhvishemi nga identiteti jonë, identitetet me të cilin jemi krenuar me shekuj. Jemi popull që kemi promovuar shumëçka, e në fakt jemi vetëm duke importuar kryesisht dukuri negative dhe kudër njerëzore. Është e vërtetë se në shumë sfera janë bërë përparime të dukshme, por ka mjaftë për t'u bërë. Ministri i nderuar i Punëve të Brendshme, doktor Bajram Rexhepi, gjithashtu edhe zëvendëskryeministri, gjegjësisht ministri i Drejtësisë, profesor doktor Hajredin Kuçi, qysh në fillim të mandatit të tyre kanë treguar një vullnet dhe përkushtim të plotë për luftimin e të gjitha këtyre dukurive, megjithatë, sikur institucionet të cilat ata i drejtojnë edhe ne vetë si qytetarë duhet të jemi më vigjilent ndaj këtyre dukurive kundërnjerëzore.

Sot rinia jonë e cila më së shumti është viktimë e këtyre dukurive, para vetes dhe fenomene kundërnjerëzore, është lënë pas dore. Mënyra e jetës dhe vetë situata aktuale nëpër të cilën po kalon kjo rini, në Kosovë nuk është e kënaqshme dhe e ardhmja e tyre nuk garanton një mirëqenie ekonomike dhe sociale.

Unë si deputet i Parlamentit të Kosovës, duke pasur të njëjtin qëllim si ju kolegë deputetë të nderuar dhe qëllimin e njëjtë ashtu si Qeveria e Kosovës, në luftimin e këtyre dukurive negative, mendoj se këto dukuri duhet trajtuar ashtu siç trajton mjekësia nga këndvështrimi i saj pasi që jam edhe mjek me profesion. Do të thotë, duhet t'i trajtojmë si shkaqe dhe të luftojmë si shkaqe dhe mos të merremi vetëm me pasojat e këtyre dukurive negative. Edukimi i mirëfilltët i rinisë sonë në bazë të ngritjes intelektuale, padyshim që ka bazën fundament të fortë. Për këtë duhet t'i marrim shembull edhe vendet e Bashkimit Evropian të cilat ne synojmë të jemi dhe të respektojmë Kushtetutën laike ashtu siç e respektojnë vendet e Bashkimit Evropian. Të rikthejmë edukatën fetare në shkollat tona publike. Kërkojmë nga ministri, përkatësisht Ministria e Arsimit, duke pasur parasysh që këto ditë do të miratohet Ligji për arsim parauniversitar, të fus në kutikulën e shkollave publike lëndën e edukatës fetare, nga se rinia duke u edukuar, duke njohur Zotin si krijues dhe vetveten si krijesë, është më i ngritur në aspektin intelektual dhe fetar. Në anën tjetër, janë shumë më larg akteve negative, kundërnjerëzore dhe duhet mirë t'i mësojmë rininë dhe qytetarët tanë se jeta, nderi dhe pasuria e qytetarëve është e paprekshme dhe si e tillë, duhet trajtuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu, le të përgatitet Anton Çuni.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Drejtësia është elementi thelbësor i shtetit. E drejtë është ajo që është në pajtim me ligjin, e ligji i drejtë është vetëm ai që është në interesin e popullit dhe qytetarit, duke u siguruar që askush të mos jetë i paprekshëm para ligjit.

Qytetarët çdo ditë përballen me terror psikik që ushtron makineria propagandistike e pushtetit vendor dhe ndërkombëtar, me reklama mbi sundimin e ligjit, reklama KËTO që devijojnë nga synimi kryesor që ka sundimi i ligjit, si sistem që përpiqet t'i mbrojë të drejtat e qytetarëve nga përdorimi arbitrar dhe abuziv i pushtetit politik. Nëse sot vërtet kemi vullnet jo vetëm që të diskutojmë, por edhe të veprojmë në funksion të respektimit të rendit kushtetues, rrjedhimisht edhe të sundimit të ligjit, atëherë do të ndaleshim në disa çështje që janë: eliminimi i strukturave paralele, heqja e fuqisë ekzekutive të EULEX-it dhe gjithë mekanizmave të tjerë ndërkombëtar që veprojnë në vend dhe funksionalizimi i plotë i të gjitha institucioneve vendore, luftimi i korrupsionit përmes krijimit të legjislacionit që mundëson hetim efikas, konfiskim të pasurisë dhe burgosjen e të gjithë politikanëve dhe zyrtarëve të korruptuar vendor dhe atyre ndërkombëtar.

Ne kemi pranuar një letër informuese të datës 3.5.2011, nga ministri i Drejtësisë, ku ndër të tjera ai na njofton për themelimin e një këshilli konsultativ për drejtësi. Unë nuk e di se çfarë nevojë ka të formohet ka të formohen kësi këshille me përbërje dhe mision që i përzihet institucioneve të caktuara të drejtësisë, që janë përgjegjëse për çështjet të cilat ky këshill ka si qëllim t'i adresojë kur dihet se sa sukses mund të ketë një këshill i tillë në përbërje të cilit janë përfaqësues të ICO dhe EULEX-it e organizatave tjera ndërkombëtare që nuk e njohin shtetin e Kosovës.

Çfarëdo koordinimi për heshtje të drejtësisë duhet të bëhet nga institucionet e vendit dhe nuk duhet të ketë kurrfarë mbivendosje të strukturave të tilla në këto institucione, sepse kjo e bën pastaj edhe më të qartë thënien që në Kosovë vërtet nuk sundon ligji, por ligji sundohet.

Po ashtu thuhet se Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in, ka sponsorizuar themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë, ku këtë institut përveç që e vë në funksionin e mbledhjes të dhënave dhe analizave, atij gjithashtu ia mbivendos EULEX-in dhe ne mund të marrim me mend se çfarë analizash dhe faktesh do të na sjellë ky Institut.

Zbardhja e krimeve të luftës dhe vënia para drejtësisë të atyre që kanë kryer krime gjatë luftës në Kosovë, nuk mund të bëhet nga ky institut e as nga një sistem i drejtësisë të cilit i është mbivendosur EULEX-i. Loja me shprehjet: funksionalizim; fuqizim; ide e punës; nevojat e punës; punë intensive, vërehet jo vetëm në këtë letër informuese, por

edhe gjatë tërë punës të Qeverisë, ku për një obligim kushtetues që kjo Qeveri ka, e që ka të bëjë me kthimin e gjyqtarëve në veri dhe vënien në funksion të gjykatave, pra me një fjalë me vendosjen e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në atë pjesë të vendit, këta përmendin takimet dhe vetëm takimet, por aty nuk mund të shihet sikur që edhe nuk kemi parë deri më tani as edhe një veprim konkret, pra kjo Qeveri veriu e vendit e ka të përfshirë vetëm në stemën e saj.

Në vazhdimësi ne kemi tërhequr vërejtjen mbi rrezikun që sjellë toleromi i strukturave paralele, bile kjo shpeshherë na ka kushtuar edhe me rrahje, burgosje e anatemim.

Lëvizja “Vetëvendosje”, në vitin 2009, i patë identifikuar 117 udhëheqës të strukturave paralele, emrat e të cilëve ua patë dërguar institucioneve të vendit, të cilat as sot e kësaj dite nuk kanë ndërmarrë as masën më të vogël ndaj tyre. Sundimi i ligjit nuk mund të mbahet i veçuar nga ndikimi i korrupsionit sepse ai gjithashtu mbahet peng i politikanëve dhe i qeveritarëve të korruptuar dhe shatazhuar, të cilët kanë zgjedhur rrugën e e ndërmjetme, atë të qëndrimit mbi ligjin, por nën EULEX-in, rrugë kjo që ju mundëson jetë luksoze përmes pasurimit të paligjshëm në favor të kompromiseve politike ndaj Serbisë në kurriz të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës, dhe ... ishte më lartë se në seancën e djeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Anton Quni, le të përgatitet deputeti Fadil Demaku.

ANTON QUNI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Pasi sot po trajtohet çështja e sigurisë dhe e sundimit të ligjit, ndoshta ka qenë e nevojshme që këtu të jetë prezent trupi më i lartë përgjegjës për siguri, siç është Këshilli i Sigurisë Kombëtare. Këtu po i shohim vetëm zëvendëskryeministrin dhe ministrin dhe kryesisht fajësimet po i drejtohen ministrit të Punëve të Brendshme, po të i shin edhe të tjerët, me siguri që ky fajësim do të përpjesëtohej edhe për ministrin do të ishte më lehtë.

Këshilli i Sigurisë Kombëtare, ka hartuar një strategji të sigurisë e cila ne, në fakt në legjislacionin e kaluar, është miratuar. Do ta cek nenin 1.10 korniza strategjike e Kosovës: do t'i luftojmë kërcënimet ndaj sigurisë nacionale në Burim duke i identifikuar përse ekzistojnë këto kërcënime dhe si mund të zbuten pasojat e tyre? Dy, do të ndërmarrim brenda mundësive tona të gjitha masat e nevojshme për të identifikuar dhe luftuar menjëherë kërcënimet ndaj sigurisë nacionale. Vazhdon, do të përcaktojmë kush dhe çka përbënë kërcënim ndaj interesave nacionale të Kosovës dhe do të përgatisim politikat të cilat reagojnë ndaj këtyre kërcënimeve? Do të bëjmë përpjekje së bashku me partnerët tanë ndërkombëtar që të zhvillojmë kapacitetet tona për masat parandaluese dhe kështu do të minimizojmë rrezikun nga kërcënimet e identifikuar dhe do të sigurohemi që të jenë në dispozicion mjetet dhe resurset e mjaftueshme për t'u përballur me kërcënimet e identifikuar.

Mendoj se shumicën e këtyre veprimeve, Qeveria është duke i kryer me organet e saja kompetente, institucionet, agjencionet e sigurisë e tjera e tjera, siç është identifikimi i

rreziqeve, kërcënimeve, burimeve, strukturave, formave dhe metodave që e rrezikojnë interesin nacional. Po ashtu të gjithë jemi të vetëdijshëm të cilat janë rreziqet potenciale siç janë: agresioni nga jashtë, dhuna ndëretnike, lufta speciale, terrorizmi, lëvizjet radikale, krimet ekonomike, krimi i organizuar, trazirat sociale, epidemitë në masë, fatkeqësitë natyrore e tjera, e tjera. Por, vërehet se shqetësimi më i madh fokusohet në veriun e Mitrovicës. Unë pajtohem që ekzistojnë arsyet e mëdha për këtë çështje.

Derisa nuk ka shtrirje të institucioneve të Republikës së Kosovës në veri, derisa është mungesë e institucionit të drejtësisë, derisa Shërbimi Doganor nuk është funksional, derisa atje ambienti është shumë i rrezikshëm për veprimtarinë e institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë, posaçërisht për institucionet siç janë: Forca e Sigurisë të Kosovës, Agjencioni i Kosovës i Inteligjencës, atëherë unë me të vërtetë kam dyshime dhe vërejtje të mëdha në konkludimin të cilin e paraqiti ministri i Mbrojtjes se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile. Ndoshta ministri është bazuar në raporte që i ka marrë nga domethënë Policia e Kosovës, nëse është bazuar në këto raporte, atëherë mund të konkludoj se me të vërtetë ka qenë i mashtruar, por nëse konkludimet i ka bërë në bazë të perceptimeve të veta duke kaluar nëpër veri të Mitrovicës, atëherë jam më se i bindur që ka përjetuar një mashtrim optik, sepse një ambient i tillë siguron një anarki të plotë, ku rregullat e lojës vendosen nga strukturat paralele serbe, grupet kriminale nacionaliste e tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e atakojnë sovranitetin, integritetin dhe rendin kushtetues të Kosovës. Nëse me këtë konkludim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë!

ANTON QUNI: Atëherë, do t'i kapërcej disa çështje. Nuk është turp të thuhet nëse Qeveria nuk ka kapacitete, nuk ka mundësi, të kërkojë ndihmë për kapërcimin e situatës dhe prapë duke u bazuar në nenin 1.11, ku thuhet: Strategjia e sigurisë është dokument dinamik i cili duhet të rishqyrtohet në perioda të rregullta kohore dhe t'i përshtatet rrethanave të reja dhe ndryshimit të objektivave të sigurisë. Kjo kërkon angazhimin e bashkërenduar të të gjitha institucioneve shtetërore, por edhe përfshirjen e qytetarëve, mediave, botës akademike dhe të shoqërisë civile në përgjithësi. Për këtë arsye, strategjia e sigurisë së Republikës së Kosovës është dokument publik, meqë siguria e Kosovës në fund të fundit varet nga përkushtimi, angazhimi dhe kontributi i të gjithë shtetasve të saj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Fadil Demaku, le të përgatitet Afrim Kasolli.

FADIL DEMAKU: I nderuar, kryetar i Parlamentit,

I nderuari zoti kryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Për rëndësinë e funksionalitetit të Ligjit dhe kontrollit institucional në tërë territorin e vendit, me theks të veçantë veriun e vendit, ne si deputetë ishim pothuaj se unanim në këtë përkushtim dhe qëllim në seancën e mbajtur një ditë më parë.

Ndërsa sot do të fokusojmë këtë diskutim në përmirësimin dhe stabilizimin e situatës politike, ekonomike dhe institucionale në vend, përmes ndërmarrjes së disa hapave emergjentë, legjislativë, administrativë, politikë, siç janë: forcimi i kontrollit doganor, fuqizimi i strukturave të sigurisë, konsolidimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm në mes tyre, reformat e vazhduara në sistemin e drejtësisë dhe ndalja e tentimit që përmes politizimit të bëhet presion mbi organet e sigurisë së vendit.

Në anën tjetër, kërkesat e pafundshme për ligjshmëri dhe zbatim të saj dhe presioni i vazhduar medial kanë bërë që EULEX të vihet në pozitë të vështirë duke mos gjetur zgjidhje. Ata dalin me deklaratatë të paqarta që kontribuojnë që gjërat të bëhen më konfuze nga presioni, në një pjesë të vendit ndërmarrin hapa duke tejkaluar ndoshta edhe limite, e në një pjesë duke mos vepruar fare, krijojnë përshtypjen e një ligjshmërie selektive në vend, siç e potencoi më herët edhe profesor Bajrami.

Është e domosdoshme nevoja e krijimit të një partneriteti të mirëfilltë nga ana e EULEX-it, si misioni i Bashkimit Evropian, dhe institucioneve të vendit tonë.

Duke qenë se pjesëmarrja jonë në këtë diskutim i shërben interesit të qytetarëve për një jetë më të sigurt dhe mirëqenie më të begatshme, e konsideroj prizmin e diskutimit tim nga këndvështrimi i nevojës imediate që institucionet e vendit duhet të ndërmarrin për krijimin e një ambienti më të sigurt, më stabil për tërheqjen e investimeve të huaja dhe të bizneseve kosovare në mënyrë që të përmirësohet dhe rritet mirëqenia e qytetarëve tanë.

Institucionet e vendit duhet dhënë rëndësi primare procesit të ndërtimit të mekanizmave që kanë involvim të drejtpërdrejtë në krijimin e institucioneve të forta dhe demokratike të shtetësisë, fuqizimin e Agjencionit tonë të Inteligjencës, organet e Forcës së Sigurisë Publike, policisë dhe ushtrisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe deri në segmentin e diplomacisë sonë, të konjuktohen në mes veti dhe t'i shërbejnë një misioni të krijimit të shtetit ligjor, funksional, demokratik, me bazë të ekonomisë së lirë, të tregut dhe konkurrencës.

Duke pasur mbështetjen e Parlamentit në nxjerrjen e infrastrukturës ligjore adekuate, Qeveria jonë duhet të ketë një qasje më aktive dhe më dinamike në marrjen e përgjegjësisë të veta, me gjithë progresin e arritur dhe rezultatet e deritanishme që tanimë janë në dukje, e me këtë rast e përshëndes edhe zëvendëskryeministrin, njëkohësisht ministrin e Drejtësisë dhe ministrin e Rendit për gatishmërinë e madhe që këto gjëra të shkojnë përpara. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Afrim Kasolli e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Arben Gashi!

AFRIM KASOLLI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më duhet të reagoj ndaj një deklaratë e tmerrshme të deputetit të LDK-së, Sali Asllanaj, se gjëja të jesh kundër EULEX-it, do të thotë të jesh kundër BE-së. Ne do të thotë, ashtu siç jemi për ulësen e Kosovës në OKB, por jemi kundër misionit të OKB-së

në Kosovë, UNMIK-ut, njësoj jemi për BE-në, por kundër EULEX-it. Pra, nëse je kundër EULEX-it, s'do të thotë që je kundër perëndimit e me lindjen. Pikërisht ky stigmatizim dhe skematizim është në kundërshtim me mendimin kritik që përbën vlerën themelore të Evropës.

Prandaj, ne jemi pikërisht kundër kësaj ndarje të botës në dy entitete absolute ontologjike që nuk kanë interaksion politik, kulturor dhe vleror ndërmjet vete, që si i tillë ky koncept dikur ka përbërë thelbin dogmatik të përshkrimeve orientaliste e i cili tashmë ka kohë që është delegjitimuar si doktrinë akademike nën peshën e teorive kritike. E nëse insistoni në këtë ndarje perëndim – lindje, atëherë ne ju themi që këto institucione tona pikërisht po e dashurojnë perëndimin në mënyrë lindore.

Në anën tjetër, se zyrtarët e kësaj Qeverie e kanë humbur thua se çdo kontakt me realitetin në Kosovë në lidhje me sigurinë, e dëshmon edhe ky koncept i tyre dhe raport i prezantuar sot. Është më se e qartë se vetëdija e tyre politike, duke qenë përfaqësues i qenies së tyre personale politike, demonstroi një koncept të mjeruar mbi gjendjen e sigurisë dhe sundimit të ligjit në mbarë vendin.

Tashmë dihet se siguria dhe ligjshmëria në Kosovë sot është shumë e rrezikuar, madje mund të thuhet se në pjesë të caktuara të Kosovës ajo mungon plotësisht si për shkak të dështimit të strukturave politike, institucionale, administrative, si ndërkombëtare dhe vendore, për shtrirje të plotë në territorin e Kosovës, mjerimit të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik, nivelit të lartë të korrupsionit në majat kulmore institucionale të vendit dhe, në fund, udhëheqjes së vendit nga kjo klikë politike sipas atij parimit të njohur: të gjithë janë të barabartë, por qeveritarët janë pak më të barabartë.

Rrjedhimisht, kjo gjendje rrezikon edhe vetë lirinë si kategori qenësore të politikës, sepse dihet që liria mbrohet vetëm me ligj. Logjikisht, kjo ka bërë që dështimi në implementimin e ligjit në dimensionin universal të tij, nënkupton edhe vetë dështimin e politikës si sferë e organizimit praktik shoqëror sepse, në fund të fundit, qëllimi fundamental i kësaj sfere mbetet pikërisht mbrojtja e lirisë.

Mirëpo, ajo që spikat dëshprimisht keq, është mënyra kur i dëgjon njeriu përfaqësuesit institucional të vendit të cilët vazhdimisht deklarojnë se gjendja e sigurisë në Kosovë na qenka stabile, se nuk paska vrasje si dikur apo se paska rënë dhuna e drejtpërdrejtë fizike dhe se ka kohë që krimi ka rënë me motive etnike. Pra, sipas kësaj qasje të stabilitetit të pa jetë, siguria na qenka vetëm fizike dhe jo politike, ekonomike dhe sociale.

Kështu, kjo frymë tregon mjerimin mendor ku ka rënë kjo Qeveri, duke harruar faktin se siguria si e tillë mbulon edhe sferat e tjera të shoqërisë që nga ajo shëndetësore, fakte këto që kohë më parë i analizoi në mënyrë mjaft të duhur kolegja Bakalli, sociale, pensionale e tjerë, komponente këto që i mungojnë plotësisht për shumicën e shoqërisë. Pra, përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse nuk janë të brengosur edhe për këtë dimension të sigurisë, e që si i tillë është shumë i rëndësishëm për siguri në përgjithësi. Në këtë kontekst vlen të përmendet sidomos vetëm një fakt se shumica e hulumtimeve të opinionit publik, që janë analizuar kohëve të fundit nga UNDP, tregojnë se 80% të

qytetarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë dhe atë kryesisht për shkak të gjendjes së mjerë ekonomike dhe sociale, e ky fakt tregon tashmë se me çfarë pasoja të paparashikueshme ndodhet gjendja e sigurisë edhe nga kjo anë e pa hetuar e cila ndryshe quhet edhe si bombë sociale.

Gjykuar mbi të gjitha këto parametra, mund të konstatohet se në Kosovë sot janë rrënuar premiset funksionuese normative të një shteti ligjor demokratik, e ndërsa në mungesë të këtyre vlerave, vetë shteti tjetërsohet, siç thotë një proverb, dhe katandiset në një bandë kusarësh.

Kështu, në koherencë me premiset ideologjike të operimit politik të kësaj Qeverie të privatizimit të çdo gjëje, kjo Qeveri gradualisht po e ideologjizon edhe sigurinë nëpërmjet privatizimit të saj. Pra, janë vetë premiset ideologjike të këtij rendi, që mund të konsiderohen si burim i krizës.

Përfundimisht, me kësi vizioni, Kosova tashmë përkundër deklarimeve formale të qeveritarëve se mbetet e përkushtuar për procese integruese evropiane, përmbajtësisht po katandiset në të kundërtën e këtyre modeleve, i cili garanton siguri vetëm për oligarkët politikë dhe mjerim për shumicën e shoqërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është mirë nganjëherë disa fjalë të korrigjohen pak! Pasi s'është Arbeni këtu, fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk do të shkoj më shumë se pesë minuta, por ndoshta dalin pak më të gjatë ata pesë minuta!

Sidoqoftë, nuk do të harroj t'ju kërkoj leje të përshëndes këtu zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes. Besoj që ma jepni këtë leje!

Ndërkaq, sa i përket temës, të them të drejtën, unë do të nënvizoj ato çka tha zoti Arsim Bajrami, se sundimi i ligjit është kondicio sine kvanon në një shoqëri stabile. Dhe, kjo do të thotë se të gjitha institucionet duhet të fokusohen mbi këtë pikë. Nuk ka as zhvillim ekonomik, nuk ka as liri e të drejta të njeriut pa sundimin e ligjit.

A po bëjmë sa duhet, se zoti Kuçi do të thoshte se kur kemi qenë koalicion, s'ke bërë shumë zhurmë! Jo, edhe atëherë kam thënë diçka, është e vërtetë. Po, a po bëjmë sa duhet? Më në fund të fundit, me të vërtetë nuk e kam ndërmend të akuzoj këtë mandat të Qeverisë, sepse ky është një proces, pra implementimi i sundimit të ligjit është një proces që nuk varet prej një mandati. Unë madje po shpresoj se do ta inkurajoj si zëvendëskryeministrin, si ministrin këtu që të vazhdojnë. Në këtë rol është fjala ime, jo në një polarizim pozitiv – opozitë.

Do të thotë, në qoftë se pa sundim të ligjit nuk mund të shpresojmë se do të kemi një shtet të suksesshëm, atëherë të gjitha forcat tona, përfshirë edhe Parlamentin, duhet të fokusohen në këtë çështje.

Është e vërtetë se ka pasur disa mistifikime që janë pasojë e UNMIK-ut. Për shembull, kur ne kemi kërkuar që edhe si individë, po besoj dhe ministri Rexhepi e ka thënë madje në mënyrë kategorike që targat të qarkullojnë të shtetit të Kosovës. Edhe vogëlsia ime ka pasur rastin e madh që të takoj një autoritet shumë të lartë të EULEX-it, për të cilin unë nuk kam fjalë apologjie, të merremi vesh. Edhe ai tha: nuk mund t'i zgjidhim çështjet politike me metoda policore. Kështu tha! Dhe, zakonisht, besoj se zoti Rexhepi e ka ndier shumë më shpesh se unë këtë fjalë nga përfaqësuesi i organizatës, për të cilin unë kam konsideratë të jashtëzakonshme dhe kam thënë gjithmonë. Dhe, tash çka po ndodhë? Po ndodh që deri prodhimi industrial, çfarë janë targat e veturave kanë pozicion politik. Unë e pranoj që vozitësi që i grahë veturës, ka një bindje politike që nuk e pranon shtetin e Kosovës. Po edhe pse shenjat e veturës paskan qëndrime politike, me të vërtetë, kjo mua më është dukur absurde dhe kam thënë edhe në atë kohën e idilës, si po them unë, të koalicionit PDK-LDK. Dhe, në këtë aspekt, unë besoj se secili prej nesh, jo tani, por në mandatin e kaluar, nuk di a kemi bërë mjaft për t'iu thënë se këtë kokërr ulliri nuk e hamë, se prodhimi industrial nuk ka bindje politike, mund të ketë njeriu dhe neve nuk na pengojnë edhe ato bindje politike që nuk e pranojnë shtetin e Kosovës, janë qytetarë tanë, natyrisht u duhet një kohë pak më e gjatë për ta pranuar këtë realitet.

Sa i përket veriut, unë asnjëherë nuk i jam referuar kësaj teme, se është temë ndoshta shumë e madhe për vogëlsinë time dhe madje unë jam njëfarë lloj mjeshtri i relativizmit.

Mirëpo, shikoni! Ky është Parlament i Kosovës dhe në këtë aspekt nuk jam krejt i bindur se jam shumë kategorik dhe kam të drejtë kur them se në veri po ndodh invazioni nga një shtet i huaj dhe për shkak të përbërjes multietnike të këtij Parlamenti, unë s'po dua të them a është keq a mirë, s'po dua ta kualifikoj. Deri qatje po shkoj. Mirëpo, ju lutem, në bisedat Serbi – Kosovë a ka pasur mundësi dhe a thua ka mundësi që të kërkohet opinioni – komenti politik i Perëndimit për këtë fakt? Kurrëgjë tjetër.

Zotërinj, ne po ulemi me Serbinë, por ju lutem...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi, le të përgatitet Liburn Aliu.

HASIME KRASNIQI: I nderuar, kryetar i Parlamentit!

Zëvendëskryeministër,

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, gjendja e sigurisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës është një çështje shumë e rëndësishme për të diskutuar në Kuvendin e Kosovës. Arsyet janë të shumta. Për të djeshmen janë dëshmorët e kombit, invalidët dhe veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjithë ata që në njëfarë forme apo tjetër kontribuuan për këtë shtet sovran, të sigurt dhe ligjor. Por sot

janë qytetarët e Republikës së Kosovës që kërkojnë sundimin e ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Jam shumë e interesuar që Kushtetuta dhe ligjet të gjejnë zbatim në tërë territorin e Kosovës, gjë kjo e cila nuk po ndodh. Në këtë drejtim, vlerësoj se ka ngecje posaçërisht në pjesën veriore të vendit, ku përgjegjës për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit në kompetencën e sigurisë është EULEX-i. I njohur si mision për zbatimin e ligjit, EULEX-i po duket se përveç që nuk po ka sukses në veri të Kosovës, po përdorë edhe drejtësi selektive, pasi që në pjesën veriore të vendit e pranon haptazi se veprojnë struktura paralele dhe nuk vepron në eliminimin e tyre, përderisa në pjesën tjetër të vendit arreston ish ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët në luftën e tyre të drejtë u përkrahën edhe nga NATO kundër regjimit vrasës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Si deputete e Parlamentit të Kosovës, jam e shqetësuar për të gjitha ato arrestime që u kryen pikërisht në rajonin e Malishevës, prej nga vij, kurse mund t'ju siguroj se pas arrestimeve, disponimi për EULEX-in është luhatur pasi që qytetarët janë të bindur në luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Arrestohen pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përkundër asaj se gjatë këtyre viteve një pjesë e konsiderueshme e tyre janë arrestuar e burgosur dhe në fund janë liruar si të pafajshëm.

Konkretisht do të theksoj edhe vërejtje tjera në punën e misionit të EULEX-it në Kosovë, i cili mision nuk ka ofruar dëshmi për rezultate para institucioneve të Kosovës dhe qytetarëve të saj në fushat për të cilat është përgjegjës.

Në doganat në veri të Kosovës, para syve të EULEX-it bëhet kontrabanda në dëm të shtetit të Kosovës. Në siguri, nuk ka ofruar siguri për lëvizjen e lirë për të gjithë qytetarët e Kosovës edhe në veri. Në drejtësi, para syve të EULEX-it në veri të Kosovës sillen lirshëm kriminelët që kanë bërë krime në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përkundër vlerësimit që i bëjmë, ne themi publikisht se të gjitha institucionet ndërkombëtare në Kosovë dhe misionet e tyre janë të mirëseardhura, por duke e respektuar pavarësinë e Kosovës, Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe njëherësh të bëjnë zbatimin e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu, le të përgatitet deputetja Muzejene Selmani.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryetar,

Kur po flitet për gjendjen e sigurisë në Kosovë, gjithmonë kjo shikohet nga këndvështrimi i pushtetit, pra: është gjendja e qetë, është stabile, e që i bie më shumë të bie në qëndrimet e kuptimit të menaxhimit të problemeve, sesa në zgjidhjen e problemeve, në fakt.

Që të mund të themi - gjendje stabile, do të thotë se do të duhej të ishim të sigurt se nuk ka arsye për destabilizim, e kjo nënkupton të trajtojmë gjendjen e sigurisë duke u nisur nga qytetari, nga liria e qytetarëve dhe nga siguria e qytetarëve për jetë të lirë. Nuk mjafton thjeshtë të lëshosh një vëzhgim dhe të vlerësosh atë si të qetë, e të brishtë, apo sidoqoftë, si po vulosen këto.

Është e domosdoshme pra të trajtohet problemi thellë dhe kjo nënkupton raportin në mes organizimit shtetëror, në mes parimeve të tij dhe drejtpërdrejt me interesin e qytetarëve.

Zakonisht, fytyra e organizimit shtetëror dhe parimeve të tij, shihet vetëm atëherë kur ndodh intervenimi i tij, pra kur ndodh intervenimi i shtetit. Në gjendje qetësie, edhe pushteti më diktatorial nuk e shpërfaq karakterin e tij në dukje, edhe pse në parimet themelore bazë programore të tij shihet qartë ajo. Pra, kur bëhet fjalë për UNMIK-un, ta zëmë, fytyra e UNMIK-ut u pa qartë nga të gjithë më 10 shkurt të 2007-tës në demonstratën kundër pakos së Ahtisarit, edhe pse fytyra e UNMIK-ut shihej shumë qartë në letra dhe në dokumentet e tij. Njëjtë, edhe me EULEX-in, siç u tha shumë herë këtu.

Edhe sot, në raport me policinë dhe punën e saj të përditshme, qytetarët e Kosovës kudo hasin në mirëkuptim dhe gjejnë përkrahjen e policisë në gjendjen e qetë. Problemi qëndron atëherë kur kemi intervenim. Pra, atëherë kur vihet në funksion, nuk funksionon zinxhiri komandues, pra kur intervenohet nga lartë. Janë intervenimet si ato ndaj tifozëve shqiptarë, apo mos intervenimet në protestat e serbëve në shkurt të vitit 2008 dhe maj 2009, në të cilat policët shqiptarë lëndoheshin dhe nuk kishin urdhër që të intervenonin, e në raste tjera, ata me lehtësi dhe me lehtësinë më të madhe intervenojnë ndaj protestuesve apo qytetarëve shqiptarë.

Këto elemente po e shpërfaqin karakterin e shtetit dhe janë shenja të një padrejtësie, e që janë në bazën e shtetit të Kosovës, e që thjeshtë burojnë nga pakoja e Ahtisarit.

Nëse duam pra të flasim për stabilitetin, nëse duam të ndërtojmë stabilitet, atëherë duhet eliminuar shkaktari, e indikacione kemi. Bazën juridike e kemi shumë të qartë, pasojat po shihen tanimë çdo ditë dhe kjo tregon se stabiliteti i brishtë pikërisht e ka rrënjën te kjo pako.

Prandaj, është e domosdoshme që kur flasim për stabilitetin dhe zgjidhjen e saj, pikënisje çdo herë ta kemi lirinë dhe të drejtën e qytetarit e që këtu, në rastin tonë, shkelet drejtpërdrejt nga Kushtetuta, nga pakoja. Dhe kjo do të thotë që kjo shkelje e lirisë së qytetarit mund të prodhojë në të ardhmen probleme tjera dhe është shumë e natyrshme dhe shumë legjitime që të ketë destabilizim në të ardhmen, kur në fakt padrejtësia ndodh në vetë shtetin.

Te pika 3 e rekomandimeve, nga propozimi për debat, kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare që në mënyrë urgjente të ndërmarrin hapa konkretë në shpërndarjen e strukturave të aparatit shtetëror të Serbisë në Kosovë.

Në lidhje me këta hapa, Lëvizja “Vetëvendosje” para dy vitesh ka deponuar nëpër prokurori anë e kënd Kosovës padi dhe kallëzime penale për strukturat paralele, me emra e mbiemra dhe me fakte përcjellëse.

Secili deputet i Kuvendit të Kosovës, madje para dy vitesh e kishte një formë të plotësuar të gatshme të kallëzimit penal, me dëshmi përcjellëse, vetëm që duhej nënshkruar dhe ta deponohej në prokurori. Një nga deputetët e deponoi një kallëzim. Sidoqoftë, kallëzime penale, të deponuara nëpër prokurori kundër strukturave paralele, kundër personave të strukturave paralele, ka mjaft. Ato janë deponuar dy vite më parë nga qytetarët, nga aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe ato janë atje. Pra, dera është e hapur dhe mund të ndërmerren hapa kurdoherë...

(Ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe të gjithë deputetët!

Pikësëpari do të kërkoj një transparencë nga ju që në rast se lajmërohem si deputete në fillim të marr fjalën, atëherë të respektohet vullneti im. Faleminderit!

Duke marrë parasysh diskutimet të cilat ndodhën sot në këtë Kuvend për çështjen e zbatimit të ligjit dhe sigurisë në territorin e Kosovës, të gjithë jemi në dijeni se pushtetet në Kosovë janë të ndara në bazë të aktit më të lartë të Kushtetutës së Kosovës, e cila u pa se edhe nga miratimi në këtë Kuvend ka pasur defekte dhe tash pritet të përmirësohet, kur dihet se të gjithë duhet ta kemi në dijeni të qartë se duhet të kemi një gjyqësor të pavarur, zbatim efektiv të ligjit dhe funksionim transparent demokratik të të gjitha institucioneve.

Në shumë raporte të ndryshme ndërkombëtare është krijuar një bindje dhe një përshtypje se në Kosovë duhet të krijohet një gjyqësor i pavarur. Nuk duhet të krijohet përshtypja nga raportet ndërkombëtare, por duhet të krijohet përshtypja nga vetë ekzekutivi, i cili është i obliguar që të kërkojë një gjyqësor të pavarur në bazë të ligjeve të cilat miratohen në këtë Kuvend. Jemi në dijeni të gjithë se kemi një numër marramendës të lëndëve të pazgjidhura për shkak të mungesës së sigurisë dhe zbatimit të ligjit në veri të vendit.

Për të arritur një besim te qytetarët e Kosovës, si pasojë e moszbatimit të ligjit në institucionet më të larta të shtetit, atëherë Kuvendi i Kosovës duhet të kontrollojë dhe synojë që të japë kontributin e vet në zhvillim të politikave të përshtatshme dhe të veprimeve konkrete në zbatim të ligjit për gjithë qytetarët e Kosovës në territorin e Kosovës. Kuvendi duhet të synojë, që të nxisë Qeverinë, nëpërmes raporteve apo monitorimit të ligjeve që edhe me miqtë ndërkombëtarë të ndryshojë qasjen e tyre dhe të ndërmarrin veprime që të ndryshojnë gjendjen e tanishme dhe të çojnë vendin drejt vendosjes së rendit dhe ligjit në çdo cep të Kosovës.

Duhet t'i ceku disa rekomandime. Duke pasur parasysh se në Kosovë sfidë dhe çështje më primare është zbatimi i ligjit, atëherë nga ky Kuvend duhet të nxirret një rekomandim që i gjithë ekzekutivi dhe Kuvendi, si monitorues i ligjeve, të përcjellë çështjen e zbatimit të ligjeve në gjithë territorin e Kosovës, të bëhet çështje shumë efektive çështja e komandës së policisë, shthurja e strukturave ilegale paralele në Kosovë dhe njëkohësisht të bëhet funksionimi i doganave, vjelja e taksave, arsimit dhe sektorët e tjerë të cilët janë pengesë për zhvillimin e ligjit dhe kushtetutshmërisë në tërë territorin e Kosovës. Kjo jep për të treguar se ekzekutivi duhet të zbatojë ligjet, të luftojë krimin ekonomik, korrupsionin dhe njëkohësisht të funksionojë i gjithë ligji dhe Kushtetuta në territorin e Kosovës. Kjo jep për të treguar se atëherë edhe aktorët ndërkombëtarë do të largohen prej Kosovës kur ne jemi të vetëdijshëm që të ndërtojmë shtetin tonë në bazë të ligjeve të cilat i kemi miratuar në këtë Kuvend të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues dhe nënkryetar i Parlamentit!

Unë do ta marr nga një kënd tjetër problemin e sigurisë, meqë deputeti, kolegu ynë Nait Hasani e ka paraqitur në thelb rolin e organizatave ndërkombëtare që merren me siguri, por realisht nga këndi ynë, siguria, si problem që lidhet me jetën tonë, me jetën e qytetarëve, është serioze sepse në shumicën e rasteve ne shohim problemin vetëm në një pjesë të territorit të Republikës, ndërsa agresioni apo agresiviteti është më i madh në veri, ndërsa ekzistimi dhe funksionimi i strukturave të huaja dhe paralele që quhen, në Kosovë është në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe në të gjitha komunat, apo regjionet fqinj jashtë kufirit të Kosovës, duke ushtruar mbi baza të rregullta detyrat e tyre kushtetuese, thuhet shpeshherë, në ushtrimin e përgjegjësisë.

Atëherë, Kosova e ka një fat të veçantë, sikur që është rasti i veçantë, presidentin e Republikës e ka gjenerale të policisë dhe ish shefen e policisë e ka tash deputet, brenda këtu dhe jo shpesh thuhet që policia është tregimi më i suksesshëm në Kosovën e lirë. Këto janë organe që merren me siguri dhe autoritet që merren me siguri në Kosovë. Është presidenti i Republikës, Këshilli për Siguri Kombëtare, është organi më i lartë; kryeministri i Republikës, zëvendëskryeministri i cili e koordinon trupën për sundim të ligjit dhe siguri; ministri i Punëve të Brendshme, Forca e Sigurisë së Kosovës, AIK-u, KFOR-i, EULEX-i, Departamenti për Situata Emergjente, zyrat e komunave, drejtoritë komunale që merren me menaxhimin e situatave, ajo që quhet siguri publike dhe situatave emergjente dhe shumë mekanizma tjerë që, nëse i bëjmë bashkë, shihet që ka paralelizma dhe nuk ka koordinim. Nëse i sheh kah rrjedhin problemet, del se ndikimet janë jashtëzakonisht të mëdha dhe moskoordinimi, në njërën anë, i këtyre organeve në një autoritet të vetëm në Kosovë, qoftë nga kryetari i Këshillit për Siguri Kombëtare apo delegimi i kësaj të drejte në ushtrimin e detyrave nga një zyre, në mënyrë që të koordinohen dhe të punohet në vendosjen e kushteve më të mira të sigurisë.

Në anën tjetër, mos arritja që të shpërbëhen strukturat paralele në Kosovë vazhdon të mbetet kërcënim i serioz, sepse këtu ka kompromis politik, jo vetëm tash. Ministri i Punëve të Brendshme është ish kryeministër i Kosovës, ka menaxhuar situatën e asaj që i

thuhet jo stabilitet dhe dhunë në vitin 2004 në Kosovë dhe profili i tij politik garanton që resori mbulohet me autoritet profesional dhe me angazhim konkret në këtë drejtim, por ajo që po dua të them është që edhe më tutje vazhdon të mbetet sfida kryesore mosarritja që nëse nuk arrihet të shpërbëhen praktikisht, ngulfatja e këtyre mekanizmave është problemi kryesor. Nuk besoj që prokuroria e Kosovës i zgjedh problemet e strukturave paralele, sepse ne kemi arrestuar edhe agjentë të shërbimeve të shteteve mike, çfarë ka qenë me BND dhe të shteteve armike, çfarë ka qenë me BIA të Serbisë dhe veprimi në situata të caktuara, apo sipas informatave operative të caktuara e ka bërë shtetin tregues që di dhe mundet të aktivizojë mekanizmin, por kur flasim për mekanizmat tjerë që në Kosovë janë ilegalë, atëherë vërtet duhet të gjendet një mekanizëm i cili koordinon të gjitha këto trupa, të gjitha këto zyre të mëdha e të vogla dhe duhet që veprimi në kushte të sigurisë të jetë krejt në rrethana tjera.

Situata mbetet e brishtë. Natyrisht, unë pajtohem që është shumë e brishtë, por me kërcënim serioz që stabiliteti dhe siguria çon në kërcënim territorial sepse kërkesa e vazhdueshme e Serbisë është territori i Kosovës, dhe jo njerëzit e Kosovës. Ata nuk po donë të flasin për njerëz dhe për të drejta të njerëzve në Kosovë, por për territore të Kosovës dhe kërcënimi serioz është territori i Kosovës, përderisa në anën tjetër ne i injorojmë të drejtat e njerëzve tanë dhe territoret tona në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Si Parlament i Kosovës jemi të obliguar t'i japim mbështetjen Qeverisë së Kosovës për vendosjen e ligjshmërisë dhe sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, gjë që e bëmë dje.

Prej përfundimit të luftës ajo pjesë është shndërruar në oazë të strehimit për të gjithë kriminelët nga ish Jugosllavia, me mbështetje nga Qeveria e Serbisë. Është për shqetësim bashkëpunimi i ngushtë i Qeverisë së Serbisë me bandat e krimit të organizuar në veri, bashkëpunim i cili është duke ndodhur para syve të instrumenteve më të larta të sigurisë ndërkombëtare. Bandat kriminale në veri kërcënojnë dhe vrasin jo vetëm shqiptarët, por edhe banorët tjerë jo serbë të cilët dëshirojnë të punojnë dhe jetojnë ndershëm në Kosovën e pavarur, siç është rasti i vrasjes së boshnjakut Shefko Sallković, e shumë raste të tjera kriminale.

Tani duhet mbështetur Qeverinë e Kosovës në vazhdimin e projekteve për integrimin e pjesës veriore. Nuk duhet harruar, deputetë të nderuar, se deri në vitin 2008 kemi pasur largim – shpërngulje të shqiptarëve nga veriu në jug dhe vetëm pasi që Partia Demokratike dhe Hashim Thaçi erdhën në pushtet, kemi angazhim serioz për kthim të banorëve nga jugu në veri.

Për herë të parë në vitin 2008 dora e Qeverisë prek atë cep të Kosovës. Në vitin 2008, fillojnë investimet në infrastrukturë në pjesën veriore dhe fillon rindërtimi i shtëpive në

pjesën veriore, ku u mundësohet kthimi shumë familjeve atje. Janë ndërtuar deri më tani 45 shtëpi dhe janë në proces ndërtimi edhe 85 shtëpi të tjera. Për herë të parë, Qeveria e Kosovës, bashkë me komunën e Mitrovicës, e udhëhequr gjithashtu nga Partia Demokratike, iu del në ndihmë duke ua paguar qiranë më shumë se 300 familjeve shqiptare të zhvendosura nga veriu në jug, atyre që nga viti 1999 janë qiraxhinj në qytetin e tyre.

Kur jemi te integrimi i pjesës veriore, ju rikujtoj se Lagja e Doktorëve, Kroi i Vitakut dhe shumë të tjera deri në vitin 2008 ishin gërmadha, shtëpitë e djegura, ndërsa sot aty jetojnë në dy lagje 26 familje të kthyera dhe jetë aty, punojnë dhe jetojnë në tokën e tyre.

Në proces të kthimit, Policia e Kosovës, njësitë speciale ndërkombëtare – KFOR-i mbështetën kthimin e të gjithë banorëve në shtëpitë e tyre, për çka duhet falënderuar dhe inkurajuar që të vazhdohet në atë drejtim për t'ju mundësuar të gjithë banorëve të asaj pjese lëvizja e lirë – e drejtë universale.

Të nderuar deputetë,

Duke ju rikujtuar se me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës kemi pasur një rebelim të strukturave kriminale në veri, me ç'rast dogjën gjykatën dhe pikat doganore dhe kishte përpjekje të grupeve ekstreme, të mbështetura nga Serbia, për të përzënë të gjithë shqiptarët nga ajo pjesë dhe vendosjen e kufirit të ri te Kërshi i Dudës, te Ura e Ibrit dhe te udhëkryqi në Zubin-Potok. Por, falë angazhimit të forcave të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare dhe vendosmërisë së shqiptarëve për të qëndruar në atë pjesë dhe mbështetjes së komunës së Mitrovicës, të udhëhequr nga Partia Demokratike, në atë kohë kryetari i komunës dhe tani ministri i tanishëm i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi, me një bashkëpunim të shkëlqyeshëm në Këshillin komunal të sigurisë në mes komunës së Mitrovicës, Policisë së Kosovës, Policisë ndërkombëtare dhe KFOR-it, plani i qeverisë së Serbisë për të vendosur kufijtë të ri dhe përndjekje të shqiptarëve nga ajo pjesë dështoi.

Gjithsesi, mirënjohja më e madhe iu takon banorëve shqiptarë të pjesës veriore, të cilët qe 12 vite po qëndrojnë atje përball presioneve të vazhdueshme dhe shfrytëzoj rasti të falënderoj të gjithë ata që qëndrojnë në veriun e Kosovës, ata të cilët nuk e shitën pronën në atë pjesë përkundër shumave të majme të ofruara nga Qeveria e Serbisë dhe presioneve që ajo bëri mbi ta. Ata u treguan patriotë të vërtetë, ata me sakrificën e tyre, duke rrezikuar edhe familjen e tyre, mbrojtën vatrat e tyre dhe Kosovën me vepra, jo me retorikë boshe, për çka i përgëzoj dhe falënderoj. Ata janë patriotë!

Vendosmëria e banorëve shqiptarë për të qëndruar në shtëpitë e tyre, në shtetin e tyre, është e drejtë legjitime dhe universale, e shenjtë, ashtu siç ishte e shenjtë edhe lufta e popullit shqiptar për liri dhe asnjë përpjekje e Dick Martit, e David Filipsit dhe atyre që ndihmuan në përpilimin e atyre raporteve, nuk mund ta njollosin përpjekjen shekullore të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.

Ne duhet, si Parlament i Kosovës, t'i japim mbështetje të fuqishme instancave të sigurisë për të arrestuar kriminelët të cilët janë në oazat e krimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi dëgjuar shumë fjalë këtu dhe ka ende që të flitet. Unë do të përpiqem krejt shkurt 3-4 skica t'i them, sepse koha u shkurtua dhe unë e thashë që ata që vijnë më vonë, nuk e kanë kohën që t'i zhvillojnë të gjitha idetë.

Një poet i madh Erich Fried, gjerman, është austriak, thotë, një vjershë të shkurtër, i ka të shkurtra me tema edhe sociale edhe psikologjike, që janë shumë të kapshme: Kush sundon këtu? Populli, - përgjigja. Thotë, unë e di që populli sundon, po kush përnjëmend sundon këtu?

Edhe ne këtu po flasim, meqë po themi lex është ligji, ku nuk sundon lex-i sundon EULEX-i dhe kjo është normale.

Edhe më normale a normale është kur reagojmë me një kundërshti, ta quajmë ne, kapitale ndaj, të themi, EULEX-it, edhe dalim dhe bëjmë demonstrata me parullën e famshme, dhe për mua shumë të çuditshme: "liri për çlirimtarët"! Se ai që është çlirimtar, lirinë e ka! Domethënë, absurdi është i madh, edhe kundërshtia është e jashtëzakonshme.

Në anën tjetër, flasim për ligjin dhe menjëherë themi - veriu i vendit. Nëse përdorim terma gjeografike, Kosova i ka katër anë të horizontit, ka veri, jug, lindje e perëndim dhe për pasojë, meqë është një vend, ka edhe mes. Pra, sundimi i ligjit nënkupton sundimin e ligjit në gjithë Kosovën. Nëse themi - veriu, atëherë më nuk është term gjeografik dhe është politik. Dhe, unë e di, nuk e thonë pushtetarët as dje as sot, as deputetët kur dalin dhe ulën këtu, nuk e thonë, po e thonë nga ana tjetër. Po, veriu është problem politik. Nuk është veç i sundimit të ligjit. Dhe kjo është e vërteta e Kosovës.

Ne normalisht që kërkojmë të sundojë ligji, sepse një shoqëri demokratike, përgjithësisht njerëzore, funksionon mirë mirë veç kur sundon ligji. Ligji nuk sundon deri në një idealitet, por përpiqet t'i afrohet asaj që është kontratë shoqërore, asaj që është marrëveshje, asaj që është disiplinim i jetës së përbashkët. Sepse, këtu ka juristë të vjetër e të dijsëm, e dinë çka ligjet kanë lind kur fjala morale s'ka bërë punë. Ligji është detyrim! Meqë është detyrim për një shoqëri, e do instrumentimin e detyrimit. Instrumentimi i detyrimit është edhe dhunë, në kufirin sa ajo është e domosdoshme që të zbatohet ligji.

Pra, kur themi - sundimi i ligjit, nuk kemi të drejtë që të bëjmë demonstrata pse ndiqet një njeri. Nuk kemi të drejtë fajin individual ta bëjmë kolektiv sepse aty ku iu thuhet – të gjithë janë hajna, mbrohen më së miri hajnat. Në shoqërinë ku - të gjithë, ju thuhet një emër i përgjithshëm, ata të vërtetit lulëzojnë. Këta të tjerët, të shkretit, rrafshohen.

Ligji është për të specifikuar raste individuale, se për ashtu, një filozof i madh Lui Artiseri, në 1981-shin brenda Universitetit të Sorbonës, aty edhe punonte dhe jetonte, e

pati vrrarë gruan e vet. Sipas këtij ligji, Lui Artiserin s'është dashur ta çojnë në gjyq. Mirë, e ka vrrarë një grua, por Lui Artiseri ka qenë filozofi më i madh i kohës në Sorbonë.

Çfarë dua të them? Ligji sundon, por barazia para ligji është barazi, sepse para ligjit, po ta përdorim tash figurën e fillimit, po e mbylli, është veç ai që e sundon ligjin. a? Pra, kush vërtet sundon? Populli! More, unë po ves - kush sundon përnjëmend? Se populli, normalisht që sundon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të kabinetit,
Deputetë,

Meqë këtu u fol shumë për sigurinë, e ideja sipas të gjitha gjasave e deputetëve që kanë kërkuar, kanë qenë të kufizuar në sundimin e ligjit, por meqenëse gati të gjithë pa përjashtim trajtuan çështje të ndryshme, mendoj që mund të them diçka që nuk është tepër në këtë debat.

E para, shikuar dhe krahasuar me fillimin kur kemi filluar për t'i ndërtuar bërthamat e para të shtetit tonë, siguria në vend ka bërë, ka progres. Ka disa parametra, indikatorë të cilët e matin këtë proces dhe kjo është thënë edhe prej institucioneve të ndryshme relevante ndërkombëtare, të besueshme, por edhe është vlerësuar nga qytetarët, pa dallim etnik. Për shembull, nuk flitet më për lirinë e lëvizjes, nuk flitet më për krime ndëretnike e po ashtu kemi një avancim në menaxhimin e integruar të kufirit sipas standardeve të BE-së dhe ndoshta indikator i kryesor do të mund të merrej vetë procesi i reduktimit të trupave të NATO-s, që sipas vlerësimit të tyre është konsideruar si një prej indikatorëve – është se kemi një siguri, një nivel të sigurisë më të lartë në Kosovë.

Por, megjithatë, sundimi i ligjit është çështje që e preokupon ende vendin tonë, është një nga sfidat që theksohen në Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe mendoj që është rendi të trajtohet nga të gjitha institucionet e vendit tonë, shoqëria civile, të gjithë qytetarët, pa dallim.

Por kur flitet për sundimin e ligjit, nuk është mirë t'i biem në qafë për të gjitha misionit të EULEX-it. Ju e dini, ky mision ka qenë, ka mbërri ose ka ardhur këtu me pajtim edhe të vendorëve dhe para se gjithash pas një vlerësimi jo të mirë të një mekanizmi tjetër ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, që pati degjeneruar nga fundi i mandatit të tij.

Dhe, po ashtu, nuk duhet të harrojmë që mandati i EULEX-it është kryesisht i kufizuar në monitorimin dhe në këshillimin e institucioneve vendore. Dhe, ky mandat shpeshherë përsëritet edhe nga vetë misioni i EULEX-it në pyetjet që i bëhen edhe në rastet që janë delikate të çështjeve të sundimit të ligjit.

Këtu pati edhe kritika dhe nëse lëshohemi në raste të veçanta, mendoj se mund të gjejmë raste të mira, të punës së mirë dhe raste të ndryshme të dështimit. Unë mendoj që nuk jemi këtu..., në raste të tilla ata vetë duhet të japin përgjigjen. Sot e kemi një reagim të

Komisionit Evropian, si një institucion i rëndësishëm i BE-së, i cili e monitoron po ashtu procesin e avancimit në Kosovë, e mbështet misionin e EULEX-it dhe po ashtu jam i sigurt që edhe qytetarët e institucionet tjera të BE-së dhe taksapaguesit e BE-së e mbështesin punën e tyre këtu.

Po, ajo çka ne na duhet, është të vazhdojmë me një bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in, të shfrytëzohen ata për mandatin që e kanë këtu, për mandatin për të cilin jemi pajtuar dhe t'i shfrytëzojmë kapacitetet e tyre në ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit në Kosovë, me luftimin e krimit, të korrupsionit e tjerë.

Kryesisht çështje të ndjeshme të sigurisë lidhen me sundimin e ligjit në gjithë territorin e Kosovës dhe ne duhet të mbetemi me shpresë që misioni i EULEX-it do të punojë më tepër në veri, aty ku kemi një shkallë më të lartë të krimit dhe aty ku konsiderohet ende që ka struktura që janë paralele dhe nuk janë të dirigjuara nga Prishtina.

Sot, për më tepër, kemi pasur edhe shifra të vetë EULEX-it që thonë, ku japin se në proporcion me regjionet tjera, në regjionin e Mitrovicës ka më shumë lëndë të cilat janë proceduar të luftimit të krimit në vitin e fundit, që do të thotë se ka një ngritje në bashkëpunim të institucioneve vendore dhe EULEX-it në luftimin e krimit atje, po kjo nuk është aspak e mjaftueshme në raport me kërkesat e qytetarëve dhe në vendosjen e plotë të sundimit të ligjit atje.

Misioni i EULEX-it duhet të fokusohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet tona në mbështetje të luftimit të krimit, në procesin e liberalizmit të vizave, që janë disa kritere të sundimit të ligjit që duhet të realizohen, duhet të na ndihmojë dhe të na mbështesë e të vazhdojë të na mbështesë në avancimin e doganave, të emergjencave, që është një segment tjetër ku ne nuk kemi kapacitete e tjera, po janë disa fusha në të cilat ne kemi nevojë për mbështetje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Zëvendëskryeministër,
Ministër i Punëve të Brendshme,
Të nderuar kolegë deputetë,
Siguria dhe sundimi i ligjit janë peshore e demokracisë për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe sa më shumë që ka progres në këto dy fusha, aq më tepër pushteti kthehet në funksion të shërbimit ndaj qytetarit.

Infrastruktura ligjore dhe Kushtetuta e Kosovës promovojnë sundimin e ligjit, por nuk ka progres të mjaftueshëm, as vullnet politik të mjaftueshëm, që inkurajon që sundimi i ligjit të përparojë. Ka më shumë përkushtim në propagandë, sesa përkushtim faktik.

Raportet monitoruese të organizmave ndërkombëtarë e vendorë në vazhdimësi kanë shprehur shqetësime për progres jo të mjaftueshëm në këto dy fusha, edhe përkundër faktit që janë përcaktuar prioritetet në investime financiare dhe ligjore nga institucionet tona.

Gjendja e sigurisë nuk mund të trajtohet si tërësi. Kur flasim për gjendjen e sigurisë në vend, përkatësisht sundimin e ligjit, imponohet trajtimi i kësaj teme në aspektin e shtrirjes territoriale. Veriu i Mitrovicës meriton të trajtohet në formë të ndarë nga zhvillimet e gjithmbarshme të sundimit të ligjit në Kosovë, pikërisht për shkak të realitetit faktit, sepse atje jo që kemi të bëjmë me moszbatim të ligjit, por kemi të bëjmë me mosnjohjen fare të legjislacionit të Republikës së Kosovës, sepse për të gjithë është e njohur situata në veri të vendit: mos funksionimi i sistemit juridik shtetëror; zhvillimi i kontrabandës së përmasave të mëdha përmes kësaj hapësire; veprimi i strukturave ilegale dhe grupeve tjera që veprojnë lirshëm. Grupet kriminale shqiptaro-serbe bashkëpunojnë në mënyrë perfekte dhe jo rrallë herë pa mbështetje politike, të cilat nuk kanë territor të ndarë, nuk kanë protokoll, nuk kanë kufij, nuk kanë burokraci në kryerjen e akteve kriminale për të nxjerrë përfitimet e tyre. Këto dhe vetë gjendja faktike në atë pjesë të vendit Qeverinë e Kosovës e mbajnë përgjegjëse për dështimin në rendit në vend dhe të ligjit në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, duke qenë kompetente dhe përgjegjëse për shtrirjen e pushtetit në gjithë kufijtë e saj territorial. Por, përderisa institucionet ndërkombëtare kanë prezencë, kompetencë dhe ndikim në veri të Kosovës, sigurisht se bashkëpërgjegjës të gjendjes aktuale janë edhe KFOR-i, EULEX-i dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë. Këtu nuk mund të amnistohet as misioni EULEX, sepse deri tani nuk ka treguar performancë dhe rezultat konkret. Më shumë këto institucione janë duke u marrë me promovimin e drejtësisë, sesa me zbatueshmërinë e ligjit, përkundër disa veprimeve shumë të natyrës mediale, andaj pa dyshim zhgënjimi edhe në misionin EULEX do të jetë goditja për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ky perceptim po formësohet.

Unë personalisht aspak nuk shpresoj se kjo Qeveri do të avancojë në sferën e sundimit të ligjit për faktin se, në një Qeveri të tillë ku dominojnë individë që besojnë se janë mbi ligjin, nuk mund të priten suksese.

Qeveria e Kosovës ka nxjerrë disa strategji të ndryshme, kjo shihet edhe në Raportin e Ministrisë, por gjendja nuk ndryshon vetëm me nxjerrjen e strategjive, por me ndryshimin e gjendjes faktike. Shumë prej këtyre strategjive, krijohet përshtypja, janë nxjerrë sa për të përmbushur një detyrë, por jo për të ndryshuar gjendjen e sferës përkatëse për të cilën është hartuar strategjia përkatëse. Në mesin e tyre, vitin e kaluar kemi nxjerrë strategjinë për veriu të Kosovës dhe, siç duket, kjo strategji është në prag të dështimit përkundër shpenzimeve të mëdha buxhetore.

Ende nuk e kemi Ligjin për mbrojtje e dëshmitarëve, Ligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, nuk po gjen zbatim Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të turizmit dhe nuk po fuqizohet ndoshta edhe në aspektin e menaxhimit të aseteve të konfiskuara të pasurive të fituara në mënyrë kriminale. Kuvendi duhet të kërkojë nga Qeveria që sa më parë të përgatit projektligjet dhe t'i procedojë për shqyrtim dhe aprovim.

Në Kosovë nuk mund të flitet se gjyqësori është i pavarur, i paanshëm dhe transparent. Siguria për personelin e gjyqësorit ende mungon dhe gjykatat janë ende të brishta ndaj ndërhyrjeve politike. Kërcënimet, shtrëngimet dhe kanosjet mund të ndryshojnë jo vetëm rezultatet e një gjykimi, por edhe të ndalojnë zbatimin e drejtë të drejtësisë. Ky fakt, fatkeqësisht, nuk është vetëm perceptim. Hetimet zgjasin në vite, në shumë raste rezultojnë pa sukses, madje tentohet të mbyllen hetimet edhe për veprat më të rënda, siç është edhe rasti i vjedhjes në Stacionin Policor.

Jo rrallëherë mundohet nga individë të caktuar që në mënyra të ndryshme të futen në një thes mbrojtja e rasteve të quajtura specifike, e cila nuk është vetëm verbale, por edhe institucionale. Mbrojtjet e tilla kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten skandaloze dhe janë evidencuar edhe nga qendrat e vendosjes ndërkombëtare, madje mediat më prestigjioze të botës vazhdojnë të shkruajnë se krimi ka miratimin edhe të udhëheqjes shtetërore. Kjo është e tmerrshme për një vend si Kosova, si shtet i ri, e cila duhet të bëjë shumë për të krijuar imazhin e mirë të bërjes së shtetit ligjor e demokratik.

Të nderuar kolegë deputetë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Ky Kuvend, më në fund, duhet të ushtrojë mbikëqyrjen dhe të kërkojë përgjegjësi për punët e kryera nga organet përkatëse në përputhje me mandatin kushtetues që ka dhe njëkohësisht të pengojë përpjekjet që për çështje të caktuara të marrë vetë rolin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ramë Vataj e ka fjalën!

RAMË VATAJ: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të dashur e të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë pajtohem me shumicën e diskutimeve që u thanë deri më tash nga parafolësit e mi, kështu që të mos i përsëris të njëjtat gjëra, unë do t'i theksoj disa veç nga një këndvështrim i imi.

Unë përgëzoj dhe uroj punën që po e bën ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Drejtësisë me këto angazhimet që i kanë marrë, për shembull, koordinimi i sistemit të drejtësisë, bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare në fushën e gjyqësisë, ndërtimi i infrastrukturës ligjore e kështu me radhë dhe besoj në raportin që e ka dhënë ministri i Punëve të Brendshme që viteve të fundit ka shënuar progres të dukshëm në aspektin e sigurisë dhe të sundimit të ligjit.

Ne jemi një shtet që kemi dalë nga një regjim diskriminues serb dhe nga një luftë që ka qenë me shumë pasoja dhe duhet ta marrim në konsiderim se në popullatën tonë është ngulitur se gjithmonë uniforma e policit ka qenë në kontekst negativ dhe unë mendoj që në përmirësimin e sigurisë apo në kontributin e zbulimit të rasteve, qoftë të krimeve të ndryshme, ndikon edhe popullata, pra bashkëpunimi i njerëzve, i çdo anëtar të shoqërisë me organet e gjyqësisë dhe organet e rendit. Pra, nuk është siguria, rendi dhe drejtësia vetëm në duart e ministrave tanë që i kemi këtu dhe vazhdimisht i kemi si shenjë qitjeje se këta janë përgjegjës për mosmbarëvajtjen apo mbarëvajtjen e sigurisë. Pra, të gjithë duhet të koordinojmë veprimet qoftë si parti politike, qoftë si institucione, qoftë si organe që të bashkëpunojmë me këto dy institucione që janë më kompetentët për sigurinë dhe rendin në hapësirën e Republikës së Kosovës.

Do të kisha dal edhe në çështjen e EULEX-it. EULEX-i është, si të themi, jashtë kompetencave të ingerencave tona, sepse janë institucion që punojnë me udhëzimet e Komisionit Evropian, janë të shteteve evropiane dhe këta janë ardhur si ndihmë e organeve të drejtësisë dhe të rendit. Mirëpo, nuk mund të pajtohem me disa veprime që i ka ndërmarrë EULEX-i, sidomos në arrestimet, mënyrën e arrestimeve në formë shumë spektakulare dhe sjelljet ndaj, për shembull, arrestimeve të fundit ndaj luftëtarëve të lirisë.

Unë i kam përshtypjet e njerëzve, pastaj ne e dimë se i kemi pasur disa protesta në përkrahje të bashkëluftëtarëve të vetë, dhe secili luftëtar e ka ndie veten ngushë sepse mënyra si janë bërë ato arrestime, ata bashkëluftëtarë kanë pritur që të nesërmen të jenë edhe ata viktimë e një arrestimi të tillë.

Prandaj, krijimi i një gjendjeje të tillë të psikozës se çdokush mund të jetë i arrestuar se ka qenë në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, neve na e ngarkon situatën e sigurisë.

Prandaj, unë do të kisha kërkuar që ne t'i koordinojmë institucionet tona. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit, të gjitha institucionet që më tepër kanë të bëjnë me sigurinë dhe rendin t'i koordinojnë veprimet me EULEX-in dhe në njëfarë mënyre t'i koordinojnë veprimet dhe të shtrijnë pushtetin në veri të Mitrovicës dhe në komunat që janë në veri të Kosovës sepse unë mendoj që kompetencë dhe detyrë e EULEX-it është që të shtrijnë edhe ligjin dhe rendin e shtetit të Republikës së Kosovës edhe në ato vende ku nuk arrin dora e institucioneve tona të Kosovës. Pra, ne duhet gjithsesi ta pranojmë si partner, po sjelljet e tyre të jenë të kontrolluara dhe mos të sillen si zot shtëpie në shtëpinë tonë.

Jemi për bashkëpunim me çdokënd që ndihmon në ruajtjen e rendit dhe ligjit, dhe ne si institucion më i lartë gjyqësor duhet të jemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Breca!

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Nuk e di se ku kemi progres në sundimin e ligjit dhe ku kemi progres në siguri kur çdo ditë ndodhin ngjarjet që na tregojnë të kundërtën. Rasti më i freskët është rasti në komunën e Prishtinës, ku janë marrë në pyetje dhe paraburgim gjashtë zyrtarë të lartë të komunës së Prishtinës për shkak se kanë kryer punën e vet.

Ky nuk është rasti i vetëm që ndodh në komunën e Prishtinës. Kanë ndodhur edhe më herët, dhe atë disa herë. Është rasti i drejtoreshës, kur në vitin e kaluar është marrë në pyetje në lidhje me një vendim të cilin e ka dhënë për një aktivitetet të cilin e kanë organizuar personat me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu, njëjtë ka ndodhur edhe me mua personalisht, deri sa kam qenë drejtoreshë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në komunën e Prishtinës, me ç'rast policia në zyrën time më kanë marrë në pyetje mua dhe punëtorin social nga Qendra për Punë Sociale "Kodra e Trimave" në lidhje me një vendim profesional të cilin e ka marrë punëtori social në lidhje me klientin e vet.

Nuk e di se prej kur ka filluar policia të merret edhe me vendimet profesionale, kur dihet se ekzistojnë bordet e ndryshme profesioniste që merren me këto çështje. Në qoftë se ka pasur ndonjë gabim, atëherë aty ka qenë kryetari dhe organet kompetente që do të merreshin me këto çështje. Është edhe rasti i punëtores shëndetësore nga Qendra kryesore e mjekësisë familjare, ku nga vendi i punës – shërbimin e rendgenologjisë, në orarin e punës, e lidhur me pranga është dërguar në stacionin e policisë pa u respektuar asnjë procedurë dhe pa u respektuar hierarkia e Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare. Mos të flasim edhe për rastin e fundit të tifozëve, të Sigal-Prishtinës, të cilët janë rrahur brutalisht, po edhe shumë e shumë raste të tjera.

Policia, mendoj, ka mjaft punë për të bërë. Çdo ditë ndodhin krime, vjedhje, trafikime dhe në vend që policia të merret me këto probleme, merret me çështje të cilat nuk i takojnë.

Vizitat e shpeshta që bëhen nga ana e policisë në komunë e Prishtinës, bëhen me qëllim që të krijojnë pasiguri të punëtorëve për çdo veprim dhe çdo vendim që ata marrin, bëhen me motive politike për të zbehur punën e një kryetari, i cili i takon një subjekti politik opozitar. Bëhet për të zbehur punën e njerëzve që me të vërtetë tregojnë rezultate të mira të punës. E unë tash, po ju pyes juve - ku e shihni progresin?

Dhe, kam një vërejtje, zoti kryesues! Kjo është hera e dytë që krejt në fund po më jepet fjala, edhe pse unë kam parë që disa këtu kanë shtypur sustën shumë më vonë se unë, kurse mua krejt në fund po më jepet fjala. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, qysh t'ju vjen radha! Renditja bëhet sipas grupeve parlamentare, jo sipas paraqitjes, sepse edhe grupet parlamentare kanë hierarki, dhe kështu është, s'kemi çka të bëjmë. Deputetja Lirije Kajtazi është e fundit!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

U tha shumëçka dhe po mundohem mos t'i përsërisë, se edhe ashtu u zgjat mjaft. S'po e përmendi veriun, s'po përmendi shumë gjëra shqetësuese që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Do të ndalem në një çështje të caktuar, për një kategori të caktuar – trajtimin e viktimave të trafikimit dhe atë nga dhuna në familje.

Nëpër disa komuna të Kosovës, në disa qendra ka që merren me strehimin dhe mbrojtjen e këtyre viktimave, ekzistojnë edhe strategjitë e Qeverisë, të cilat u prezantuan në fillim edhe nga ministrat, por ku janë punët në këtë drejtim. Edhe pse përgjegjësia për këtë bie në disa ministri, ato ende vazhdojnë të mbahen me disa programe të përkohshme që ofrojnë disa organizata joqeveritare, e që, siç e dimë, e kanë kaluar gjashtë mijëshen, me bollëk i kemi, dhe jo nën kujdesin permanent dhe me programe të plota që do të mundësonin ri-integrimin e këtyre viktimave që është çështja esenciale pse ato ekzistojnë.

Puna e parë që fillohet me këta njerëz është motivimi për jetë të pavarur, të dinjitetshme, ani se institucionet nuk e bëjnë punën e mjaftueshme që t'ua ofrojnë këtë jetë. Më pas, me një strehim emergjent, që degradon në një zgjatje të pa kufi, nuk dihet sa, dhe më e rënda në mungesë të programeve për rehabilitim e ri-integrim dhe për pasojë një gjendje shumë më e rëndë se sa fillimi. Është më se e nevojshme të monitorohet mirë puna me këtë shtëpi, me këto qendra – trajtimi i viktimës me krejt kompleksivitetin e krijuar, e pse jo edhe shpenzimet e parasë, që nganjëherë janë motivi kryesor pse hapen ato.

Këtu, siç e di, është edhe koordinatori nacional i strategjisë, është mirë të mendohet kjo punë bashkë me ministrat për t'i monitoruar këto gjëra mjaft me rëndësi. Në të kundërtën, më mirë do të ishte të motivohen viktima të durojnë një të keqe të vogël në familje, sesa një mohim të plotë nesër nga shoqëria.

Dhe, për fund, para se të ankohe mi në ndërrimin e petkut nga UNMIK-u në EULEX, siç u tha këtu te disa folës dhe njerëz të njëjtë dhe te korrektësia e tyre, do të ishte mirë të shohim çfarë bëjmë me institucionet tona që i krijojmë duke ndërruar petkun nga SHIK në AIK dhe për të parë se sa jemi korrektë me to. Faleminderit!

KRYESUESI: Të faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë të paraqitur. Sipas rregullës, përfaqësuesi i Qeverisë, zoti zëvendëskryeministri e ka fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Më lejoni që në fillim të këtij përfundimi, do të thotë të prezantimit të Qeverisë, të falënderoj që të gjithëve për prezantimet, për deklarimet, për sugjerimet, por edhe për kritikën përmbajtësore që keni bërë për punën e Qeverisë.

Më lejoni që të tentoj të jap disa përgjigje për çështjet që u ngritën nga ju, të nderuar deputetë, dhe po ashtu të jap edhe disa synime që i kemi ne si Qeveri.

Fillimisht do të filloj me zotin Kryeziu, profesorin i cili e tha që çështja e rendit dhe ligjit është proces. Dhe, unë pajtohem plotësisht, dhe ky proces është jo vetëm për Kosovën, por besoj edhe për të tjerët, që i ka sfiduar, do të thotë nga Kroacia e teposhtë, gati të gjithë. Ky nuk është ndonjë justifikim për ne, por një proces i cili nuk ka filluar me ne dhe nuk do të përfundojë. Po unë do të shtoja që është edhe një parakusht për zhvillim ekonomik e integritet evropian, por janë disa akterë. Unë e di se Qeveria është akteri kryesor dhe duhet të jetë ashtu, po janë edhe disa akterë tjerë që lidhen, në veçanti do të thosha, në radhë të parë me vullnetin. Vullnetin do ta ndajë në dy grupe: në vullnetin politik dhe, e përmendi një kolegë këtu, zoti Vataj më duket, vullnetin për bashkëpunim me organet e drejtësisë. Vullneti politik tregohet nga ju, nga ne, nga qytetarët, nga partitë politike. Por vullneti për të bashkëpunuar është vullnet individual i secilit qytetar që duhet të punojë më shumë në vetëdijesimin e tyre.

Në anën tjetër, obligim që është edhe i yni dhe i juaj, është ngritja e ligjeve të mira, apo nxjerrja e ligjeve të mira. Unë e di që në Kosovë ka ligje të mira dhe e di që ato ligje tani kalojnë në fazën e implementimit, ku implementues nuk jemi vetëm ne Qeveria, por implementues janë edhe institucionet tjera, në veçanti ato të drejtësisë kur është fjala për sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial.

Qeveria ka përgjegjësi për t'i ngritur kapacitetet dhe, e tha zoti, më duket Anton Çuni, nuk është marre të thuhet që kapacitetet s'janë të mjaftueshme. Edhe unë e them ashtu. Ne duhet t'i ngrisim kapacitetet, jemi duke i ngritur ato dhe ngritja e kapaciteteve tona duhet të jenë në proporcion në zbehjen e autoritetit të ndërkombëtarëve në Kosovë. U përmend këtu, Qeveria s'ka qenë asnjëherë kundër EULEX-it. Nuk është as sot. Qeveria ka qenë për bashkëpunim dhe partneritet dhe unë e them, e tha zoti Hasani në fillim. Unë e them se Qeveria e Republikës së Kosovës është për partneritet me EULEX-in dhe ky partneritet për rend dhe ligj. Dhe ne e kemi kritikuar, Qeveria e ka kritikuar EULEX-in, jo kur e ka prek dikë, por e ka kritikuar kur s'ka punuar. Dhe ne kemi thënë, urdhëro puno! Dhe, ju e dini po ashtu, në situatat më të rënda që mund t'i quaj dikush, ne kemi dalë dhe kemi thënë – jemi për bashkëpunim dhe partneritet. Po e them edhe sot. Por ky partneritet dhe bashkëpunim duhet të jetë në ngritjen e kapaciteteve tona dhe zvogëlimin e prezencës së tyre dhe ju e dini një ndër prioritetet e Ministrisë që e udhëheq unë është strategjia dalëse për EULEX-in në Republikën e Kosovës. Po kjo nuk nënkupton konfrontim, por përgatitje të ligjeve dhe të kapaciteteve tona. Unë besoj në përgatitjen e infrastrukturës për institucionet. E them dhe e besoj bashkë edhe me ndihmën tuaj. Sot gjyqtarët e prokurorët në këtë vend nuk kanë të drejtë të ankohen, për dy çështje: E para, e kanë mandatin e përjetshëm pas rizgjedhjes prej tri viteve dhe kjo i garanton që s'mundet asnjë parti politike, kushdo që të vijë në pushtet, të ketë ndikim. Dhe, e dyta, e kanë pagën më të madhe se sa unë, se sa ministri i Drejtësisë dhe unë mendoj se ky është një shembull i mirë për pavarësinë e tyre, por edhe për kërkesën për të punuar më shumë.

Zoti Gjini, e tha me të drejtë, po i shohim të tjerët çka janë kah bëjnë, çka jemi ne. Unë pajtohem, zoti Gjini, me këtë dhe në këtë drejtim, do të thosha duhet ta heqim logjikën t'i fajësojmë të tjerët. Për rend dhe ligj në veri, unë e fajësoj EULEX-in, edhe KFOR-in e të tjerët. Për rend dhe ligj në Prishtinë, Gjakovë, Gjilan e diku tjetër kemi faj edhe ne, nëse

munjon. Dhe, në këtë drejtim, duhet të gjithë ne, në veçanti do të thosha, prokurorët dhe gjyqtarët dhe po ashtu duhet t'i ikim një, apo t'i ikim një rrëshqitje, mund ta prekë drejtësia kë të dojë, ta lejojmë drejtësinë ta thotë fjalën e vet. Mos të japim paragjykime. Deputetët me paragjykime mund të japin edhe presion mbi drejtësinë.

Po them, profesor Hamiti e përmendi – kush sundon këtu. Teoretikisht, thuhet, zoti profesor - ligji sundohet me ligj. Bile, në demokraci thuhet, nga vullneti i shoqërisë, i shumicës. Por, ajo çka mund të them unë, që e shtoj në thënien tuaj - kush e ruan rojtarin. Këtu po hapet dilema. Kush janë ata që e ruajnë rojtarin. Unë them që njerëzimi gjithmonë e ka përdorur ja forcën, ja ideologjinë, ja besimin, ja moralin, ja ligjin për t'i kontrolluar njerëzit. Dhe kështu shkon edhe sot, ka për të shkuar edhe në vitet e ardhshme.

Besoj që, si e përmendi edhe zoti Haziri, nuk qenka këtu, pajtohem plotësisht se duhet të kemi një koordinim më të mirë. Një prej pikave, ndoshta pika e parë, është koordinimi i sistemeve të drejtësisë dhe të sigurisë në këtë vend. Ne kemi të shpërndara në pjesë... të ndryshme, duke ruajtur pavarësinë, se në emër të pavarësisë në këtë vend, në sistem të drejtësisë po i iket llogaridhënies. Ka njerëz që thonë këtu, unë jam i pavarur. Ju e dini edhe vetë, keni edhe agjencione tuaja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, shtoja edhe pak kohën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dhe këtu e dini, që i keni edhe agjencione apo institucione të pavarura. Në emër të saj i ikim llogaridhënies. Ashtu ballafaqohemi edhe ne. Dhe, ky është një proces, të gjithë jemi të pavarur prej njëri-tjetrit, por gjithë jemi pjesë e një sistemi që duhet të japim llogaridhënie.

Zoti Muja i dha disa propozime konkrete. Ajo çka pajtohem, që u lidh edhe me veriun. Pajtohem që ju jeni që të mos ketë asnjë mandat atje. Dhe Qeveria e Kosovës në asnjë rast s'i ka dhënë mandat dhe nuk i jep për bashkëpunim atje. Pajtohem që të ketë prezencë edhe fizike, jo vetëm ajo vizive. Por, në raport me veriun duhet të themi, përveç punëve që duhet t'i bëjmë brendapërbrenda, u përmend nga disa këtu, duhet t'i definojmë raportet, jo vetëm Kosovë – Serbi por Kosovë e Serbi me BE-në.

Dhe pajtohem plotësisht, dhe ne kemi venë që kushte apo parakushte për çdo proces të integritetit në BE të jetë edhe për Kosovën edhe për Serbinë, dy: njohja reciproke e njera tjetrës dhe respektimi i tërësive territoriale. Pa këto dy parakushte - çdo lëvizje, besoj, në këtë drejtim është e dëmshme.

Natyrisht, Albulena duket e ka marrë një obligim pak të merret me mua më shumë, po s'prish punë, s'di a je juriste apo jo? E përmende Këshillin Konsultativ të Drejtësisë. Si të thuash konsultativ, nuk është obligativ. E dyta, përbërja e atij këshilli, pasqyron konsensusin nacional. Unë nuk mendoj të bëj reforma në drejtësi me mendimet e Partisë

Demokratike të Kosovës. Se reformat që mund t'i fillojë unë, i ka filluar dikush para meje. Nuk mund të krijojmë drejtësi dhe siguri me objektivat e një partie politike.

Po e them publikisht. Unë e kam ftuar zotin Adem Demaçi të jetë kryetar i këtij Këshilli. Do të thotë, qëllimi im është që t'i inkorporoj njerëzit që janë simbol të drejtësisë dhe janë njerëz të cilët identifikohen edhe nga bota akademike, por edhe simbolikat e tyre për drejtësinë. Dhe unë do të jem një prej anëtarëve. Nuk do ta udhëheq unë, dhe në vendim të Qeverisë thuhet që nuk udhëhiqet nga ministri i Drejtësisë.

E përmendët Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës. E para, ne nuk kemi arsye t'i frikësohemi të vërtetës. Ne duhet ta ballafaqojmë të vërtetën në sy. E vërteta jonë përball të tjerëve, e tjerëve përball nesh, po edhe e vërteta brendapërbrenda nesh. Dhe, ajo çka dua të them, ne duhet për aq sa është EULEX-i në Kosovë dhe ka mandat të plotë për krime të luftës, duhet të bashkëpunojmë me Ata. Por Instituti nuk e ka për obligim t' i marrë parasysh... instituti do të jetë kryesisht i karakterit shkencor, profesional me një mision të veçantë – në kohën kur ngritën apo krijohen kushtet për ngritjen e padisë për krime të luftës në Kosovë ndaj Serbisë, t'i kemi disa letra. Ne kemi pjesëza të ndara, në Këshill për të Drejtat e Njeriut, në sindikata, në parti politike të mëhershme, por mendoj që duhet t'i kemi në mënyrë të argumentuar dhe shkencore.

Zoti Kasolli e definoi lirinë dhe e përmendi pak edhe lindjen edhe perëndimin. Së pari, zoti Kasolli, liria nuk kufizohet me ligj, është vlerë që ligji e normon. Mund të jetë më shumë se sa ligjet. E dyta, e përmendi lindjen dhe perëndimin, që nuk ka dallime. Por ajo çka mund të them, e përfunduat, që thatë, Qeveria po e do perëndimin në mënyrë lindore. Dhe unë po e them kështu, lufta e Skënderbeut, alfabeti latin dhe orientimi politik dhe ushtarak në vitet e 90-ta, është shpëtim i kombit shqiptar. Dhe unë mendoj që këtu pajtohem që të gjithë.

Dhe, krejt në fund, më lejoni të them që nuk e marrim ne në Qeveri këtë debat si presion, ne e marrim fuqizim për rendin dhe ligjin, për sistemin e drejtësisë dhe unë ju ftoj që debate të tilla të keni edhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, po edhe me Këshillin Prokurorial, që do të ishte një ndihmë e mirë dhe me agjencione të tjera që merren për sigurinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, ministri i Brendshëm, zoti Rexhepi e ka fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues,
Zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë,
Shumicën e çështjeve i tha zëvendëskryeministri, e tha edhe në nivelin akademik, unë do t'i shmangem kësaj pjese dhe do të jem pak jo për të replikuar, por nëse ka nevojë diku ndonjë sqarim.

Fillimisht, edhe unë e përshëndes këtë debat se ka pasur shumë edhe sugjerime dhe ide dhe edhe aty ku ka pasur kritika mendoj se është shqetësim i përbashkët që siguria dhe

sundimi i ligjit nuk është i mjaftueshëm asnjëherë dhe duhet gjithë të angazhohemi dhe të ketë më shumë sundim të ligjit dhe sidomos në veri të Kosovës.

Po nisem nga një çështje që u përmend nga disa dhe është një brengë e madhe që edhe dy vjet pas vjedhjes në Dhomën e Dëshmimeve nuk është zgjidhur ky rast. Fillimisht edhe hetuesia e Policisë i ka pasur disa muaj hetimet, pastaj e kanë marrë komplet EULEX-i dhe ndoshta një nga pakënaqësitë më të mëdha të miat kanë qenë në lidhje me këtë rast dhe ndoshta sonte edhe do të kem një përgjigje zyrtare në kërkesën që kemi bërë. Ka pasur forma të ndryshme se a do të përmbyllet ky rast pa ngritur asnjë aktakuzë. Ne insistojmë që ky rast nuk mund të përmbyllet në atë mënyrë, por do të hetohet deri në fund dhe ata që e kanë bërë këtë vjedhje duhet të dalin para drejtësisë dhe sipas të gjitha gjasave do të bëjmë ne ekip hetues të përbashkët, vazhdohet në atë drejtim dhe nuk përmbyllet në këtë mënyrë pa rezultate për arsye se kjo është një hipotekë, një barrë që edhe më tutje e rëndon edhe policinë edhe të tjerët.

Po them, vetëm sa për informim, se sa është çështja e dëshmimeve, këtu më tepër është çështje e vjedhjes së narkotikëve dhe parave që ka qenë dhe pak ka ndonjë vlerë të dëshmimeve të krimeve që janë bërë në të kaluarën. Por, ky është një mësim që në të ardhmen se si duhet të veprojmë më mirë dhe jam optimist se bashkërisht me EULEX-in mund ta përmbylлим në mënyrë të suksesshme, nuk them datë e muaj, po sigurisht se duhet të përmbyllet me rezultat konkret.

Pra, të them edhe një herë, vetëm dua të përsëris që edhe hetuesia e policisë edhe prokuroria dhe gjyqësia nuk duhet të jenë nën presione politike dhe as unë si ministër as brenda policisë nuk kemi qëllime të dëmtohet dikush politikisht, por si kanë ndodhur arrestimet me kërkesën e prokurorit në komunën e Prishtinës mund të ndodhin edhe në komuna tjera, në ministri dhe kudo qoftë, do të kemi qasjen e njëjtë. Pra, larg asaj që ta politizojmë dhe nuk dua që Policia e Kosovës të jetë e politizuar në këtë drejtim, por ta kryejë detyrën e vet ashtu qysh e ka mandatin.

Reformat në polici vazhdojnë edhe më tutje dhe do të ketë reforma edhe në pjesën veriore. U përmend edhe komandanti i një stacioni. Tash nuk dua të hy në detale, por këto ditët e ardhshme shumë shpejt do të ketë reforma edhe në stacionet e policisë në veri dhe do të vazhdojë nga niveli qendror edhe nëpër regjione edhe nëpër komuna tjera dhe ne nuk do të lejojmë ndërhyrje politike në polici. Po vetëm sa për sqarim që politikëbërjen e bëjnë Qeveria edhe nëpërmjet Ministrisë, policia është zbatues e ligjit dhe natyrisht që menaxhohen nga pjesa politike. Për arsye se nuk mund të jetë komplet e pavarur në nocion abstrakt dhe të mos jep llogari kurrkujt, kështu që në këtë drejtim edhe do të vazhdojmë më tutje.

Sa i përket targave të ndryshme që janë, urdhri për konfiskim është valid edhe më tutje dhe sa për informim në dy ditët e kaluara katër palë targa janë konfiskuar në pjesën veriore, dy në Lagjen e Boshnjakëve, një në Kroin e Vitakut dhe andej... Nuk ka shumë në veri, për arsye se urdhri është valid edhe më tutje dhe pavarësisht kërkesave të individëve lokal, ata e dinë se nuk mund të qarkullojnë nëpër pjesë tjera të Kosovës. Në

veri praktikisht është pak më vështirë, por edhe atje ka rezultate dhe mesazhi është shumë i qartë, do të vazhdohet në këtë drejtim.

Unë desha të përmend, këtu e kemi deputetin ish- ushtruesin e detyrës së drejtorit të Policisë, as unë nuk do të avokoj për këtë, po e di shumë mirë, edhe bashkëpunimin dhe ai s'ka pasur kurrfarë presioni as nuk është shkarkuar. Me vetë dëshirë ka hyrë në skenën politike, bile ... ka qenë në tregun politik dhe tash është deputet. Përkundrazi, e ka pasur përkrahjen e plotë dhe në momentin kur kemi insistuar që prej drejtorit të Policisë dhe deri te strukturat tjera....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta ministrit...!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: ... dhe në atë drejtim, por është vetë dhe nuk e kam ndërmend të avokoj , përndryshe e kam përkrahur punën e tij dhe është normë ligjore që më mos të kemi ushtrues detyre as në polici, po as në ministri dhe ky është proces që ndodh edhe më tutje.

Sa i përket lëvizjes ose me tabela, përmendet aty, unë jam një prej atyre që gjatë vikendit jam çdoherë në pjesën veriore dhe them para jush shumë shpejt shkoj nëpër urën kryesore me tabela të KS, ndoshta më vonë edhe RKS-së dhe nuk kam probleme as nga policia as nga të tjerët. Kjo s'do të thotë se lëvizja e lirë në veri është plotësisht, por varet pak edhe nga vendosmëria e njerëzve që jetojnë atje.

Është shumë pozitive që edhe dje, gjatë mocionit, u përmend se çdo tre muaj ne duhet të raportojmë për progresin që bëhet në pjesën veriore. Mendoj se është iniciativë e mirë. Kjo na mobilizon edhe më tutje dhe do të jemi shumë më të vendosur që të shtrihet sundimi i ligjit edhe në institucionet qendrore edhe në pjesën veriore.

Sa i përket strategjive, me të vërtetë është një numër shumë i madh. U tha këtu edhe nga deputetët e ndryshëm. Disa veç të aprovuar, disa janë të kryera edhe plane të veprimeve dhe nuk mund të priten rezultate nga të gjitha këto menjëherë, por dihet se fillimisht është një strategji, një synim çka dom, janë planet e veprimit dhe pas një kohe vlerësohen se sa implementohen. Për disa prej tyre ka rezultate konkrete, sidomos sa i përket pengimit të trafikimit me qenie njerëzore e shumë tjera, mirëpo nuk do të hyj shumë në detaje dhe shumica prej tyre në fazat e ardhshme do t'i vlerësojmë se sa implementohen.

Dua vetëm një përgjigje, aty u përmend nganjëherë se Këshilli për Siguri Kombëtare mban takimet dhe nuk dihet se çka bëhet. Ata që janë njohës të mirë, mund të them se për zotin Burim Ramadani, edhe pse e kam pirë kafën, unë e kam parë dhe me vëmendje e kam dëgjuar dhe e di...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Deputeti Nait Hasani e ka fjalën, i fundit!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Falënderoj deputetët për kontributin që dhanë me fjalimet e tyre, deklaratat, propozimet, kërkesat. Unë vetëm mund të them që angazhimi i secilit në këtë pikë për rendin dhe sigurinë në Kosovë ka qenë mjaft i frytshëm, mjaft i rëndësishëm dhe këtë mund ta them që edhe Bashkimi Evropian ose prej Brukselit, Maja Kacijançiq është angazhuar të japë edhe komentet e veta pikërisht për debatin e sotëm dhe ajo ka thënë, që, sipas saj, iniciativën duhet të ndërmarrin vendorët dhe se janë autoritet lokal ata që duhet të udhëheqin me rendin, ligjin dhe sigurinë.

Prandaj, unë propozoj që rekomandimet të cilët u lexuan në fillim, t'i lexoj edhe një herë dhe t'i votojmë, që të angazhohemi që çështja e Kosovës dhe siguria e saj të jenë pikë që ne duhet të vendosim.

Prandaj, unë me anë të propozimit tim, dhe kërkesave që i kemi bërë dhe atë që lexova, kërkoj që të votohen rekomandimet dhe propozimi që të formohet një delegacion nga Parlamenti i Kosovës, të shkojë në Bruksel dhe në Parlamentin Evropian për t'i prezantuar të gjitha këto shqetësime lidhur me punën e EULEX-it. Ky është në interes të EULEX-it, të Kosovës dhe të sigurisë.

Prandaj, vendosja e ligjit dhe kushtetutshmërisë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës:

- Kërkohet nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe misioni ndërkombëtar në Kosovë që të respektohet Kushtetuta dhe ligji në fuqi;
- Kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare që në mënyrë urgjente të ndërmarrin hapa konkretë në shpërndarjen e strukturave të aparatit shtetëror të Serbisë në Kosovë;
- Kërkohet nga misioni ndërkombëtar të bëjë implementimin e pakos së Ahtisarit edhe në pjesën veriore të Kosovës.

Unë kërkoj që të votohen këto. Ju faleminderit për debatin!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të vazhdojmë me votimin e rekomandimeve, konstatoj se në sallë janë 70 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për të vazhduar procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani. Faleminderit!

Konstatoj se me 32 vota “për”, 15 “kundër”, 3 “abstenime” Kuvendi miratoi rekomandimet lidhur me gjendjen e sigurisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Faleminderit!

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale, për vitin 2010

Komisioni funksional për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të pavarur Miniera e Minerale për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës, ftoj kryetarin e komisionit funksional Zenun Pajaziti për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19.4.2011 shqyrtoi Raportin vjetor të punës për vitin 2010 të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

Rekomandimi është që të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2010 të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale.

Komisioni ka vlerësuar se ky raport është në pajtim me nenin 58 të Ligjit numër 03/L-163 për miniera dhe minerale dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për një angazhim konstruktiv gjatë debatit të brendshëm dhe takimit me KPMM dhe po ashtu dëshiroj të ju njoftoj se janë shtruar disa çështje problematike që kanë të bëjnë me ushtrimin e aktivitetit të këtij komisioni dhe po ashtu me disa dukuri të cilat ndikojnë drejtpërdrejt edhe në zhvillimin ekonomik të vendit, po edhe në ambientin e vendit tonë. Janë trajtuar disa çështje të cilat janë marrë nga komisioni si rekomandime të Komisionit dhe ne besojmë se ky komision do t'i trajtojë me përpikëri. Ju ftoj pra, të gjithëve, edhe grupet edhe deputetët që të votojnë për këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Hadergjona, do ta bëjë arsyetimin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet e Financa në mbledhjen e mbajtur me datën 13.4.2011 ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010 dhe ka vlerësuar se raporti është i përgatitur mirë teknikisht, janë pasqyruar shpenzimet sipas kategorive ekonomike duke bërë krahasime me vitet e kaluara si dhe buxheti është shpenzuar 95.84% nga buxheti i planifikuar kurse sipas kategorive për paga dhe mëditje është realizuar 99.30%, kategoria e mallrave dhe shërbimeve është realizuar

95.71%, kategoria e shpenzimeve komunale është shpenzuar 79.59%, subvencionet 98.75%, kurse shpenzimet kapitale janë realizuar diku 91%.

Në raportin vjetor të Komisionit për Miniera dhe Minerale për vitin 2010 janë të përfshira të gjitha të dhënat e nevojshme për shpenzimet e buxhetit nëpër kategoritë ekonomike e po ashtu janë detalizuar shpenzimet nëpër kategori të ndryshme.

Anëtarët e Komisionit kanë kërkuar disa sqarime të prezantuara në raport për të dhënat e prezantuara në raport, si çështja e të hyrave nga renta minerare, që janë të prezantuara dhe më të larta se sa faturimi i tyre si dhe të hyrat nga tantiema dhe destinimi i tyre. Po ashtu u kërkuar arsye për rritjen e disa shpenzimeve në kategori të mallrave dhe shërbimeve krahasuar me vitet e kaluara.

Nga pyetjet e parashtruara, përfaqësuesit e KPMM-së kanë sqaruar se mjetet nga renta minerare janë të pasqyruara më tepër se sa të faturuara për shkak të inkasimit të mjeteve edhe për vitet paraprake. Ndërkaq, të hyrat e realizuara nga tantiema në përputhje me ligjin e ri janë të prezantuara si të hyra nga renta minerare dhe ato depozitohen në buxhetin e Kosovës si para publike në përputhje me Ligjin e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Sa i përket rritjes së disa shpenzimeve për mallra dhe shërbime, sipas tyre kjo ka ndodhur për shkak të rritjes së aktiviteteve në terren.

Bazuar në të gjitha sqarimet të cilat janë ofruar dhe duke vlerësuar se raporti financiar i Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010, respekton parime të përgjithshme të kontabilitetit për raportim financiar si dhe obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, kështu që Komisioni njëzëri ka rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, kabinet qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Komisioni i pavarur për Miniera e Minerale është një rregullator ekonomik me qëndrueshmëri financiare si faktor kyç për pavarësinë e funksionimit të tij.

Komisioni i pavarur për Miniera e Minerale është autoritet i vetëm për të lëshuar, inspektuar dhe revokuar lejet dhe licencat për operatorë, përkatësisht operime minerare, qofshin hulumtuese apo të shfrytëzimit në sektorin e minierave në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Kuvend duhet të ushtrojmë më shumë mbikëqyrjen ndaj veprimtarisë së rregullatorëve ekonomikë siç është në këtë rast KPMM-ja dhe këtë vëmendje nuk duhet

pasur vetëm me shqyrtimin e raporteve vjetore që shpesh këto raporte dinë të jenë më tepër përshkruese, të hartuara me paraqitje të tilla në formë afirmative të punës së tyre.

Duke iu referuar këtij raporti, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i gëzohemi faktit se përkundër ballafaqimit me probleme të shumta, ky institucion i pavarur gjatë vitit të kaluar ka arritur rezultatet më të larta që prej themelimit të këtij rregullatori ani se aty këtu vërehet lehtëmendësia e UNMIK-ut kur dihet se ky institucion është si pasardhës i Drejtorisë së Minierave dhe Mineraleve të Shtyllës IV të UNMIK-ut.

Të nderuar deputetë,

Në përputhje me Ligjin për miniera dhe minerale në Kosovë, neni 58 – Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale i dorëzon raporte të rregullta Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit kalendarik të cilit i referohet raporti.

Bazuar në këtë, raporti del i mangët në disa segmente. Për shembull, tek licencat për hulumtime gjeologjike dihet vetëm numri i licencave të lëshuara por nuk dihet sa kanë pasur mundësi të përcillen kompanitë me licenca hulumtimi për minerale metalore se a i kanë kryer këto hulumtime sipas programeve të paraqitura në KPMM dhe nëse një kompani brenda afatit ligjor nuk i është përmbajtur, përkatësisht nuk i ka kryer hulumtimet, si është vepruar në këto raste kur këto kompani kanë aplikuar për vazhdim licence.

Në raport nuk dihet se a janë interpretuar hulumtimet e vjetra, ose kur jemi te operimet ilegale, sa ka arritur KPMM-ja të koordinohet me komunat përkatësisht inspektorët komunalë në lidhje me ndërprerje e operimeve ilegale, sa përkrahen nga komunat sepse dihet se disa komuna nuk e njohin këtë institucion.

Për shembull, faqe 54, thuhet se në bashkëpunim me departamentet tjera është bërë identifikimi i operatorëve të licencuar që nuk e kanë paguar renten minerare dhe që nuk kanë raportuar ashtu si parashihet në licencë.

Në këtë rast, në raportin e të hyrave të realizuara, janë paraqitur vetëm obligimet e” Trepçës” ndaj KPMM-së, nuk dihet sa janë realizuar të hyrat e kompanive tjera të mëdha, siç është KEK-u, Feronikeli, e tjera.

Pra, nuk është paraqitur në raport për cilat kompani është fjala, me përjashtim të një kompanie, që është paraqitur borxhi i ngarkuar retroaktivisht për cilën gjë nuk dihet se a kanë pasur të drejtë ligjore për një veprim të tillë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin e KPMM-së dhe, që të mos zgjatet më shumë, në formë të rekomandimeve do t’i lexoj me radhë se çka ka vendosur.

KPMM-ja duhet të vendosë ose t’u ofrojë bashkëpunim institucioneve përkatëse në Kosovë, të ketë marrëdhënie konstruktive me të gjitha institucionet si AKP-në, Ministrinë

e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, komunat dhe institucionet tjera që janë të përfshira në sektorin e minierave.

Mandej, të jetë më efikase në eliminimin, përkatësisht luftimin e operimeve ilegale, domethënë duhet të hartojë plan veprimi për të ndalë operimet ilegale.

Të mbrojë sektorin e minierave për të siguruar shfrytëzim racional të resurseve minerale.

Të zbatojë ligjin për miniera dhe minerale edhe në kuptimin e lirimit të disa kompetencave, sidomos në fushën e gjeologjisë, që këto kompetenca t'i bartë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Të zbatojë Planin e guroreve të Kosovës duke mos lëshuar licenca jashtë këtij plani.

Mandej, kompanitë e huaja që kanë kryer projekte kapitale në KPMM të obligohen t'i dorëzojnë projektet edhe në gjuhën shqipe. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Raportin e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale e kemi shqyrtuar edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së, ku është analizuar bukur gjatë dhe janë bërë pyetje e sugjerime.

Raporti i dorëzuar është një dokument voluminoz dhe teknikisht i punuar mirë, me mjaft shënime dhe tabela analitike.

Veprimtaria e hulumtimit e sidomos e eksploatimit të resurseve natyrore përbëjnë një lëmi për të cilën duhet të kihet kujdes për mënyrën, për sasinë e eksploatimeve, për kontrollin e mirëfilltë të firmave që licencohen dhe që eksploatojnë pasuritë, për ndalimin e operatorëve ilegalë të cilët bëjnë dëme dhe për mënyrën e rehabilitimit të ambientit dhe kthimit në gjendje paraprake nëpër vende ku kjo licencë ka përfunduar.

Për të qenë kjo veprimtari plotësisht funksionale, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë dhe i koordinuar i shumë aktorëve, siç janë KPMM-ja, komunat përkatëse, policia, inspektorati, por edhe agjencioni i cili deri më tani mungon dhe pasojat e mungesës së të cilit shihen përmes keqpërdorimit nga ana e operatorëve ilegalë.

Në anën tjetër, në qoftë se analizohet gjendja e tanishme e lumenjve, e ambienteve përreth apo brenda gurëthyesve dhe ambienteve tjera, shihet se KPMM-ja dhe të gjithë aktorët tjerë kanë bukur shumë punë para veti për të qenë funksionalë ashtu si duhet.

Në qoftë se analizohet marrja e licencave dhe eksploatimi, atëherë shihet që edhe në këtë lëmi firmat të cilat janë të licencuara ka dyshime për mënyrën e licencimit por edhe në funksionimin e tyre në kuadër të kompetencave të tyre.

Në anën tjetër, operatorët ilegalë vazhdojnë të funksionojnë. Secili prej nesh i cili udhëton, ka mundësi që në mëngjes herët apo në mbrëmje të shihen kamionë të shumtë të rëndë të mbuluar nga të cilët kullon uji dhe të cilët i dëmtojnë shtretërit e lumenjve, ndonëse në KPMM thonë që nuk ka asnjë licencë të dhënë për këtë veprimtari.

Për degradimin e ambientit nuk kemi çka të flasim, sepse ai degradim ka filluar herët dhe ende vazhdon me të madhe që të degradojë shtretërit e lumenjve dhe ambientin e Kosovës.

Në KPMM nga Bordi i cili raportoi në Komision u tha që ka pengesa të shumta dhe që ende mungon mbyllja e atij qarku institucional, i cili do të bënte funksional edhe KPMM-në.

LDK-ja kërkon dhe rekomandon:

- që KPMM-ja të eliminojë pengesat e deritanishme, të shqyrtojë kohëzgjatjen e licencave në mënyrë që ato të jenë funksionale si dhe mënyrën e licencimit të operatorëve legalë;
- që agjencioni të aktivizohet sa më shpejt në mënyrë që të organizohet në mënyrë efektive puna e të gjithë aktorëve të KPMM-së, komunave, inspektoratit, policisë dhe të gjithë aktorëve tjerë të cilët marrin pjesë në këtë rreth institucional;
- që inspektorati të funksionojë ashtu që të mbrohet ambienti por edhe operatorët e licencuar nga konkurrenca jo lokale;
- që policia të jetë në nivel të detyrës kur vihet te eksploatimet nga ana e operatorëve ilegalë, ku si pasojë vjen deri te dëmtimi i ambientit dhe shkatërrimi i pasurive tona.

Grupi Parlamentar i LDK-së pret që raporti i KPMM-së për 2011 të ketë të zgjidhura këto pengesa të cilat sot ekzistojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës, do të tentoj të jem sa më i shkurtër në paraqitjen e qëndrimit tonë karshi Raportit të dorëzuar të KPMM-së.

Së pari, dua të them që është bërë ose ndoshta edhe ka qenë edhe më herët një praktikë që këto raporte të agjencive të pavarura të jenë mjaft të mangëta në informatat që i japin. Shihet që në komisione në të cilat ato diskutohen, nxirren shumë më shumë informata nga raportuesit, mirëpo konsideroj që këto informata duhet të jenë në disponim edhe të deputetëve tjerë, për shkak se kërkohet edhe vota e tyre, karshi këtyre raporteve.

Për sa i përket raportit në fjalë, duhet të konstatoj në fillim se nuk duket që pasqyrat financiare që paraqiten aty janë konform ligjit në fuqi dhe as që këto pasqyra janë të auditura, pra janë informata të cilat jepen dhe të cilat janë të paverifikuara.

Janë katër probleme kryesore që paraqiten në raportin dhe përgjithësisht me fushëveprimin dhe veprimtarinë në këtë lëmi të jetës ekonomike në Kosovë. Natyrisht më drastike këtu paraqitet veprimtaria e operatorëve ilegalë, ku në raport konstatohet se në këtë drejtim ka pasur përparim, ndërsa të dhënat e tregojnë pikërisht të kundërtën të dhënat po ashtu nga raporti. Pra, në faqen 33 thuhet që ilegalisht veprojnë afër 268 kompani, apo subjekte, ndërsa legalisht veprojnë vetëm 278. Po shihet që numri është thuaja se i barabartë mes operatorëve legalë dhe ilegalë në lëmin e përdorimit të mirave materiale në territorin e Kosovës.

Në këtë vit janë ekspluatuar në mënyrë ilegale diku 1 milion e 524.000 metra kub material, që thuhet në faqen 52. Ndërkohë që ekspluatimi i zhavorrit gjatë vitit 2010 dhe 2009 ka treguar një rënie prej më se 60% për shkak të veprimit të operuesve ilegalë.

Materiali konstaton se operuesit ilegalë i dëmtojnë rënd operuesit legalë dhe buxhetin e Kosovës, pra në faqen 56, në fund të faqes, ndërkohë që KPMM vetëm konstaton mosfunksionimin e sistemit në këtë drejtim dhe nuk jep asnjë fjalë për presionet dhe kërcënimet politike që bëhen lidhur me mos legalizimin e gurthyeshve.

Një pikë tjetër që vërehet këtu është edhe çështja e Sharrcemit, të Hanit të Elezit, që siç e dimë, në fund të vitit 2010 AKP-ja privatizon këtë kompani me procedurë një burimore, një proces mjaft i kontestuar i privatizimit ky. KPMM-ja kompanisë Sharrcem ia ka bartur licencat e shfrytëzimit të vitit 2006 dhe kësaj kompanie menjëherë në janar të vitit 2011, pra menjëherë pas privatizimit, i lëshohen edhe dy licenca për hulumtim, që listohen në listën e licencave aktive numër 77 dhe 98.

Një çështje tjetër që duhet ngritur këtu është edhe çështja e rentave minerare dhe taksave, ku mungojnë të dhënat për efikasitetin e faturimit në shkallën e përgjithshme të inkasimit, borxhet e përgjithshme prej fillimit dhe të tjera.

Taksa për hulumtim dhe renta për minerare janë rregullatorë të rëndësishëm në këtë lëmi, kurse KPMM-ja në këtë raport nuk bën asnjë vlerësim ose propozim për këtë çështje.

Dhe, një pikë e fundit, që dua ta ngrit, është fjala për “Trepçën”. Në raport nuk ka asnjë fjalë për kontestin në mes “Trepçës” dhe Kompanisë Kosovo resource company lidhur me zonat hulumtuese. KPMM-ja në vitin 2007 i ka dhënë kësaj kompanie për hulumtimin në pronë të Trepçës dhe në zonat ku Trepça i ka përfunduar hulumtimet. Me gjithë kundërshtimin e “Trepçës” UNMIK-u atëbotë e ka përkrahur këtë vendim shumë të dëmshëm për Trepçën. Licenca vazhdohet në prill të vitit 2009 dhe tani kjo vazhdohet nga KPMM-ja dhe Kuvendi i Kosovës, pra në atë kohë, dhe raporti nuk cekë asnjë përparim apo ndonjë fjalë për këtë çështje se ku ka mbetur ky kontest dhe si po merret KPMM-ja me këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, do të provoj të jem goxha i shkurtër se ka kaluar shumë kohë, por qare s'pata pa dalë edhe një herë para jush.

Është goxha befasuese, domethënë është e habitshme se qysh Kuvendi i Kosovës mbërrin edhe një herë të vijë deri te kjo pikë dhe të kalojë nëpër një material jashtëzakonisht të rëndësishëm shpejt e shpejt. Është edhe më e habitshme qysh Komisioni, pa marrë parasysh kush është aty, kalon nëpër këtë material jashtëzakonisht shpejt dhe i kapërcen elementet më të rëndësishme të materialit.

Ju kisha tërhequr vëmendjen te tabela 8, në faqen 22. Shumë e shkurtër është tabela, e lehtë për ta parë. Në këtë tabelë e shihni që gjatë vitit 2005, 2006 dhe 2007 ky komision i ka lëshuar 146 licenca për shfrytëzim të materies në gurë, që është gur i fortë për rrugë, ndërsa i ka lëshuar 50 licenca për hulumtim të atij guri. Ndërsa, prej vitit 2008 deri në vitin 2010, do të thotë gjatë vitit 2008, 2009 dhe 2010 në kohën kur ka pasur bum të ndërtimit të rrugëve, ky komision i ka lëshuar vetëm 66 licenca për shfrytëzim e 195 licenca për hulumtim.

Tani licenca për hulumtim lëshohen për hapësira shumë të mëdha të tokës efektive, lëshohen për dy vite, domethënë dy vite bëhet hulumtim i vazhdueshëm, hulumtim duke i mbushur kamionët, dhe mund të zgjatet edhe për dy vjet tjera.

Do të thotë, dikujt në këtë Qeverinë aktuale, bashkë me KPMM-në i ka bërë një klik i jashtëzakonshëm. Lëshoni licenca për hulumtim, mos lëshoni licenca për shfrytëzim, se përmes licencave për hulumtim nuk paguhet Roelti. Do të thotë, Kosova nuk i merr paratë e veta.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

E di që s'ka transmetim, po dikush do ta dëgjojë më vonë. Unë këtë e shoh si një hallkë serioze të krimit të organizuar në Kosovë dhe mendoj se dikush duhet parë prokuroritë dhe të filluar me menduar. Është fjalë e deputetit në foltore zyrtare të Kuvendit të Kosovës, foltoren më të lartë në Kosovë. Ju bëj thirrje me bërë hulumtim se kjo është hallkë tepër serioze e krimit të organizuar në Kosovë.

Është edhe një paradoks tjetër, të nderuar kolegë deputetë. Na këtu shumë jemi UÇK! I kam vetë disa kolegë të mi të UÇK-së: a mos ka qenë edhe ky Bechtelli në UÇK pahiri? I ka 12 licenca për hulumtim, në kohën kur gati e ka shtruar gjysmën, e autostradës.

Bechtell & Enka ka marrë 12 licenca për hulumtim të gurit dhe është duke shtruar me gurë i cili është i dedikuar për hulumtim, është duke e shtruar autostradën. Gati ka shkuar në gjysmën, të cilën ka për ta bërë deri në Arllat, është duke mbërri në Suharekë. E keni tabelën 2, faqe 14 deri në faqen 17, dhe ju kisha lutur ta këqyrni.

Mendoj se përderisa patëm fjalë këtu që duhet të mbrohet ambienti, duhet me u mbrojt 1, 2, 3, 4, 5... të gjitha janë të rëndësishme. Po, edhe një herë po e shfaqim habinë serioze me kolegët e mi në Komisionin për Tregti – qysh nuk e kanë parë as tabelën 8, as tabelën 2! Qysh s'i kanë parë tabelat?! Qysh ka mund Komisioni të na sjell në këtu këtë raport dhe mos të na tregojë qysh mundet të shtrohen krejt rrugët e Kosovës me licenca për hulumtim? Qysh bën kështu! Ne jemi Kuvend, ne duhet t'i mbikëqyrim këta.

Është gati e njëjta gjë sikur që na ka ndodhur me bitumin, kur në kohën kur janë shtruar krejt rrugët e Kosovës, importi i bituminit ka rënë në minimum, përderisa shumë më tepër kemi importuar kur s'kemi shtruar rrugë.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të nderuar kolegë deputetë, ju fton juve që të kërkonit ta shtyni votimin për këtë raport. I dimë pasojat e mos votimit.

Kërkojmë prej jush që ky Komision – Komisioni parlamentar, po mendoj, të shkojë te Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale dhe të kërkojë sqarim: a janë në veti ata njerëz, a janë në tokë të bukës? Qysh bën kështu?

Po ju lus, nëse ne do të kalojmë nëpër këtë material kësisoj, duke e parë këtë që ju thashë unë sot, Kuvendi i Kosovës do ta humbë të drejtën për ta mbikëqyrë në mënyrën qysh duhet ta mbikëqyrë edhe vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar për Koalicionin për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010. Duke marrë parasysh se ky raport është punuar konform Ligjit për miniera dhe minerale, raporti i sivjetmë paraqet gjendjen faktike e cila ndodhet në terren dhe mund të them se në këtë raport shihen akoma probleme të cilat na mbesin nga operuesit ilegalë.

Ligji për minierat dhe minerale mundëson, i jep mundësi KPMM-së që t'i vijë në ndihmë edhe Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, kryeprokurori i shtetit, komunat e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe të gjitha institucionet të cilat mund t'i ndihmojnë KPMM-së.

Mirëpo, siç shihet dhënia e licencave është definuar këtu mjaft mirë, kërkesa për licenca janë diku 187 kërkesa dhe është shumë e qartë që janë kërkuar licenca për shfrytëzim, hulumtim dhe aktivitete tjera të veçanta, mirëpo e gjithë esenca e ndihmës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është deri te formimi i Agjencionit Kadastral, me rëndësi, i cili do të mund të ishte edhe agjencion për menaxhimin e mallrave të konfiskuara, që pritet që Qeveria shumë shpejt të merr hapin e duhur, duke marrë parasysh se gjithë këto institucione duhet t'i dalin në ndihmë KPMM-së, kjo shihet edhe

një herë se Kosovës në këtë aspekt i mungon edhe plani hapësinor dhe është shumë e vështirë çështja e dhënies së licencës dhe kontrollimi nga inspektoratet e minierave që të shihet saktë sa po e shfrytëzon hapësirën për zhvillimin e asaj licence.

Duke marrë parasysh të gjitha të dhënat në këtë raport, shihet se KPMM-ja ka të hyra të veta të cilat të hyra nga rentat janë dedikuar buxhetit të Kosovës dhe ky raport është raport i gjendjes faktike e cila ndodhet në terren dhe është raport i cili nxirret në bazë konform ligjit për miniera dhe minerale dhe shihet se shumë operatorë të cilët gjenden edhe si operatorë të mëdhenj ekonomik, rasti i Sharr-cemit dhe rasti i kompanive tjera në Kosovë që duhet t'i paguajnë rentat këtij agjencioni të pavarur apo këtij rregullatori ekonomik në të mirë të buxhetit të Kosovës, Grupi Parlamentar për Kosovën e re i jep përkrahje këtij raporti dhe kërkon që komisioni për Miniera dhe Minerale të zbatojë ligjin për miniera dhe minerale në mënyrë strikte për arsye se i ndihmon edhe vetes edhe qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën!

HASHIM DESHISHKU: I nderuari, zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në këtë raport ka sjellë mjaft detaje për punën që e ka bërë gjatë vitit të kaluar. Megjithatë, ka mjaft gjëra të cilat nuk kanë dhënë përgjigje të plota.

Unë me këtë rast do t'i veçoj vetëm tri momente, të cilat konsideroj se janë të rëndësishme dhe meritojnë një trajtim më të thellë.

1. Informaliteti, përkatësisht veprimtaritë ilegale në eksploatimin e resurseve natyrore.
2. Mbrojtja e ambientit dhe siguria në punë.
3. Financat e KPMM-së, përkatësisht buxheti dhe shfrytëzimi i tij.

Për çështjen e parë, në këtë raport, në faqen 33 thuhet se janë regjistruar dhe inspektuar 268 raste të veprimtarive dhe ndaj operatorëve janë parashtruar 170 kallëzime penale. Nuk ka krahasime se a është në rritje apo në rënie numri i ilegaleve të inspektuar dhe të regjistruar. Mungesa e këtyre të dhënave nuk na jep pasqyrë të saktë se kjo veprimtari po shkon kah informaliteti, apo edhe këtu është duke dominuar ligji.

Për më keq, nuk ka ndonjë shifër e cila do të tregonte qartë se në çfarë përmasa apo sa ka qenë prodhimi i materialit të eksploatuar ilegalisht; sa është dëmtuar buxheti i Kosovës. Këtë dëm a do ta kompensojnë ilegalët e zënë.

Për shqetësim është fakti se ka një shpërputhje të madhe ndërmjet numrit të kallëzimeve penale, 170 sosh dhe dënimeve të shqiptuara 6 raste. Ka moskoordinime të veprimeve ndërmjet institucioneve dhe kjo ilegale iu ofron shansë që diku të gjejnë përkrahje.

Madje raporti konstaton se: të gjitha këto aktgjykime nuk e kanë dënimin e merituar në raport me veprën penale.

Për shkak të punës së ilegaleve, po pëson biznesi legal, përkatësisht ai që është i pajisur me leje e licenca dhe që paguan të gjitha obligimet ndaj shtetit. Kjo qartë del nga raporti. Për ilustrim, po e përmendi faqen 41: Prodhimi i vjetëm i rërës dhe i zhavorrit ka qenë për 3.639 ton më i madh se në vitin 2005, por gati për 27.000 ton më i vogël se në vitin 2008 dhe 27.550 ton më i vogël se në vitin 2009. Krejt kjo ka ndodhur për shkak të konkurrencës jolojale, apo të lirimt të punës së ilegaleve, kështu thuhet edhe në raport.

Prandaj, unë si deputet, pyes: A ka mekanizëm ky shtet që të mbrojë bizneset nga veprimtaritë ilegale? Apo të gjithë duhet të hyjnë në informalitet, meqenëse askush nuk do të na shqetësojë. Se është kështu, flet prodhimi i rërës dhe i zhavorrit.

Duke u ndërlidhur me këtë, dua të dihet saktësisht: A ka licencë dhe leje për eksploatim Kompania Bechtell & Enka?

Sipas raportit vërehet se ajo ka leje vetëm për hulumtim, por më intereson të di se: a është duke bërë eksploatim, dhe për këtë a ka njohuri KPMM-ja?

Çështje tjetër, që ndërlidhet me veprimtarinë ilegale, është edhe shkatërrimi i ambientit. Por kjo ndodhë edhe për shkak të mungesës së koordinimit dhe bashkërenditjes së aksionit ndërmjet dikastereve të ndryshme qeveritarë.

Madje, në raport thuhet se disa kompani nuk u përmbahen kushteve të mbrojtjes së ambientit. Por çfarë janë ndërmarrë që të bllokohen ndotësit e këtillë?

Rreth kësaj çështje, nuk mjafton vetëm konstatimi se mbetet obligim i inspektorëve të minierave që të mbikëqyrin zbatimin e kushteve apo se kompanitë kanë nisur tu përshtaten kushteve që ua imponon ligji. Por ato jo që duhet të nisin t'i përshtaten ligjit por duhet t'i përshtaten ligjit në momentin kur pajisen me licencë e leje, përkatësisht kur fillojnë punën.

Për fat të mirë, sipas raportit ka më pak raste tragjike që kanë ndodhur në vendet e eksploatimit të lëndëve të minierave. Vjet ka pasur katër lëndime të rënda, e një vdekjeprurëse. Ndërkaq, parvjet 11 lëndime të rënda e 2 vdekjeprurëse. Por është për alarm edhe një rast i vetëm nëse ndodhë. Madje çka është edhe më e keqe, ka pasur raste me pasoja tragjike, të cilat kanë ndodhur pas tërheqjes së kompanive të cilat pas vetes kanë lënë vetëm humnera. Në raste të këtilla, shpesh fajtor është njeriu. Këtu në rend të parë e kam fjalën për atë mbikëqyrës. Nuk mjafton vetëm të konstatohen mospërgatitjet teknike të kompanive, apo mos respektimi i normave, por duhet ndërmarrë masa konkrete qoftë edhe me mbylljen e përhershme të këtyre kompanive. Të mos harrojmë se jeta e njeriut është më e çmueshme se çdo ton rërë, zhavorr, gurë.

Sa i përket buxhetit të KPMM-së, është pak për habi se rritja e të hyrave ka ndodhur për shkak të arkëtimeve nga vitet më hershme. Vjet janë faturuar 5.3 milionë euro, kurse janë

arkëtuar gati 4.6 milionë ose me një shkallë të përmbushjes 86.8%. Në total, vjet KPMM-ja ka arkëtuar gati 8.5 milionë euro, por ndryshimi ka të bëjë për vitet e mëparshme.

Lind pyetja: Si ndodhë që këto arkëtime të bëhen me kaq vonesë? Dhe, diçka që duhet të theksohet, e cila është me rëndësi të veçantë, është: pse „Trepça“ ka borxh 1.5 milionë euro, ndërkaq në media thuhet se ajo vjet ka qenë në kufijtë e rentabilitetit. Si mund të ketë rentabilitet me borxhe? Apo, pse KPMM-ja nuk ka bërë arkëtimet e tyre? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë!

Të nderuar deputetë, para se të vazhdojmë me votimin e raportit, konstatoj se në sallë janë prezentë...

Urdhëro, po ke folur ti!

Mirë, deputetja Berisha e ka fjalën!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Më parë e kisha fjalën në emër të Grupit Parlamentar dhe gjatë përcjelljes së diskutimeve të kolegëve të mi, më shtynë që të marr fjalën edhe si deputete për shkak të sqarimit më tepër të opinionit dhe të deputetëve këtu, të cilët do t'i nënshtrohen një votimi për këtë raport.

Shumë me vend e pati zoti deputeti Visar Ymeri, kur tha se sqarimet më të mëdha i kemi marrë në Komision përmes pyetjeve që ia kemi bërë anëtarëve të Bordit të KPMM-së, ngase raporti vërtet është pak sa i mangët për ata që nuk kanë sens profesional në këtë drejtim. Dhe në këtë mënyrë, gjatë interpretimit të këtij raporti, duke interpretuar raportin si të shkëputur dhe të pjesshëm lehtë mund të bimë në dezinformim të opinionit dhe në dezorientim të Kuvendit se si të votohet.

Më lejoni për sqarim, që më herët një deputet tha se – pse janë lëshuar më shumë leje në vitin 2010, leje të hulumtimit dhe më pak në vitet tjera. Duhet të jesh njohës i mirë i kësaj çështjeje profesionale, por duhet të konsultosh edhe me ligjin që e rregullon këtë sferë dhe më lejoni që tua lexoj, faqe 13 në raport, se si dhe çka janë licencat e hulumtimit. Licencë hulumtimi është autorizim zyrtar me shkrim i lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës III të Ligjit për miniera dhe minerale. Licencat për hulumtim mineral – ndërtimor lëshohen me afat dyvjeçar. Që këtu i kemi tabelat që i ceku kolegu më parë, dhe mund të vazhdojnë vetëm një herë për një periudhë maksimale prej dy viteve të cilat mund të lëshohen me sipërfaqe maksimale deri në 250 hektarë.

Ndërsa licencë e hulumtimit për të gjitha mineralet e tjera lëshohen për një afat jo më të gjatë se tri vite, është fjala për mineralet metalike, me sipërfaqe maksimale deri në 100 kilometra me mundësi vazhdimi deri në tri herë nga dy vite, me kusht që çdo vazhdim sipërfaqeje për hulumtim duhet të reduktohet së paku 50%.

Nuk duhet t'i jepet konotacion tjetër sepse licencat e hulumtimit janë zvogëluar nga se në licenca të shfrytëzimit që këtu në tabela paraqiten se janë më të vogla në vitin 2010 ato kanë një afat shumëvjeçar, dhjetëvjeçar, pesëmbëdhjetëvjeçar e kështu me radhë, varësisht prej programeve që i kanë paraqitur kompanitë dhe kërkesat për hulumtim.

Prandaj, së pari është mirë të konsultohen me ligjin dhe të konsultohen me deputetët e vet të cilat i kanë pas pjesë të komisionit dhe të gjithë deputetët në komision e kanë mbështetur njëzëri raportin e këtij institucioni të pavarur. Ju ftoj, kolegë deputetë, ta voton dhe miratoni këtë raport sepse kështu jemi në linjë dhe mbështetje të këtij institucioni të pavarur. Informacione shtesë ne kemi kërkuar edhe në komision të këtij institucioni dhe është mirë që t'i shpërndahet të gjithë deputetëve, të gjitha dilemat dhe pyetjet që janë shtruar edhe në komision edhe sot në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur deputeti Gjini!

ARDIAN GJINI: Mendoj se nganjëherë kur flasin njerëzit, vlen ajo shprehja: mos e vet se të kallëzon vet!

Unë e thashë që licenca për hulumtim jepet për dy vite, mos të harron kolegja e dijshe se unë kam qenë ministër dhe e kam përcjellë këtë lëmi, më ka mbetur diçka në mend për tri vjet. Jepet për dy vjet, i shtyhet afati edhe për dy vite tjera. Nëse më kallëzoni mua, përpos rrethit të aeroportit, cila rrugë nuk është mbaruar për katër vjet, unë pajtohem që duhet me rishikuar këtë mendim timin. Shihni tabelat! Nuk do koment!

I nderuar, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Po ju thërras edhe një herë, të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, shihni tabelat! Për katër vite kryhet autostrada. Gjysma është kryer. Edhe licencat janë vetëm për hulumtim. Rrugët tjera, që po kryhen, asnjë nuk zgjatë më shumë se katër vjet. Për katër vjet kryhen rrugët duke hulumtuar gurin, pa e paguar asnjë cent për buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi kuorum!

Unë desha t'ju pyes, meqenëse nuk kemi kuorum, kemi edhe dy pika të rendit të ditës, raporte. A dëshironi që të debatojmë për to, apo t'i shtyjme për seancën e ardhshme, edhe debatin, edhe votimin.

(Ndërhyrje)

Po, por s'ka kuorum. Hajde Ramiz, se ty ishim duke të pritur. U bënë 61 deputetë, do të thotë kemi kuorum. Atëherë, po e votojmë raportin.

Para se të vazhdojmë me votimin e raportit, konstatoj se në sallë janë 61 deputetë. Është numër i mjaftueshëm për procedim.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani. Tash janë 63 deputetë!

Faleminderit! Konstatoj se me 31 vota "për", 28 "kundër" dhe 1 "abstenim" Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010.

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet e Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Komisionit të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, Nait Hasani, për arsyetimin e Raportin me rekomandimet. Nait Hasanit, fjalën! Po, mund të kërkon ndërpërprerjen e seancës. Po, zoti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kemi në vazhdimësi problem me kuorum dhe ka kaluar një kohë shumë e gjatë, domethënë që jemi duke punuar, unë propozoj që këto dy pika që kanë mbetur të shtyhen për një seancë të radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Një votim formal: A jeni dakord që të shtyjmë për seancën e ardhshme të radhës? OK. Me kaq, konstatoj se seanca e sotme mori fund.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve